

Ministria e Arsimit dhe  
e Shkencës e Republikës së Serbisë

# EDUKATA QYTETARE

PËR KLASËN E PESTË TË SHKOLLËS FILLORE

"Institucionet më të bukura do të mbetën çdo kund letër e vdekur në qoftë se tek qytetarët nuk e zgjojnë ndërgjegjen e pjekur të përkushtuar të atdhedashurisë dhe virtyteve qytetare"

*Nga teksti shkollor për edukatën qytetare të Millan Gj. Milliqeviq Shkolla e vogël për të drejtat dhe detyrimet qytetare nga viti 1837.*

Beograd 2011



# ***DORACAK PËR MËSIMDHËNES***

## **Mesazhi mësimdhënësve**

Të respektuar mësimdhënës,

Në qoftë se dëshironi që shkolla të jetë vend për të mësuar në ambientin e respektimit, të përfaqimit të lloj-llojshmërive, të paraqitjes së lirë të ideve e të mendimeve, të participimit të nxënësve, njerëzit e rinj si produkt i kësaj përvoje, do të presin nga shoqëria që tu përmbahet principeve të njëjtë. Mësimdhënësit kanë një detyrë të bukur dhe të përgjegjshme. Në shoqëritë të cilat po kalojnë nëpër ndryshime të shpejta politike, shoqërore e ekonomike, kontributi i shkollës është vendimtar. Nxënësit të cilët e kanë shijuar që në shkollë të dëgjohet zëri i tyre, që mendimi tyre të respektohet dhe të kenë të drejta e përgjegjësi, do të përgatiten më së miri për të ardhmen.

Dëshirojmë që ky doracak t'ju ndihmojë t'a realizoni programin mësimor të edukatës qytetare në klasën e pestë të shkollës fillore. Mendojmë se mundemi t'ju ndihmojmë në ndërtimin e kulturës së paqes në paralelen tuaj, e me këtë edhe në shkollë e cila po ngritet çdo ditë, e ndërton secili nga ne në raport me tjerët, nëpërmjet mënyrës si komunikojmë, si hidhërohemi, si gëzohemi, si përqafojmë, kuptojmë, nxisim, i duam ata me të cilët jetojmë.

Gjithashtu dëshirojmë që ky doracak t'ju ndihmojë:

- të fusni risi në punën tuaj dhe në komunikim me nxënësit tuaj,
- të jetë mbështetje për misionin e formimit të njerëzve të rinj të përgjegjshëm, qytetarë të ardhshëm,
- t'ju sigurojë njohuri dhe shkathësi të mjaftueshme që janë të domosdoshme për arsimim për demokracinë, shoqërinë qytetare dhe të drejtat e njeriut,
- që mësonjëtorja juaj të bëhet vend i mësimi mbi demokracinë dhe të drejtat e njeriut, në atmosferën demokratike e për aftësimin e nxënësve për jetë në shoqërinë demokratike e cila i respekton të drejtat e njeriut.

Me dëshirë që ta avancojmë realizimin e programit, ju ftojmë t'i dërgoni sugjerimet tuaja, shembujt nga praktika dhe tregimet e suksesshme me postë elektronike në:

[obrazovanje@gradjanske.org](mailto:obrazovanje@gradjanske.org)

## **Përmbajtja:**

### **1. ARSIMIMI PËR DEMOKRACI DHE SHOQËRI QYTETARE**

1.1. Demokracia dhe shoqëria demokratike qytetare	6
1.2. Çfarë është arsimimi për demokraci dhe shoqëri qytetare ?	7
1.3. ADSHQ në Serbi	8
1.4. Demokracia në shkollë - përse synojmë zhvillimin e demokracisë në shkollë?	10
1.5. Vendimmarrja demokratike në mësonjëtoreshkollë	10
1.6. Si ndërtohet në mësonjëtoresh atmosferë demokratike?	13
1.7. Çfarë pritet nga arsimtarët lidhur me të drejtat e fëmijës – Konventa mbi të drejtat e fëmijës	13
1.8. Mbi Konventën	14

### **2. PRINCIPET E REALIZIMIT TË PROGRAMIT**

2.1. Çfarë është çështje kyçe në programin e edukatës qytetare (EQ)	17
2.2. Principet themelore të mësimin/ të mësuarin	18
2.3. Planifikimi i mësimin/ orëve	19
2.4. Objektivi, detyrat dhe përmbajtja e programin	20
2.5. Shtojcat	22

### **3. UDHËZIME PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT**

3.1. Njohja e elementeve kryesore të programin	32
3.2. Kundrimi i kushteve të jetës shkollë	35
3.3. Zgjedhja e problemin në të cilin do të punohet	37
3.4. Mbledhja e të dhënave mbi problemin e përzgjedhur	38
3.5. Aktivizimi dhe participimi – plani i aksionin	41
3.6. Prezantimi publik i planin të aksionin	47
3.7. Vështrimi i të mësuarës-evaluimi	47
3.8. Shtojcat	49

## 1. ARSIMIMI PËR DEMOKRACI DHE SHOQËRI QYTETARE

„Shoqëria qytetare është shoqëri në të cilën flitet mbi gjithçka, dhe askush nuk thotë se je fajtor për atë që ke thënë“

Milica, 10 vjeç

## 1.1. Demokracia dhe shoqëria demokratike qytetare

Demokracia është grumbull i rregullave procedurale për marrjen e vendimeve kreative të cilat mundësojnë pjesëmarrje më të gjerë të mundshme të të interesuarve, apo atyre të cilëve u përkasin këto vendime (duke nënkuptuar edhe kontrollin e tyre të procesit të vendimmarrjes).

Demokracia nënkupton:

- **Barazinë e qytetarëve** - objektivi i demokracisë është që ndaj gjithë njerëzve të sillen njësoj pavarësisht arsimimit të tyre, përkatësisë kombëtare, statusit ekonomik...sepse të gjithë njerëzit janë të lirë të sillen me përgjegjësi, kur nga ata pritet ta bëjnë këtë. Nëse presim që të gjithë të rriturit kur të shfaqin kujdes mbi jetën e tyre, atëherë janë të aftë edhe për të marrë pjesë në vendosjen mbi jetën në shoqërinë të cilës i takojnë.

- **Përmbushja e nevojave të përgjithshme** - sa më shumë njerëz të marrin pjesë në përcaktimin e politikës, është më e sigurt se ajo do t'i manifestojë brengat dhe synimet e tyre. Demokracia nënkupton kuptueshmërinë e informatave për të gjithë, në mënyrë që të mund të ndikojnë në krijimin e politikës.

- **Pluralizmi dhe kompromisi** - demokracia mbështetet në këmbimin e lirë të mendimeve të ndryshme, paraqitjen e argumenteve dhe arritjen e kompromisit. Këmbimi i mendimeve përfshinë të drejtat që dallimet në mendime të shprehen dhe të dëgohen. Në atë mënyrë arrihet barazia midis qytetarëve.

- **Garantimi i lirive themelore** - demokracia garanton liritë themelore, që përfshinë: të drejtën për mendim dhe shprehje të lirë, bashkim me të tjerët, të drejtën e lëvizjes, të sigurisë personale... Demokracia i mbron këto të drejta, sepse sjellin deri tek vendimet kolektive dhe nxit zhvillimin personal të individit.

Shoqëria demokratike dëshiron të ndërtojë tipet vijuese të shoqërisë:

- **Qytetarët shembullorë** – të edukuar e të arsimuar sipas standardeve dhe kërkesave të shoqërive demokratike;
- **Qytetarët e lirë**- të cilët jetojnë dhe punojnë sipas principeve demokratike, parimeve, kërkesave, të drejtave dhe detyrimeve;
- **Qytetarët e përgjegjshëm** të cilët:
  - ✓ **do të jenë të zot dhe të mund** të jetojnë në bashkësi;
  - ✓ **do të jenë të zot** që mirë dhe adekuat të ushtrojnë aktivitetet e tyre profesionale
  - ✓ **do të jenë tolerantë**, kompetentë, të shëndoshë moralisht e fizikisht, humanë, dashamirës të së vërtetës, të përgjegjshëm, të ndershëm, kreativë, të pavarur;
  - ✓ **të jenë të zot dhe të mund** të përfshihen dhe të marrin pjesë në zhvillimin e shoqërisë demokratike.

## 1.2. Çfarë është arsimimi për demokraci dhe shoqëri qytetare

### Projekti i Këshillit të Evropës <sup>1</sup>

Të gjitha vendet evropiane janë ballafaquar me sfidat e shoqërisë bashkëkohore sikurse janë: rritja e apatisë zgjedhore; marginalizimi dhe tjetërsimi i të rinjve nga rrjedhat kryesore shoqërore; rritja e intolerancës, ksenofobisë, racizmit. Vendet që gjenden në procesin e tranzicionit e të demokratizimit gjenden përpara sfidave shtesë. Këshilli i Evropës u ka bërë thirrje të gjitha qeverive të vendeve anëtare që në vendet e veta, në kuadër të politikës arsimore dhe reformave që po i zbatojnë, tu japin prioritet arsimimit për shoqërinë demokratike. Duke nxjerrë arsimimin për demokraci dhe shoqëri qytetare në plan të parë, Këshilli i Evropës dhe vendet anëtare përpiqen të gjejnë përgjigje adekuate në shumë nga sfidat e shoqërisë bashkëkohore dhe të ndërtojnë një shoqëri më të drejtë, më të lirë dhe më tolerante evropiane.

Arsimimi për demokraci dhe shoqëri qytetare (ADSHQ) është grumbull i masave edukative e arsimore dhe i aktiviteteve, qëllimi i të cilave është që edhe të rinjtë dhe të rriturit të aftësohen më mirë për të marrë pjesë aktive në jetën demokratike, ashtu që do t'i realizojnë të drejtat dhe do t'i përqafojnë përgjegjësitë e veta. Me fjalë të tjera ADSHQ na mëson mbi atë si të bëhemi qytetar dhe si të jetojmë në shoqërinë demokratike.

Ajo nënkupton:

- përvojën e mësimin gjatë **gjithë jetës**,
- përgatitjen si të individit ashtu edhe të shoqërisë në tërësi për **pjesëmarrje** në jetën qytetare e politike
- respektimin e të **drejtave** dhe përqaftimin e **përgjegjësive**,
- marrjen në konsideratë të **llojllojshmërisë** kulturore e shoqërore

### Objektivat e arsimimit për demokraci dhe shoqëri qytetare:

- forcimi i shoqërisë demokratike me kultivimin e kulturës demokratike,
- zhvillimi i ndjenjës së përkatësisë dhe përkushtimit shoqërisë demokratike,
- zhvillimi i vetëdijes mbi vlerat e përbashkëta themelore për t'u ndërtuar shoqëria më demokratike, më tolerante dhe më e drejtë.

### Çfarë përfshinë arsimimi për demokraci dhe shoqëri qytetare

ADSHQ është fushë shumëdisiplinore e cila përfshinë: edukimin qytetar, arsimimin për të drejtat e njeriut dhe të drejtat e fëmijës, arsimimin interkulturor, arsimimin për paqe e zhvillim, arsimimin global...

Këto disiplina synojnë të sigurojnë “shkrim leximin qytetar”, por ashtu që ajo të pasqyrohet në **shfrytëzimin** e të drejtave qytetare dhe **praktikimin** e përgjegjësive qytetare në tipet e ndryshme të shoqërive, të cilave ju takojnë qytetarët. Prandaj, ADSHQ është mësim social, mësim **mbi** shoqërinë demokratike, mësim **për** shoqërinë demokratike dhe mësim **në frymën** e shoqërisë demokratike. Ai ofron dije, shkathtësi dhe nxit gatishmërinë për angazhim shoqëror kompetent e të përgjegjshëm.

---

<sup>1</sup> Këshilli i Evropës është organizatë politike kontinentale, misioni kryesor i të cilit është – forcimi i demokracisë pluraliste, i të drejtave të njeriut dhe sundimi i ligjit [www.coe.int](http://www.coe.int)

Ku zhvillohet arsimimi për demokraci dhe shoqëri qytetare

Si arsimim gjatë gjithë jetës ADSHQ është pjesë e arsimimit formal e jo formal, por zhvillohet edhe në jetën e përditshme. Kjo do të thotë se, përpos në institucionet arsimore, arsimimi për demokraci realizohet me anë të aktiviteteve të sektorit joqeveritar, bashkësisë lokale dhe mediave.

Shkolla është bartëse kryesore e arsimimit për demokraci dhe shoqëri qytetare, para se gjithash në mësim, por edhe në aktivitetet jashtë - arsimore dhe në kulturën e atmosferën e tërësishme të shkollës.

### **Çfarë arrihet me arsimimin për demokraci dhe shoqëri qytetare tek nxënësit**

- Zhvillimi i **vlerave** dhe **qëndrimeve** është epilog kyç i këtij mësimi. Kujdes i veçantë u kushtohet gjitha vlerave të cilat e mbështesin idenë e demokracisë dhe të drejtave të njeriut, sikurse janë konsiderata dhe respektimi i vetvetes dhe të tjerëve, aftësia e dëgjimit dhe e zgjidhjes paqësore të konflikteve.

- Kuptimi dhe **dija** – në kuptimin më të gjerë kjo dije mund të ndahet në tri nivele: “**dija mbi**” shoqërinë demokratike, rregullat e jetës së përbashkët..., **njohja** e procedurave, dispozitave, ligjeve, konventave... dhe “**të dihet si**” ( Çfarë e përbën debatin ? Cila qasje është zbatuar për nxjerrjen e rregullave në shkollë?...).

- **Përfshirja e nxënësve**, që do të thotë se secilit nxënës i sigurohet të marrë pjesë në shkollë. Mbi pjesëmarrjen mësohet me pjesëmarrje, e jo me mësim mbi pjesëmarrjen. Kyçe është që mësimdhënësit të sigurojnë që të gjithë nxënësit të jenë të përfshirë në mënyrë të barabartë, duke respektuar dallimet e nxënësve të vet, si në stilet e të mësuarit ashtu edhe në tipin e personalitetit.

- Nxitja e **marrjes së përgjegjësisë dhe të iniciativës** për ndodhitë në shkollë, e më pas edhe për gjithë atë që ndodh në shoqëri. Këto janë kapacitete që e forcojnë individin për rimarrjen e rolit aktiv në bashkësi dhe për dhënien e kontributit të vet në krijimin e punëve të saj në zgjidhjen e problemeve.

- Zhvillimi i **solidaritetit**, i cili në shumë mënyra është i lidhur me kapacitetin e individit që të bëjë hapa përpara nga hapësira e vet, t’i njohë të drejtat e tjerëve dhe të jetë i gatshëm për mbrojtjen e tyre.

Këto elemente të arsimimit për demokraci dhe shoqëri qytetare, dijet e kuptimi, aftësitë dhe shkathtësitë, vlerat, janë të lidhura ndërmjet tyre dhe fitohen e ndërtohen me anë të përvojës praktike, teknikës aktive e kooperative të mësimi, por edhe me anë të analizës së mëpasshme dhe refleksionit.

### **1.3. Arsimimi për demokraci e shoqëri qytetare (ADSHQ) në Serbi**

Rrënjët e ADSHQ-së në sistemin arsimor të Serbisë janë vendosur qysh në shekullin e 19 kur është zhvilluar lufta për rregullim kushtetues. Atëherë është zhvilluar koncepti i arsimimit për shoqërinë demokratike, duke iu përshtatur shtetit të atëhershëm dhe shoqërisë serbe që ka qenë i njohur si arsimim për “të drejta dhe detyrime qytetare”. Përmbajtja e tekstit të parë shkollor të arsimimit qytetarë (Milan Gj. Miliqeviq, Shkolla e vogël për të



drejta dhe detyrime qytetare, (1889) ka përfshirë “mësimet” mbi detyrimet morale, lirinë qytetare e politike, të drejtat dhe detyrimet shoqërore, bazat e sistemit kushtetues e politik dhe marrëdhëniet ndërkombëtare.

Në fillim të shekullit 20 arsimimi qytetar ka qenë i përfaqësuar në shkollat e Mbretërisë e Jugosllavisë. Planprogrami mësimor i shkollave qytetare të viteve të njëzeta e tridhjeta e ka pas si lëndë e detyrueshme mësimin mbi të drejtat e detyrimet qytetare, qëllimi arsimor i të cilit ka qenë “përgatitja e nxënësve që të bëhen qytetarë dhe shtetas me vetëdije të ndershme.”

Në kohën tonë, aktivitetet në këtë fushë realizohen prej vitit 1992, si pjesë e angazhimit të shumë OJQ-ve. Serbia është inkuadruar në Këshillin e Evropës më 2001, dhe në vazhdimësi është e pranishme në të gjitha fazat e tij.

- Arsimimi për demokraci dhe shoqëri qytetare është futur në arsimimin e Serbisë më 2001.
- Janë akredituar shumë programe të OJQ-ve nga kjo fushë kurse në vitin shkollor 2001/2002, është futur lënda Edukata qytetare në arsimimin fillor e të mesëm.
- Deri tani janë zhvilluar programet për katër klasët e para të shkollës fillore dhe për katër klasët e shkollës së mesme, si dhe doracakët për arsimtarë.
- Janë stërvitur edukatorët të cilët në seminarët e mëtejshëm për edukimin e mësimdhënësve kanë stërvitur disa mijëra arsimtarë për mbajtjen e mësimin nga kjo lëndë.
- Është hartuar korniza juridike e cila siguron, obligon/ nxit shkollat që të sigurojnë pjesëmarrjen e nxënësve, prindërve dhe përfaqësuesve të bashkësisë lokale në jetën dhe punën e shkollës.
- Janë bërë hapat e parë në decentralizimin dhe demokratizimin e institucioneve arsimore: me përfshirjen në Programin shkollor planifikimin zhvillimor, me formimin e parlamenteve të nxënësve, me veprimin e klubeve rinore, me pjesëmarrjen aktive e konstruktive të prindërve në jetën e përditshme të shkollës, me zhvillimin e praktikës së dialogut, negocimit dhe të kërkimit të konsensusit në situatat e përditshme të jetës shkollore.
- Është realizuar bashkëpunimi në fushën e ADSHQ me shumë organizata e institucione vendore e ndërkombëtare.

Ministria e Arsimit dhe e Sportit, në kuadrin e **Strategjisë së Ministrisë për periudhën 2005-2010**, si një nga prioritetet, ka cekur demokratizimin e arsimimit dhe arsimimin për demokraci e shoqëri qytetare.

**Decentralizimi dhe demokratizimi i arsimimit** nënkupton:

- Zhvillimin e autonomisë së institucioneve arsimore;
- Respektimin e nevojave ekonomike e shoqërore në arsimim;
- Përfshirjen e përfaqësuesve të grupeve të interesit në procesin e vendosjes në arsimim;
- Sigurimin dhe përcjelljen e cilësisë së arsimimit dhe të rezultateve të tij;
- Profesionalizimin e kuadrove në arsimim;
- Kultivimi i atmosferës së tolerancës dhe të komunikimit konstruktiv;
- Sistemin e decentralizuar, ekonomik dhe efikas të menaxhimit;
- Përgjegjësinë profesionale e personale në procesin e vendimmarrjes.

## 1.4 Demokracia në shkollë - përse synojmë zhvillimin e demokracisë në shkollë?

Shoqëria demokratike dëshiron që me arsimimin dhe edukimin e vet të:

- arsimojë nxënësit për mënyrën demokratike të jetesës,
- zhvillojë gatishmëri për angazhime shoqërore, respektimin dhe zhvillimin e vlerave të sistemit shoqëror,
- kultivojë qëndrim kritik ndaj dukurive dhe problemeve shoqërore, vetëdijen e mirëkuptimit shoqëror, të tolerancës dhe të drejtësisë sociale.

**Karakteri demokratik në sferën e arsimimit mbështetet në respektimin e dy principeve themelore:**

- **principin e barazisë** (barazia në raport me të drejtat para ligjit)
- **principin e participimit** (pjesëmarrjes aktive në vendimmarrje mbi dhe në praktikën e arsimimit dhe edukimit)

Shkolla është vendi më adekuat në të cilin fëmijët mund të mësojnë dhe shijojnë principet e njëjtësisë, barazisë dhe të participimit.

Demokracia nënkupton **përshtatjen e informatave** të gjithë nxënësve, që do të mundësonte që nxënësit ta marrin përgjegjësinë për atë që ndodh në shkollë, në mënyrë që të mund të ndikojnë në krijimin e politikës.

Demokracia mbështetet në **këmbimin** e lirë të **mendimeve të ndryshme**, paraqitjen e argumenteve dhe arritjen e kompromisit. Këmbimi i mendimeve përfshinë të drejtën që dallimet në mendime të shprehen dhe dëgjohen. Në këtë mënyrë arrihet barazia midis nxënësve.

Demokracia garanton **liritë themelore**, që përfshijnë: të drejtën e mendimit dhe shprehjes së lirë, të bashkimit me tjerët, lëvizjes, të sigurisë personale... Demokracia i mbron këto të drejta sepse nxësin zhvillimin personal të nxënësit

**Prandaj është e rëndësishme që në shkollë të ekzistojnë rregullat dhe procedurat demokratike, në miratimin e të cilave lypset të marrin pjesë edhe vetë nxënësit.** Është me rëndësi që nxënësit të merren vesh dhe të përqafojnë mënyrat e kontrollit të rregullave dhe procedurave demokratike, që do të jetë garanci për respektimin e tyre.

## 1.5. Vendimmarrja demokratike në mësonjëto/ shkollë

Që një vendimmarrje të konsiderohet demokratike, është me rëndësi që vendimi të jetë marrë në mënyrë demokratike, domethënë me respektimin e rregullave të procedurës. Karakteristika kryesore e demokracisë është që të gjithë t'i ndajnë të drejtat në vendimmarrje në mënyrë të barabartë, kurse vendimmarrja me shumicë është mjet procedural për zgjidhjen e mospajtimeve kur janë shterrur të gjitha metodat tjera, sikurse janë debati, amendamentet, kompromisi.

Demokracinë e dallojmë nga autokracia ku vendimet i merr një, ose pakica, në mënyrë autoritare, duke mos përfillur çfarëdo rregulli dhe arbitrarisht, sipas mendimit të vet, pa mundësi të çfarëdo pjesëmarrjeje të atyre cilëve u përkasin ato vendime.

Është me rëndësi që vendimet të cilat merren në paralele, të miratohen ashtu që të respektohen procedurat dhe rregullat e dakorduara. Të gjithë kanë të drejtë të marrin pjesë në marrjen e vendimeve, sidomos mbi gjërat që u përkasin vetë nxënësve.

Në procedurën demokratike bëjnë pjesë, midis të tjerash:

- e drejta e votës për secilin nxënës,
- mundësia e shprehjes publike të mendimit personal.

*Mësimdhënësi do të ketë rastin që gjatë vitit të ushtrojë me nxënësit marrjen demokratike të vendimeve. Me rastin e zgjedhjes së problemit në të cilin do të punojnë nxënësit, është me rëndësi që mësimdhënësi të mos ndikojë në zgjedhjen e problemit me të cilin nxënësit dëshirojnë të merren, veç t'i fusë në diskutim mbi argumentet që i kanë mbledhur.*

## **Participimi/pjesëmarrja e nxënësve**

Fëmijët dhe rinia kanë të drejtë për shprehjen e lirë të mendimit dhe për pjesëmarrje në vendimmarrje mbi gjërat që atyre u përkasin direkt, të drejtë për bashkim dhe tubime të qeta. Realizimin e këtyre të drejtave - që të dëgjohet zëri i tyre dhe të përfshihen në vendimmarrje - e quajmë participim ose pjesëmarrje. Participimi është rimarrja e rolit aktiv në shoqëri.

Me anë të participimit nxënësit fitojnë dijeni dhe shkathtësi të rëndësishme. Ata mësojnë të marrin vendime dhe të jenë të përgjegjshëm. Shkolla lypset të jetë vend ku mësohet mbi demokracinë, të drejtat e fëmijës, por edhe vend ku jetohet demokracia. Me realizimin e principeve dhe vlerave demokratike në shkollë, nxënësit fitojnë dijeni mbi demokracinë dhe përgatiten për jetë në shoqërinë demokratike në mënyrën më të mirë të mundshme.

Participimi i nxënësve është me rëndësi vitale kur është fjala mbi jetën shkollore dhe mësimin. Shtrohet pyetja a është e mundshme pjesëmarrja e nxënësve në marrjen e vendimeve si mbi mësimin shkollor, ashtu edhe mbi të gjitha aktivitetet tjera që ndodhin në shkollë. Një nga pyetjet që gjithashtu shtrohet është, përse nevojitet një pjesëmarrje e atillë e nxënësve? Shikuar gjerësisht, problemi i participimit shtrohet tek të gjitha aktivitetet që janë të përbashkëta për të rriturit dhe fëmijët, në mënyrë të tillë që ka kuptim të analizohet problemi i participimit të fëmijës në bashkësitë sikurse janë familja, shkolla, jeta publike.

Ekzistojnë disa nivele të participimit të nxënësve në shkollë, që nuk do të thotë se të gjitha format e cekura të participimit janë në kuptimin e plotë të fjalës.

**MANIPULIMI** është formë e pjesëmarrjes së rrejshme të nxënësve. Mbi manipulimin është fjala në të gjitha ato raste kur fëmijët paraqiten në manifestimet e përbashkëta në aktivitetet e fëmijës dhe të rriturve, por fëmijës nuk i është sqaruar në çfarë marrin pjesë, pse marrin pjesë, cilët janë efektet e atyre aktiviteteve në përgjithësi e cilët janë efektet për vetë fëmijët. Të rriturit shpesh në këtë nivel i keqpërdorin fëmijët për të arritur ndonjë qëllim të vetin.

Për shembull:

Fëmijët marrin pjesë në garat e ndonjë lënde sepse i flasin mirë gjuhët, punojnë matematikë, etj., por në të vërtetë fëmijët nuk dëshirojnë të marrin pjesë, kurse mësimdhënësit marrin kompensimin e caktuar financiar kur nxënësi i tyre e zë njërin nga tri vendet e para në garë. Gjithashtu, ai sukses është jashtë shkollës, por nuk është dëshirë e fëmijës.

**PËRDORIMI DEKORATIV I FËMIJËVE** gjithashtu është shumë i shpeshtë. Edhe në këtë formë të angazhimit, fëmijët nuk vendosin mbi pjesëmarrjen e vet, nuk e kuptojnë idenë e asaj në çfarë marrin pjesë, askush as nuk ua sqaron dhe për fëmijët ky angazhim nuk ka kurrfarë domethënie. Në këtë nivel fëmijët paraqiten në ndonjë rol të shkurtër, zakonisht të veshur në ndonjë mënyrë simpatike, diç thonë ose bëjnë, punohen fotografi të bukura, pastaj fëmijët mekanikisht largohen kurse të rriturit i vazhdojnë aktivitetet e veta.

Shembull:

Përdorimi dekorativ i nxënësve në shkollë është kur dikush vjen ta vizitojë orën (prindi, kontrollori...), kurse “të shkëlqyeshmit”, për mirëseardhje, deklamojnë vjershën prej dhjetë strofash.

**PËRDORIMI SIMBOLIK I FËMIJËVE** është diç më pak manipulues e dekorativ. Fjala të shpeshtën është mbi pjesëmarrjen e fëmijëve në aktivitetet e të rriturve, që kanë të bëjnë me fëmijët, ose që mund të kenë pasoja për fëmijët. Edhe në këtë rast fëmijët nuk janë njoftuar mbi atë në çka marrin pjesë, nuk e kuptojnë mirë domethënien e ndodhisë, dhe vetëm pjesëmarrja e tyre për ta nuk ka shumë kuptim. Por prezenca e fëmijëve shërben si përkujtues për të rriturit që të mendojnë në fëmijët. Fëmijët që paraqiten në aktivitete të këtitilla simbolizojnë, por nuk i përfaqësojnë në mënyrë të mirëfilltë fëmijët për të cilët me rëndësi është ajo që bëjnë të rriturit.

Ndodhë që në takimin ku të rriturit marrin vendime të cilat prekin fatin e fëmijës, ta thërrasin ndonjë fëmijë dhe nga ai të pritët të thotë një fjali për të cilën as që ka pas kohë për tu përgatitur, as që i ka pyetur fëmijët tjerë çfarë mendojnë, e i përfaqëson po ata fëmijë.

Shembull:

Kur në mbledhjet e këshillave të paraleleve thirren përfaqësuesit e secilës paralele dhe “instruktohen” nga kujdestarët e klasës çfarë duhet të thonë mbi paralelen të cilën e përfaqësojnë, dhe të shpeshtën u falënderohen disa kujdestarëve për mundin dhe punën me fëmijë.

**PARTICIPIMI I NJËMENDËT I FËMIJËVE** - Ekzistojnë disa lloje të kësaj forme të participimit. Aty gjithmonë fjala është mbi pjesëmarrjen e fëmijëve në atë që është e rëndësishme për vetë fëmijët. A thua fëmijët njëmend marrin pjesë në këtë, përfundohet në bazë të disa kuteve të rëndësishëm:

- A mund ta kuptojnë fëmijët idenë e aktivitetëve në të cilat duhet të marrin pjesë;
- A marrin pjesë fëmijët në vendimmarrje mbi inicimin e këtij aktiviteti dhe mbi pjesëmarrjen e vet në të;
- A kanë fëmijët mundësi të vendosin të marrin pjesë vullnetarisht;
- A janë informuar fëmijët mbi rezultatet e aktivitetëve dhe pasojat e këtij aktiviteti për ta;
- A ekziston mundësia që fëmijët ta drejtojnë ndonjë pjesë të aktivitetit.

Me kombinimin e kuteve të cekura fitohen lloje të ndryshme dhe nivele të ndryshme të participimit të njëmendët të fëmijëve në shkollë. Nxënësit janë të:

- **INFORMUAR**

Këto janë ato forma të organizimit të aktivitetëve, në të cilat fëmijët nuk kanë iniciativë dhe nuk marrin pjesë në vendimmarrje, por me siguri janë edhe të informuar mirë.

- **SHPREHIN MENDIMIN E VET**

Shkalla pasuese e angazhimit të fëmijëve është ajo kur të rriturit mundohen me të vërtetë që t’i dëgjojnë fëmijët me kujdes, të dëgjojnë vërtetë çfarë mendojnë ata njëmend mbi atë që duhet të bëhet, e pastaj edhe të sqarojnë kuptimin e aktivitetëve në të cilët do të marrin pjesë.

- **MARRIN PJESE NË VENDIMMARRJE**

- **MARRIN VENDIME**

Në këtë nivel, një nga kutet kryesore është se kush është iniciator për ndonjë aktivitet, kur e merr vendimin mbi inicimin e aktivitetit dhe kush e zbaton kontrollin mbi rrjedhën e aktivitetit. Këtu janë të ndara qartë rolet e fëmijëve dhe të rriturve. Ato janë aktivitetet e përbashkëta të fëmijëve dhe të rriturve, ku shtrohen probleme qenësore të jetës së përbashkët, të komunikimeve të atyre që janë të ndryshëm,

ballafaqimi i pikëpamjeve të ndryshme, zgjidhja e konflikteve mes vete, bashkërendimi i qëllimeve dhe interesave të ndryshme.

- U KONTRIBUOJNË AKTIVITETEVE SHKOLLORE

- ZHVILLOJNË AKTIVITETET SHKOLLORE

Participimi i njëmendët i nxënësve është njësoj i rëndësishëm si në procesin arsimor dhe në procesin e mësimit, ashtu edhe në të gjitha aktivitetet tjera jashtë mësimore. Duke shfrytëzuar këto dijeni mbi participimin, nevojitet të organizohen nxënësit që të hartojnë planin e aksionit për problemin të cilin e kanë përzgjedhur dhe me të cilin merren.

## 1.6. Si ndërtohet në mësonjëtoare atmosfera demokratike?

Kultivimi i atmosferës demokratike është kushti i parë që të aplikohen objektivat dhe detyrat e arsimimit për demokraci dhe shoqëri qytetare. Çfarë do të thotë kjo në të vërtetë? Fokusi është në krijimin e atmosferës në të cilën nxënësit do të ndjehen lirinë që të shprehin personalisht dhe të jenë të hapur, por edhe përgjegjës ndaj vetvetes, të tjerëve dhe grupit në procesin e përbashkët të mësimit.

Në një mësonjëtoare të tillë ekzistojnë rregullat e caktuara qartë, sepse pa rend dhe rregulla themelore nuk mund të jetë demokratike.

- Fëmijët marrin pjesë në miratimin e rregullave dhe vendosin mbi masat për mosrespektimin e tyre.
- Rregullat e miratuara ashtu mund të mos u përgjigjen individëve, por derisa janë të vlefshme lypset të respektohen.
- Rregullat mund të ndryshohen.
- Raportet prej bashkëpunëtorit e zëvendësojnë konkurrencën dhe garat.
- Liria individuale shfrytëzohet në mënyrë të tillë, që të mos i rrezikojë të tjerët. Kjo është mënyrë që të zhvillohet përgjegjësia individuale.
- Atmosfera miqësore, atmosfera e përqaimit dhe e mbështetjes është me rëndësi vitale.
- Respektimi dhe përqaftimi i ndjenjave dhe e nevojave të nxënësve e të mësimitdhënësve.
- Bisedat grupore zhvillohen vazhdimisht.
- Gabimet janë të lejueshme.

*Mësimitdhënësit do të kenë rastin që në programin për klasën e V, qysh në orën hyrëse bashkë me nxënësit të miratojnë rregullat dhe të merren vesh si aplikohen masat në qoftë se rregullat nuk respektohen. Roli i mësimitdhënësve është që rregullat të përkufizohen me gjuhën e aksionit pozitiv.*

Duke shikuar grupet e nxënësve si mësojnë, mund të vërehet sa vijon - se ekziston lidhja midis asaj si është drejtuar grupi dhe mënyra si mëson ai. Grupet e drejtuara në mënyrë autokratike mësojnë vetëm atëherë kur me ta është drejtuesi (udhëheqësi) ndërsa grupet e drejtuara në mënyrë demokratike, punojnë edhe kur janë vetëm. Në këtë mënyrë tek nxënësit zhvillohet përgjegjësia. Ata bëhen më të përgatitur për një shoqëri të hapur.

## 1.7. Çfarë pritet nga arsimtarët lidhur me të drejtat e fëmijës – Konventa mbi të drejtat e fëmijës

Konventa u është dedikuar të gjithë atyre që merren me fëmijët. Por esencën e saj në masën më të madhe duhet ta njohin, para se gjithash, fëmijët. Roli i të rriturve pikërisht është në faktin që fëmijëve t'u **ndihmojnë ta kuptojnë esencën** e të drejtave të veta në mënyrë që

t'i aplikojnë me sukses. Kur i njohin, kuptojnë dhe aplikojnë të gjitha të drejtat që u takojnë me vetë lindjen, fëmijët do të pihen në persona të përgjegjshëm, të cilët do të dinë të respektojnë edhe të drejtat e veta edhe të tjerëve.

Së këndejmi nga mësimdhënësit pritet:

- Ta njohin Konventën mbi të drejtat e fëmijës;
- Që fëmijët t'i njohin me të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre në raport me ato të drejta.
- Të sigurojnë kushte në mësonjëtoare dhe në shkollë, në të cilat do të respektohen të drejtat e fëmijëve;
- Që bashkë me fëmijët të krijojnë kushte në mësonjëtoare dhe në shkollë për realizimin pa pengesa të drejtave të fëmijës.
- Të sigurojnë përcjelljen e respektimit të drejtave të fëmijës.
- Nëse bëhet shkelja e të drejtave të fëmijës, të reagojnë si profesionistë.

Ndajuni nxënësve tuaj kopjen e Konventës mbi të drejtat e fëmijës. Orientoni ata sa herë që analizoni ndonjë situatë, gjendje dhe zgjidhjen e mundshme ta kërkojnë se me cilin nen të Konventës kjo rregullohet. Është me rëndësi që nxënësit të kuptojnë cilat të drejta i kanë, por gjithashtu është me rëndësi të kuptojnë se me përcjelljen dhe përfshirjen aktive në realizimin e të drejtave të veta, i gëzojnë të drejtat e shënuara në letër.

## 1.8. Mbi Konventën

Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara ka miratuar në vitin 1948, *Deklaratën universale mbi të drejtat e njeriut*. Ky dokument nënkuptonte edhe të drejtat e fëmijës. Nevojat e veçanta të fëmijëve imponojnë edhe kujdes të veçantë, prandaj Kombet e Bashkuara miratuan në vitin 1959, *Deklaratën mbi të drejtat e fëmijës*. Deklarata nuk ka veprim ligjor, juridik veç paraqet detyrimin moral. Konventa është një lloji ligji, traktat i cili juridikisht i obligon vendet të cilat e nënshkruajnë apo "ratifikojnë". Prandaj, më 20 Nëntor të vitit 1989, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi *Konventën mbi të drejtat e fëmijës*. Ajo hyri në fuqi në vitin 1990.

*Konventa mbi të drejtat e fëmijës* është traktat i Kombeve të Bashkuara i cili saktëson cilat të drejta në tërësi u takojnë fëmijëve. Ajo shtron standardet bazike për mirëqenien e fëmijëve në stadi të ndryshme të zhvillimit të tyre. Konventa është ligj universal i cili në një vend dhe në tërësi i përkufizon të gjitha të drejtat e fëmijës, në vend që të drejtat e fëmijës të zgjidhen me një varg ligjesh dhe marrëveshjesh ndërkombëtare. Ajo mbështetet mbi katër principe kryesore:

**1. e drejta për jetë, ekzistencë dhe zhvillim** të cilat shteti nevojitet t'ia sigurojë secilit fëmijë në masën e mundshme maksimale (neni 6),

**2. mos-diskriminimit** - të gjithë fëmijëve u takojnë të drejta të barabarta, pa marrë parasysh racën, ngjyrën, gjininë, gjuhën, besimin fetar, bindjen politike apo tjetër, prejardhjen kombëtare, etnike apo sociale, gjendjen pronësore, paaftësinë, lindjen apo statusin tjetër të fëmijës, të prindit të tij apo të kujdestarit (tutorit) të tij (neni 2),

**3. interesit më të mirë të fëmijës** – në të gjitha procedimet që u përkasin fëmijëve interesi i tij më i mirë do të ketë prioritet,

**4. respektimit të mendimit të fëmijës** - e drejta e fëmijës të shprehë mendimin e vet në të gjitha çështjet dhe procedimet që i përkasin direkt dhe që ai mendim i tij të merret në konsideratë (neni 12).

Konventa përmban 54 nene, të cilët përcaktojnë llojet e caktuara të drejtave. Mund të dallojmë katër grupe të të drejtave:

**E drejta për ekzistencë** – përfshinë të drejtën për jetë dhe të drejtën për kënaqjen e nevojave themelore ekzistenciale (ushqimin, kulmin mbi kokë, standardin adekuat të jetesës, kujdesin mjekësor);

**E drejta për zhvillim** - përfshinë krejt atë që është e rëndësishme për zhvillim normal dhe të tërësishëm të të gjitha potencialeve të fëmijës (e drejta për arsimim, për lojë, kohë të lirë e rekreacion, për aktivitete kulturore, për qasje në informata dhe lirinë e mendimit, të shprehjes dhe të besimit fetar);

**E drejta mbrojtëse** – kërkon që fëmijët të mbrohen nga të gjitha format e keqpërdorimit, mospërfilljes dhe të keqtrajtimit (puna fëmijërore, keqpërdorimi seksual dhe ekonomik , përdorimi i drogës, pjesëmarrja e fëmijëve në konfliktet e armatosura, kujdesi për fëmijët refugjatë, delikuenca për të mitur, dhuna dhe keqtrajtimi fizik);

**E drejta e participimit** - u jep fëmijëve mundësi që jenë pjesëmarrës aktivë në jetën e bashkësisë së tyre (e drejta e shprehjes së lirë të mendimit të vet dhe për pjesëmarrje në vendimmarrje mbi çështjet të cilat u përkasin direkt atyre, e drejta për bashkim dhe tubime te qeta).

Konventa ka për objektiv avancimin e pozitës së fëmijëve në shoqëri, me ç' rast theksohet se secili fëmijë para se gjithash është individ të cilit i takojnë të drejtat e njeriut nga lindja. Ajo përmban të gjitha llojet e të drejtave të fëmijëve që janë të gërshetuara. Nuk ekzistojnë të drejta më shumë a më pak të rëndësishme, sepse të gjitha bashkë e përbëjnë tërësinë.

## **2. PRINCIPET E REALIZIMIT TË PROGRAMIT**

*DËGJOJ - HARROJ  
SHOH - MBAJ MEND  
PUNOJ - KUPTOJ*

*Proverb kinez*



## 2.1. Çfarë është çështje kyçe në programin e Edukatës qytetare

**Mësimi aktiv** – ky është proces i mësimin “me anë të veprimin”. Ky është proces arsimor në të cilin ai që mëson është partner aktiv në procesin e mësimin, e jo marrës pasiv i dijenisë. Individët dhe grupet mësojnë më mirë kur marrin pjesë aktive në mësim. Metodat e mësimin aktiv në ADSHQ përfshijnë: ekspozimin e lirë të ideve, debatin, diskutimin, aktivitetet hulumtuese, punën projektuese...

**Mësimi në bashkëpunim** – mbështetet në mësimin social e interaktiv ku vend qendror kanë proceset grupore. Aktivitetet në kuadër të mësimin në bashkëpunim u mundësojnë fëmijëve që të mësojnë bashkë duke punuar në projektet e përbashkëta. Kjo gjithashtu i nxit nxënësit që bashkërisht t’i shqyrtojnë problemet, që t’i kundrojnë më mirë, dhe vetvetes t’ia shprehin më mirë. Ekzistojnë forma të ndryshme të mësimin me ndihmën e moshatarëve dhe konsiderohet formë mësimore më produktive e interaksionit. Forma e dhënies së mësimin është mësimi ku një fëmijë mundohet të japë mësim – e udhëheq fëmijën tjetër me rastin e kryerjes së ndonjë detyre.

Shtojcë “Të mësuarit në grupin e moshatarëve”.

**Puna ekipore** është angazhim i përbashkët, i sinkronizuar i profesionistëve të profileve të ndryshëm apo të njëjtë ose i specialistëve në detyrën e njëjtë. Mund të organizohet në cilëndo fushë të veprimtarive njerëzore dhe nuk kërkon pajisje të posaçme. Ekipi nuk është njësoj si edhe grupi i individëve që punon diçka. Secili ekip posedon role specifike të përkufizuara me vizion të përbashkët dhe me aftësi të nevojshme për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta. Ajo që për ekipin është karakteristike, është se pavarësisht ndarjes së përgjegjësisve dhe të roleve, anëtarët e ekipit e ndihmojnë njëri tjetrin dhe japin sugjerime për secilin segment të procesit të punës.

Shtojca “Puna ekipore” .

**Analiza kritike** – është proces me të cilin nxitet dhe mbështetet zhvillimi dhe shfrytëzimi i zotësisë së mendimit kritikë. Shkathësia e mendimit kritikë përfshinë hulumtimin, interpretimin, prezantimin dhe refleksionin. Ajo përfshinë procesin e krijimit të mendimit vetjak , mësimin si të shprehet ajo dhe nëse nevojitet e korrigjon. Analiza e gjendjes në shkollë, analiza e mediave, diskutimet, puna në projekte e mënyra të ngjashme, janë metoda të cilat e ndihmojnë analizën kritike.

**Përsiatja** është proces me anë të së cilit individ apo grupi shqyrton aktivisht atë që ka ndodhur. Pa përfshirjen e aktiviteteve të përsiatjes, ai i cili mëson mund ta humbë rastin real për ta zhvilluar të kuptuarit e vet. Aktivitetet në të cilat është përfshirë përsiatja, midis tjerash janë, shfrytëzimi i ditareve, shënimeve, evidencave, këmbimi në grupe të vogla të asaj që ka ndodhur ose që është mësuar.

**Hulumtimi** ka të bëjë me mësimin dhe zbulimin. Ky është proces me anë të së cilit idetë dhe çështjet hulumtohen, analizohen dhe këmbehen. Hulumtimi në arsimim mund të kontribuojë në kuptimin më të madh të procesit të mësimin.

**Veprimi** mbështetet në kuptimin e asaj që po ndodh. Mund të vepohet në shkollë, në bashkësi lokale, si dhe në nivel global.

*Nxënësit në klasën e V do të kenë rastin të mësojnë dhe punojnë në mënyrë ekipore, hulumtuese dhe duke mbledhë të dhëna të cilat pastaj do t'i analizojnë në mënyrë kritike, kurse mësimdhënësit do të kenë rastin t'i udhëheqin ata nëpër atë proces.*

## **2.2. Principet themelore të mësimit/ të mësuarit**

### **Të mësuarit interaktiv/ mësimi**

Të mësuarit interaktiv nënkupton procedimin e ndërlikuar i cili synon të "imitojë" procesin e njohurisë çfarë zhvillohet në rrethanat autentike të jetës, e shpie drejtë një përjetimin të tërësishëm të përvojës së përdorshme e të qëndrueshme.

Në procesin interaktiv të mësimit, realizohet bashkëpunimi midis mësimdhënësit dhe nxënësit, dhe kjo në formën e konstruktimit të përbashkët, ndërtimit të përbashkët të njohurive të reja dhe në formën e aktiviteteve të mësimdhënësve dhe nxënësve që janë komplementare, domethënë të cilat plotësohen. Tek mënyra interaktive e punës kjo arrihet me anë gjetjes së fazave kyçe të planifikuara, drejtuara, kondensuara dhe me kohë të shkurtuar të këtij mësimi:

- nxënësit më së pari futen në kontekst të temës me të cilën dëshirojmë të merremi;
- krijohet situata e cila iu mundëson të gjithëve që të marrin pjesë aktive në hulumtimin dhe gjetjen e zgjidhjeve për problemin e shtruar;
- me anë të diskutimit këmbehen, sqarohen, saktësohen dhe modelohen përvojat;
- sillet në lidhje me dijet ekzistuese dhe përgjithësohet;

Rrethanat e ndërlikuara në të cilat zhvillohet një mësim i tillë dhe numri i madh i elementeve që duhet përgatitur dhe kontrolluar, janë një arsye se pse para mësimdhënësit shtrohen kërkesa të veçanta. Arsyeja tjetër del nga fakti që interaktiviteti nënkupton përfshirjen aktive të të gjithë nxënësve dhe të drejtën të komentojnë, ekspozojnë qëndrimet e veta, thellojnë, sqarojnë, rishikojnë, kontestojnë, kundërshtojnë... Së këndejmi është e nevojshme që mësimdhënësi të ketë dije të mjaftueshme, shkathtësi e siguri, të jetë i pajisur me gjithë atë që do t'ia mundësojë që, tërë rrjedhën e mësimit interaktiv, ta zhvillojë me sukses.

Të mësuarit interaktiv përfshinë shumë më tepër fenomene se sa ky grumbull i teknikave të cilat mund të quhen këshu. Secili aktivitet mund të organizohet individualisht ose në grupe, por qasja e tërësishme në punë, konsiston në procesin e mësimit dhe krijimin e lidhjeve midis metodës, përmbajtjes dhe moshës së fëmijëve.

### **Principet e mësimit**

Arsimimi efektiv për demokraci dhe shoqëri qytetare realizohet me anë të pjesëmarrjes aktive në zotërimin e dijenive nëpërmjet shumë kanaleve - nga mediumet e ndryshme, ambienti i afërm e i largët i jetesës. Me këtë rast shfrytëzohen më shumë shqisa dhe angazhohen funksione të llojllojshme psikike, fitohen rezultate më të mira dhe të qëndrueshme.

- **Të mësuarit është konstruksion aktiv i dijes**
  - ✓ nevojitet aktiviteti vetjak
  - ✓ përvoja dhe veprimtaria praktike
  - ✓ këmbimi me njerëz të tjerë
- **Nxënësit mësojnë në mënyra të ndryshe**

Procesi i mësimdhënies duhet përshtatur

  - ✓ tipeve të ndryshme të mësimit
  - ✓ stileve të ndryshme të mësimit
  - ✓ tipeve të ndryshme të personalitetit të nxënësve

- **Mësimi është**
  - ✓ **Proces shumëdimensional:** emocional, kognitiv, i dëshiruar, social.
  - ✓ **Procesi gradual:** motivimi, nxënia e informatave dhe e dijes.
  - ✓ **Proces integral:** ndërlidhje me përvojën e mëparshme e të ardhshme.
  - ✓ **Proces kontekstual:** zhvillohet me anë të interaksionit në kontekst.

### 2.3. Planifikim i mësimit/orëve EQ

Hapi i parë në realizimin e programit të lëndës së Edukatës qytetare është **planifikimi i mësimi** i cili duhet të jetë i orientuar kah nxënësit. Që kjo të arrihet merren në konsideratë elementet vijuese:

- Të përgatiten kushtet për mësimin dhe të mësuarit
- Të shtrohen objektivat dhe të përzgjidhen përmbajtjet
- Të zhvillohet procesi i mësimi dhe të përzgjidhen format e mësimi
- Të notohen dhe përcillet përparimi i nxënësve

#### **Të përgatiten kushtet për mësimin dhe të mësuarit**

Kur ta planifikoni mësimin, është me rëndësi të keni pasqyrën e qartë mbi kushtet për mësim dhe për të mësuar, duke u nisur nga karakteristikat e klasës dhe të gjithë nxënësve veç e veç. Nxënësit lypset t'i njihni dhe kuptoni ata në gjithë dallimet e tyre: aftësitë dhe shkathtësitë e tyre të ndryshme, anët e forta e të dobëta, mënyra e përsiatjes, qëndrimet dhe interesimet, si dhe **karakteristikat zhvillimore të asaj moshe**. ( Shtojcë “Karakteristikat zhvillimore të nxënësve të klasës së pestë”).

Kushtet për mësim duhet analizuar në harmoni me qëllimet që dëshironi t'i realizoni me anë të mësimi. Ashtu, me rastin e përzgjedhjes së detyrave dhe përmbajtjeve, do të merrni në konsideratë njohjen tuaj të karakteristikave të fëmijëve veç e veç, si dhe të klasës në tërësi. Përpos kësaj, shfaqni kujdes edhe për kushtet e jashtme në të cilat zhvillohet mësimi. Që të ia lehtësoni vetvetes këtë hap në planifikim, mund t'i shfrytëzoni disa pyetje kyçe:

- Cilat dijeni dhe shkathtësi posedojnë nxënësit e mi?
- Çfarë janë njohuritë dhe shkathtësitë e mia?
- Cilat kushte të jashtme lypset t'i kem parasysh?

#### **Shtroni objektivat dhe përzgjidhni përmbajtjen**

Ky hap në planifikim paraqet vendimin e rëndësishëm që e merr mësimdhënësi. Objektivat, detyrat dhe përmbajtjet thjeshtë nuk mund të rimerren. Ato lypset të hulumtohet, sqarohen dhe arsyetohen. Kjo do të thotë se objektivat lypset të harmonizohen me kushtet dhe përmbajtjet e përzgjedhura.

Pyetjet kyçe janë:

- Prej cilave përmbajtjeve nisem?
- Çfarë u intereson nxënësve të mi në këtë përmbajtje?
- A është i ndërlidhur të mësuarit në shkollë me mësimin jashtë shkollës?

#### **Përzgjedhja e përmbajtjes**

Planifikimi dhe përzgjedhja e përmbajtjeve mësimore është detyrë pretenduese edhe pse udhëhiqeni nga planprogrami mësimor. Lypset të keni pasqyrën e përmbajtjeve të ndryshme, t'i kuptoni ato, analizoni, t'i vlerësoni me kritikë, t'i përzgjidhni dhe t'i vini në

kontekst të kushteve dhe objektivave. Këtë punë është më mirë ta bëni në bashkëpunim me kolegët tjerë dhe më fëmijët e prindërit e tyre.

Pyetjet kyçe janë:

- Prej cilave përmbajtjeve nisem?
- Çfarë u intereson nxënësve të mi në këtë përmbajtje?
- A është i ndërlikuar të mësuarit në shkollë me mësimin jashtë shkollës?

### **Të zhvillohet procesi i të mësuarit dhe të përzgjidhet forma e mësimit**

Procesi i mësimit është shumë i ndërlikuar, kërkon përsiatje serioze në mënyrë që të planifikohen format e mësimit, detyrat mësimore dhe mënyra e punës. Prandaj, zhvillimi i procesit të mësimit si dhe përcjellja e nxënësve, është detyrë që kërkon më së shumti të cilën mësimdhënësi ia shtroni vetvetes (Shtojcë “Teoria e inteligjencës së shumëfishtë, nga Gardneri). Pyetjet kyçe janë:

- Cili proces i të mësuarit do t’u mundësojë nxënësve të arrijnë objektivat?
- Si ta mundësojë zotërimin gjithëpërfshirës, përpunimin dhe të mbajturit mend?
- A qëndron në situatën e planifikuar të mësimit synimi në zotërimin e informatave, përpunimin e informatave dhe mbajtjen mend apo zbatimin?

Si ndihmë, me rastin e zgjedhjes së formave, përmbajtjeve të mësimit, mund t’ju shërbejë tabela vijuese me mënyrat e të mësuarit të fëmijëve, varësisht nga fakti se cilat aftësi i kanë të zhvilluara.

### **Të notohet dhe përcillet përparimi i nxënësve**

Tek planifikimi i mësimit duhen siguruar mënyrat e përcjelljes së përparimit të nxënësve, efikasiteti dhe cilësia e mësimit si dhe masat për përmirësimin e rezultateve të të mësuarit tek fëmijët. Nevojitet t’i mendoni mirë instrumentet dhe kriteret në bazë të së cilëve do ta vlerësoni dhe notoni përparimin e nxënësve tuaj. Pyetjet kyçe janë:

- Si të provohen dhe notohen rezultatet e nxënësve?
- Si të zbatohet vetënotimi dhe notimi nga ana e tjerëve?
- A i mbështes nxënësit në ndërtimin e imazhit pozitiv të aftësive personale, dhe a janë të vetëdijshëm për avancimin në të mësuar?

## **2.4. Objektivi, detyrat dhe përmbajtja e programit**

### **Objektivi**

**Objektivi** i përgjithshëm i programit është aftësimi i nxënësve për pjesëmarrje aktive në jetë, me shtrirjen e njohurive praktike mbi demokracinë, principet dhe vlerat e saj në nivel të funksionimit të shkollës.

Përmbajtjet dhe mënyra e punës lypset të nxisin tek nxënësit gatishmërinë për pjesëmarrje aktive në jetën e përditshme, para se gjithash në shkollë, dhe t’i fus në kuptimin e procedimeve dhe të principeve që shfrytëzohen në proceset demokratike.

Me këtë rast është e rëndësishme të realizohen këto detyra.

### **Detyrat**

- që nxënësit t’i njohin rregullat dhe procedurat shkollore;
- që nxënësit të futën në kuptimin e funksionimit të organeve drejtuese të shkollës dhe të trupave profesionale;
- që nxënësit të njihen me të drejtat dhe përgjegjësitë e të gjithë aktorëve në nivel të shkollës;

- që tek nxënësit të zhvillohen shkathtësitë komunikuese të domosdoshme për sjellje prej bashkëpunëtori, argumentimin e qëndrimeve dhe shprehjen e mendimeve;
- që nxënësit të stërvitën në teknikat e punës grupore;
- që tek nxënësit të zhvillohet aftësia e gjykimit kritikë dhe të vendimmarrjes e veprimit të përgjegjshëm;
- që nxënësit të nxiten dhe aftësohen për pjesëmarrje aktive në jetën e shkollës me zhvillimin e shkathtësitë për avancimin e kushteve të jetës shkollore me anë të praktikës.

## **Përmbajtja**

Tema I: Njohja e elementeve themelore të programit

Tema II: Kundrimi i kushteve të jetës shkollore

Tema III: Përzgjedhja e problemit në të cilin do të punojnë

Tema IV: Mbledhja e të dhënave mbi problemin e përzgjedhur

Tema V: Aktivizmi dhe participimi - plani i aksionit

Tema VI: Prezantimi publik i planit të aksionit

Tema VII: Vështrimi i të mësuarit dhe evaluimi i programit

## 2.5. SHTOJCAT

### SHTOJCA MËSIMI NË GRUPIN E MOSHATARËVE

Të mësuarit është proces i ndërtimit aktiv të dijes dhe i ndryshimit të sjelljes së personit që mëson. Të mësuarit është në lidhje të pashkëputshme me ndryshimet e përgjithshme zhvillimore, mbështetet në aftësitë e rritura dhe kthyeshëm ndikon në ndryshimin e atyre aftësive. Format e ndryshme të të mësuarit u përgjigjen fëmijëve të moshave të ndryshme, ndërsa bebet shfrytëzojnë format elementare të të mësuarit (kushtëzimin klasik dhe instrumental, imitim), ndërsa fëmijët në moshë më të madhe kanë aftësi të shfrytëzojnë forma më të përsosura të të mësuarit të cilat përfshijnë aktivizimin kuptimor, operacionet formale politike, planin e brendshëm. Kuptohet se fëmijët mësojnë në të gjitha situatat, më shumë spontanisht, dhe pak a shumë me qëllim. Ekzistojnë forma të ndryshme të të mësuarit me ndihmën e moshatarëve, dhe veçohen dy forma të të mësuarit.

**FORMA E BASHKËPUNIMIT** është formë e të mësuarit me ndihmën e moshatarëve dhe konsiderohet për nga njohuritë, formë më produktive e interaksionit. Pikërisht bashkëpunimi midis fëmijëve veçohet si formë e ndërlikuar e të mësuarit në interaksion me moshatarët, aksionet e fëmijëve janë të orientuara kah objektivi i përbashkët, shumë shpesh janë të harmonizuara, dhe fëmijët marrin pjesë që problemi të zgjidhet me partneritet.

**FORMA E MËSIMDHËNIES** është të mësuarit ku një fëmijë mundohet të japë mësim - e udhëheq fëmijën tjetër, me rastin e kryerjes së ndonjë detyre.

Disa autorë konsiderojnë se të mësuarit është proces i participimit social. Ekziston qëllimi i ndonjë personi të mësojë, kurse rëndësia e të mësuarit formësohet me anë të procesit të ekzistimit të shumë pjesëmarrësve në praktikën socio-kulturore.

#### ***Ideja e të mësuarit në situata siguron direktiva të rëndësishme për praktikën:***

1. të mësuarit është lidhja midis nxënësve; ajo që ndodh në kushtet të cilat i afrojnë njerëzit dhe organizojnë kontakte të tilla, i cili bën që pjesët e caktuara të informatave të bëhen të rëndësishme; pa sistem të rëndësisë nuk ka mësim dhe nuk ka as shumë të mbajtur mend.
2. ekziston lidhja midis dijes dhe aktivitetit; të mësuarit është pjesë e jetës së përditshme; zgjidhja e problemeve dhe të mësuarit nga përvoja bëhen procese qendrore.

#### ***Është me rëndësi të mos harrojmë se fëmijët mësojnë dhe njihen në mënyra të ndryshme:***

- Fëmija mëson duke luajtur. Në lojë i zhvillon të gjitha potencialet. Në lojëra roli e tejkalon vetveten, decentrohet, zhvillon mendimin kuptimor.
- Me anë të përvojës vetjake, me anë të angazhimeve personale. Në bazë e të gjitha formave të të mësuarit është mësimi me përvojë. Me praktikim fitohen të gjitha shkathtësitë dhe shprehitë: motorike, komunikative dhe ekspresive.
- Fëmija mëson sipas modelit (imitimit, të mësuarit me anë të vëzhgimit, modelimit, me identifikim). Në këtë mënyrë e zhvillon sjelljen, raportet me njerëzit, mënyrën e veprimit e ngjashëm si këto.
- Fëmija e mëson zgjidhjen e problemeve. Me këtë formë të të mësuarit zhvillohet mendimi, zotësia e ballafaqimit me problemin, zhvillohet strategjia e zgjidhjes së problemeve, zhvillohen alternativat.
- Fëmijët mësojnë me anë të zbulimeve – me maturi, manipulim, me oscilim, eksperimentim. Kjo është rruga e arritjes së zbulimeve, shpikjeve vetjake, me anë të

të cilave përpos angazhimit mendor, forcohet vetësiguria, përjetohet gëzimi, habia, dhe e gjithë kjo kontribuon në qëndrimin pozitiv ndaj të mësuarit.

- Fëmija mëson interaktivisht nga fëmijët tjerë – moshatarët dhe të rriturit. Në paralele, në grupe të vogla e të mëdha. Grupi është burim i ndryshimeve për fëmijën. Zhvillimi i pabarabartë i grupit është shans për zhvillim.
- Fëmija mëson duke krijuar; krijimin, ndërtimin, konstruktimin. Me aktivitete të tilla zhvillohen sjelljet divergjente të cilat çojnë në fuqizimin e aftësive krijuese.
- Fëmija mëson në vende të ndryshme dhe nga njerëz të ndryshëm, në natyrë, në vendet historike, në objektet e kulturës, shkencës, nëpër muze, në objektet sportive...
- Fëmija mëson kudo, me shikim, dëgjim, pjesëmarrje.

## **SHTOJCA PUNA EKIPORE**

- është angazhim i përbashkët i sinkronizuar i ekspertëve të profileve të ndryshme apo të njëjta ose i specialistëve në detyrën e njëjtë,
- mund të organizohet në cilëndo fushë të veprimtarive njerëzore,
- nuk kërkon paisje të veçantë.
- nuk është njësoj si edhe grupi i individëve i cili punon diçka.

Secili ekip posedon role specifike të përkufizuara me një vizion të përbashkët dhe me aftësitë e nevojshme për zgjidhjen e problemeve veç e veç. Dikush në ekip do të realizojë kontakte, dikush do të mbledhë informata, dikush do të shtypë vendimet dhe materialet e përbashkëta, dikush do të punojë në mbajtjen e energjisë dhe entuziazmit, dikush ta rregullojë hapësirën për takime...Aftësitë që nevojiten për drejtimin e punës ekipore janë të llojllojshme dhe për secilin ka vend. Ajo që është karakteristike për ekipin është se, pavarësisht ndarjes së përgjegjësisë dhe roleve, anëtarët e ekipit e ndihmojnë njëri-tjetrin dhe japin sugjerime për çdo segment të procesit të punës.

Në literaturën e cila merret me punën ekipore, ekzistojnë disa ndarje të roleve në ekip. Disa autorë rolet i analizojnë globalisht, duke e shikuar ekipin pavarësisht nga opinioni dhe lloji i detyrës me të cilën merren. Një kategorizim i tillë i rolit që mund të gjenden në çdo ekip është sa vijon:

***PJESËMARRËSI AKTIV*** është ai anëtar i ekipit që është i orientuar në detyrën, dhe i cili rolin e vet e sheh në atë që të gjejë informatat më të mira mbi problemin me të cilin merret. Ai gjithashtu merret me përkufizimin e objektivave dhe shfaq kujdes mbi cilësinë e përbushjes së detyrimeve. Mundohet që të gjithë bashkë të jenë sa më efektiv.

***BASHKËPUNËTORI*** është ai anëtar i ekipit i cili është fleksibil dhe i gatshëm të hidhet kudo që nevojitet. Është i hapur për përvoja dhe ide të reja. Fut entuziazëm dhe përpos detyrës, për të janë të rëndësishëm edhe anëtarët e tjerë të ekipit dhe cilësia e marrëdhënieve ndërnjerëzore.

***KOMUNIKUESI*** është anëtar i ekipit i cili i nxit bisedimet dhe më së shumti merret me atmosferën e punës në ekip. Ai veçanërisht është i dobishëm në fazat e para të punës ekipore: i nxit të gjithë anëtarët për pjesëmarrje, është dëgjues i mirë, krijon atmosferë të mirë, i lehtëson marrëveshjet e përbashkëta.

**SFIDUESI** është anëtar i ekipit i cili është kritikë ndaj të gjithë objektivave, metodave, zgjidhjeve dhe vendimeve të ekipit. Edhe pse kjo nuk është lehtë përherë të përballohet, ky është anëtar shumë i çmueshëm i ekipit sepse është i gatshëm për rrezik, kultivon sinqeritet, i nxit të tjerët të flasin mbi problemet e veta dhe mund të ndryshojë diçka në mënyrën e zakonshme të funksionimit, në qoftë se kjo i nevojitet ekipit.

Të katër profilet e përmendura është e dëshirueshme t'i ketë secili ekip. Nuk do të vlente që ekipet kategorikisht të përbëhen nga **bashkëpunëtorët** dhe **komunikuesit** - kjo do t'i kthente në detyrë!; nuk do të vlente që ekipet të përbëhen nga **pjesëmarrësit aktivë** dhe **sfiduesit** - kurrë nuk do të arrinte konsensus! Me një fjalë, ekipit i nevojiten funksione të ndryshme, sepse pikërisht ato mundësojnë që të gjithë proceset e punës së ekipit të aktivizohen. Në qoftë se në ekip nuk ekziston ndonjëri nga funksionet e përmendura, ndoshta nevojitet të thirret ndonjë anëtar i ri.

Autorët e tjerë merren më shumë në mënyrë praktike, përta u përket roleve në ekip dhe lidhur me llojin e punës të cilën e bën ekipi. Këta autorë rolet i ndajnë në punuese (më shumë lidhur me punën të cilën e bëjnë) dhe shoqërore (më shumë lidhur me interaksionin). Lista bazike e roleve, sipas tyre, duket kështu:

#### DALLIMET MIDIS GRUPIT DHE EKIPIT

EKIPI		GRUPI
Objektivat e përbashkëta të dakorduara	OBJEKTIVAT	Objektivat individuale e të paharmonizuara
Aksionet janë të ndërvarura e të harmonizuara	AKTIVITETI	Aksionet e pavarura individuale ose grupore
Ndarja e qartë e roleve dhe përgjegjësi	ROLET	Individët udhëheqin situatën dhe marrin role varësisht nga zgjedhjet personale
Ekziston përgjegjësia individuale dhe e përbashkët	PËRGJEGJËSIA	Kryesisht ekziston përgjegjësia individuale
Suksesi dhe mossauesi ndahet në pjesë të njëjta	SUKSESI	Individi mund të jetë i suksesshëm, por jo edhe grupi



Ekipi ka rregullat e veta, mekanizmat dhe procedurat e vendimmarrjes	VENDOSJA	Rregullat e procedurat munden, por s'është e thënë të ekzistojnë, të miratohen nga situata në situatë
Secili mund t'i ketë idetë e veta, por nevojitet gatishmëri që nga ajo të hiqet dorë kur përzgjidhet zgjidhja më e mirë	PUNA E PËRBASHKËT	Individët mund të kenë ide dhe aksione të pavarura
Anëtari ri i ekipit futet sipas procedurës së njëjtë si edhe anëtarët ekzistues	FORCA	Anëtarët e grupit munden lirisht t'i bashkohen ose ta braktisin grupin

## SHTOJCA

### MËSIMI ME ANË TË PROJEKTEVE SI FORMË E TË MËSUARIT AKTIV

Në kuadër të mbajtjes së mësimit në lëndën e Edukatës qytetare, nxënësit bashkë me mësimsdhënësin janë të përfshirë në realizimin e një projekti. Mësimi i cili realizohet me anë të projekteve është formë shumë e rëndësishme e punës në shkollë dhe është mjaft e dobishme që programi shkollor të jetë fleksibil, e jo i fiksuar, që një formë e tillë e mësimit të mund të realizohet. Në projekt nxënësit kanë mundësi të përzgjedhin temën të cilën do ta studiojnë dhe ta hartojnë dizajnin e projektit (si do të punojnë në zgjidhjen e problemit të shtruar), me ç' rast në mënyrë të pavarur i mbledhin informatat e rëndësishme, e organizojnë materialin, i analizojnë të dhënat dhe i prezantojnë rezultatet e punës së vet. Është me rëndësi të theksohet se është e domosdoshme të përgatiten nxënësit për këtë metodë të të mësuarit/mësimit, është e pamundshme që atyre t'u jepet vetëm problemi (apo tu jepet që ta zgjedhin të pavarur) dhe të lihen të punojnë vetë. Me rastin e përzgjedhjes së problemit është e domosdoshme që mësimsdhënësi ta eklipsojë çdo hap duke shtjelluar e diskutuar me fëmijët. Është me rëndësi që:

- ta përzgjedhë temën
- të shohë çfarë është e nevojshme që të merren me këtë temë - cili material, mjete, të dhënat,
- të shohë ku mund të gjendet materiali i nevojshëm – qasja e burimeve të dhënave,
- të shoh përdorimin e materialit të mbledhur për gjetjen e strategjisë për zgjidhjen e problemit të përzgjedhur,
- e punon strategjinë e punës për zgjidhjen e problemit të shtruar,
- e përgatit prezantimin e punimit,
- e harton evidencën e asaj që është kryer me informatën e saktë kthyesë.

Arsyet për t'u krijuar kushtet në praktikën shkollore që të aplikohen dhe ekzekutohen projektet janë këto:

- u mundësojnë nxënësve aplikimin e dijeve të fituara, që është një nga objektivat edukativo-arsimore,
- zhvillojnë dhe ushtrojnë më shumë funksione kognitive tek nxënësit (organizimi, sinteza, analiza dhe evaluimi i materialit),

- zhvillojnë kompetenca të rëndësishme sikurse janë inventiviteti (shpikja), aftësia e zgjidhjes së problemeve, aftësitë integruese (sinteza e ideve, e përvojave dhe e informatave nga burimet e ndryshme dhe fushat e ndryshme),
- zhvillojnë shkathtësi të vendosjes dhe të vendimmarrjeve (vendimmarrja çfarë është e rëndësishme e çfarë jo, çfarë duhet të hyjë në punë e çfarë jo),
- nxisin aftësitë e udhëheqjes së proceseve vetanake të punës (aftësia që në mënyrë të pavarur të kryhet një punë më e ndërlikuar, aftësia e marrjes së iniciativës)
- nxisin aftësitë e komunikimit efektiv me të tjerët (bashkëpunimi efektiv dhe këmbimi me të tjerët – Të mësuarit aktiv 2, Ivan Iviq, Ana Peshikan, Sllobodanka Antiq, Instituti për psikologji, 2001.

Puna në projekt i motivon nxënësit për të mësuar dhe punuar duke ju ofruar aktivitete që për ta janë të nevojshme dhe që ju interesojnë. Nxënësi ka më shumë përgjegjësi për të mësuarit e vet, ka një rol shumë më aktiv. Nxënësit fitojnë autonomi më të madhe dhe kanë mundësi më të madhe ta drejtojnë procesin e vet të të mësuarit, që është parakusht i rëndësishëm për fitimin e mëtejshëm të njohurive dhe, para se gjithash, aplikimin e njohurive të fituara dhe të zotësisë në jetën reale.

## **SHTOJCA**

### **KARAKTERISTIKAT ZHVILLIMORE TË NXËNËSVE TË KLASËS SË PESTË**

Periudha e zhvillimit në të cilën gjenden nxënësit njëmbëdhjetëvjeçarë, në psikologji është përkufizuar si periudhë e para-adoleshencës. Ose, më thjeshtë, fillim i pubertetit. Specifika e kësaj periudhe është se ndryshimet tek fëmijët janë shprehimisht të shpejta, dinamike dhe të bujshme, e ndodhin në të gjitha nivelet - në nivelin fizik, të njohjes, emocional dhe social.

**Ndryshimet fizike:** rritja e lartësisë dhe peshës, e skeletit dhe muskujve, pjekuria e sistemit themelor fiziologjik, pjekuria e sistemit endokrin, zhvillimi i sistemit nervor.

**Ndryshimet emocionale:** manifestimi i bujshëm i emocioneve, zbrazje impulsive, mungesa e kontrollit të emocioneve, reagim i bujshëm dhe tejet i theksuar, paaftësia për të ndjerë dhe kuptuar gjendjet emocionale të të tjerëve, pamundësia e këmbimit, ndarjes, e ballafaqimit dhe familjarizimit në ndjenja, para se gjithash në relacionet me të rriturit, kundruall simbiozave “afektive” me moshatarët me të cilët ndajnë ndjenja të njëjta.

**Ndryshimet e njohjes:** dukuria e mendimit formal – abstrakt; si pasojë e këtyre mundësive të njohjes lindin mendimet e para serioze mbi krijimin e botës, kozmopolitizmin, apokalipsin, mbi trungun familjar, vlerat, politikën...krijohen teori mbi vetveten, gjurmohet identiteti...

**Ndryshimet sociale:** përgatitet rimarrja e përgjegjësisë për jetë të pavarur në shoqëri në të gjitha segmentet e saj.

## **SHTOJCA**

### **TEORIA E INTELIGJENCËS SË SHUMFISHTË, E GARDNERIT**

Huard Gardner e ka kundruar inteligjencën si aftësi e zgjidhjes së problemit apo të menduarit mirë të prodhimit që janë të çmuar në një apo shumë ambiente kulturore. Gardner më parë e ka formuluar listën prej shtatë inteligjencash. Dy të parat janë ato të cilat zakonisht vlerësohen në shkollë, tri të tjerat janë zakonisht të ndërlidhura me artin, kurse dy të fundit Gardner i ka quajtur inteligjencë personale.

**Inteligjenca linguistike** përfshinë ndjeshmërinë për gjuhën e folur e të shkruar, aftësinë për mësimin e gjuhëve, mundësinë që të shfrytëzohet gjuha për arritjen e ndonjë objekti. Kjo

inteligjencë përfshinë aftësinë që të shërbehet me efektivitet me gjuhën në shprehjen retorike e poetike dhe që gjuhën ta shfrytëzojë si mënyrë e të mbajturit mend të informatave. Shkrimtarët, poetët, avokatët dhe oratorët janë, sipas Gardenrit, persona me inteligjencë linguistike të lartë.

**Inteligjenca logjike matematikore** përbëhet nga aftësitë që problemet të analizohen logjikshëm, që të bëhen operacione matematikore dhe që të hulumtohen problemet shkencërisht. Sipas Gardnerit, ajo përfshinë aftësinë që të zbulohen modelet, përfundon me deduksion dhe mendon logjikisht. Kjo inteligjencë më shpesh është e ndërlidhur me mendimet shkencore e matematikore.

**Inteligjenca muzikore** përfshinë shkathtësitë e ekzekutimit, kompozimit dhe vlerësimit të modeleve muzikore. Ajo i orienton aftësitë që të dallohen dhe të kompozohen tonalitetet dhe ritmet muzikore. Sipas Gardnerit, inteligjenca muzikore, për nga mënyra strukturore, është gati krejtësisht paralele me inteligjencën linguistike.

**Inteligjenca trupore-kinestetike** përfshinë potencialin e shfrytëzimit të gjithë trupit dhe pjesëve të trupit në zgjidhjen e problemeve. Kjo është shkathtësi e shfrytëzimit të aftësive mentale që të bashkërendohen lëvizjet e trupit. Gardner konsideron se aftësitë mentale e fizike janë të lidhura ngushtë.

**Inteligjenca sociale** përfshinë potencialin që të dallohen dhe shfrytëzohen modelet, si të hapësirës së gjerë ashtu edhe të kufizuar. Ajo iu mundëson njerëzve që të punojnë me efektivitet me tjerët. Mësimdhënësve, shitësve, udhëheqësve religjiozë e politikë u nevojitet inteligjenca inter-personale e zhvilluar mirë.

**Inteligjenca inter-personale** përfshinë aftësinë e kuptimit të vetvetes, pranimin e ndjenjave, frikësimeve dhe motiveve vetjake. Sipas Gardnerit, ajo përfshinë posedimin e modelit efektiv punues të vetvetes dhe shfrytëzimin efektiv të atyre informatave, në drejtimin e jetës personale.

**Inteligjenca interpersonale** ka të bëjë me aftësinë për t'u kuptuar qëllimet, motivet dhe dëshirat e njerëzve tjerë. Ajo u mundëson njerëzve të punojnë më me efikasitet me tjerët. Mësimdhënësve, punëtorëve prijësve religjioz e politik u nevojitet inteligjendja interpersoanel e zhvilluar mirë.

#### TETË MËNYRA TË TË MËSUARIT

Fëmijët që kanë aftësi të zhvilluara shumë	mendohen	DUAN	u nevojitet
linguistike	me fjalë	leximi, të shkruarit i tregime i përrallave, lozja e lojërave gjuhësore	libra, kaseta, garniturë për shkrim, letër, ditarë, bisedimet, debatet, diskutimet, tregimet
logjike matematike	me përfundim	eksperimentimi, ekzaminimi, zgjidhja e enigmave, llogaritja	material për eksperimentim, materiale shkencore, gjëra manipulim, ekskursionet në planetarium dhe muzeu shkencor

<b>spaciale</b>	në fotografi	dizajnimi, vizatimi, vizuelizimi, shkarravitja	arti, katrorë lego, video filma, slajde, lojëra me mendim, labirinthe, shtresimet, libra të ilustruar, ekskursionet në mezeje artistike
<b>truporo kinestetike</b>	me anë të ndjenjave trupore	vallëzim, vrapim, kërcim, ndërtim, përkim, gjestikulim	lozja e roleve, drama, lëvizjet, gjërat për ndërtim, sport dhe lojëra fizike, përvoja taktike, mësimi duke treguar
<b>muzikore</b>	me anë të ritmeve dhe melodive	këndimi, fishkëllimi, këndimi ngadalë, duartrokitje dhe rrapëllimë me këmbë, dëgjimi	koha për këndim, vizita e koncertit, muzika në shtëpi e në shkollë, instrumentet muzikore
<b>interpersonale</b>	me reflektimin e ideve të njerëzve tjerë	paraprirja, organizimi, vënia në lidhje, manipulimi, argëtimi	miqtë, lojërat grupore, tubimet shoqërore, ngjarjet në bashkësi, klubet, metrotë/punë kallfe
<b>intrapersonale</b>	në raport me nevojat e veta	shtrimi i objektivave, mediatimi, ëndërimi, planifikimi, reflektimi	vendet sekrete, koha në vetmi, projektet pa kufizim kohor, mundësia e zgjedhjes
<b>natyrore</b>	me anë të natyrës dhe forma natyrore	loja me kanakarët shtëpiakë, kopshtaria, hulumtimi i natyrës, rritja e shtazëve, kujdesi ndaj planetit	përshtatja natyrës, mundësia për interaksion me shtazët, vegla për hulumtimin e natyrës (p.sh. thjerrzat, dylbitë)

Garnder pohon se këto shtatë lloje të inteligjencës rrallë funksionojnë të pavarura. Ato shfrytëzohen njëkohësisht dhe kanë tendencë ta plotësojnë njëra-tjetrën si gjatë zhvillimit të aftësive, ashtu edhe me rastin e zgjidhjes së problemeve.

Gardner paraqet dy pohime esenciale mbi inteligjencën e shumëfishtë:

1. Teoria është paraqitje e kognicionit (njohurisë) njerëzor në tërësi. Inteligjencia e shumëfishtë ofron “definicionin e ri të natyrës njerëzore lidhur me çështjen e kognicionit”. Qenia njerëzore është organizëm i cili posedon një grumbull bazik të inteligjencës.
2. Njerëzit posedojnë përzierjen unike të inteligjencave. Gardner pohon se është sfidë e madhe në aplikimin e resurseve njerëzore, “si të shfrytëzohet uniteti që na është dhënë si racë (lloj) që i shpreh disa inteligjenca, në mënyrën më të mirë të mundshme.”

Këto inteligjenca janë amorale – mund të shfrytëzohen edhe për qëllime konstruktive edhe destruktive.

Në punimet më të vonshme Gardner ka shtuar në listë edhe dy lloje të inteligjencës.

**Inteligjenca natyrore** u mundëson qenieve njerëzore ta dallojnë, kategorizojnë dhe t’i krahasojnë karakteristikat e caktuara të mjedisit. Ato “kombinojnë përshkrimin e aftësive esenciale me karakterizimin e rolit të cilin e çmojnë shumë kultura”.

**Inteligjenca ekzistenciale** shfrytëzohet në hulumtimin e natyrës së ekzistimit në format e veta të shumta.

Teoria e Hauard Gardnerit mbi inteligjencën e shumëfishtë nuk është përfaquar menjëherë në qarqet e psikologjisë akademike. Mirëpo, hasi në përgjigje të fuqishme pozitive të mësimdhënësve. E përfaquan me gatishmëri shumë teoricienë të arsimit dhe e kanë aplikuar mësimdhënësit dhe njerëzit të cilët merren me çështjet e shkollimit.

Nga ana tjetër, në shikim të parë kjo teori ka vepruar si dënim me vdekje ndaj arsimimit formal klasik. Ka qenë mjaft vështirë t'ua mësosh një lloj të inteligjencës, shtrohet pyetja se si t'ia bësh tek me nëntë? Është mjaft vështirë t'ua mësosh, madje edhe kur gjithçka mund të mësohet; e si do të ndodhë nëse ekzistojnë kufijtë e qartë dhe kufizimet e fuqishme në të kuptuarit dhe të mësuarit njerëzor?

Gardner jep përgjigje në këto pyetje me vërejtjen se psikologjia nuk dirigjon direkt arsimimin, por vetëm ndihmon që të kuptohen kushtet në të cilat zhvillohet arsimimi. Aq më tepër, inteligjenca e shumëfishtë u jep mësimdhënësve mundësi për shumë mënyra të ndryshme të mësimin, në vend të vetëm një mënyre. Edhe kufizimet që ekzistojnë në tru mund të shfrytëzohen për futjen e disa nocioneve (apo të tërë sistemit të të menduarit) sipas mënyrës në të cilën nxënësit këtë do ta mësojnë dhe përvetësojnë më lehtë. Paradoksale, kufizimet mund të jenë sugjестive dhe tejet çliruese.

Ekzistojnë arsyeje të shumta të reagimit pozitiv të mësimdhënësve ndaj paraqitjes së inteligjencës së shumëfishtë të Gardnerit. Teoria argumenton përvojat e përditshme të mësimdhënësve: nxënësit mendojnë dhe mësojnë në shumë mënyra të ndryshme. Gjithashtu, ajo u jep mësimdhënësve kornizën logjike për organizimin dhe vështrimin e notimit e të praktikës pedagogjike. Si revansh, ky vështrim i shtyu shumë mësimdhënës të zhvillojnë qasje të reja të cilat do t'u bëjnë ballë më mirë nevojave të nxënësve me tipet e ndryshme të të mësuarit.

Nga punimet e Gardnerit mund të nxirren tri aspekte që i përkasin arsimimit dhe nënkuptojnë:

**Vizionin e gjerë të arsimimit.** Të gjitha inteligjencat janë të nevojshme për të jetuar mirë. Prandaj, mësimdhënësit lypset t'i kultivojnë të gjitha inteligjencat, e jo vetëm dy të parat nga lista, mbi të cilat janë kujdesur tradicionalisht. Ky vizion ia mundëson mësimdhënësit ta zgjedhë “gjerësinë në vend të thellësisë”. Të kuptuarit nënkupton se dijenia e fituar në një ambient, mund të shfrytëzohet në ambientin tjetër. “Nxënësit lypset të kenë mundësi të gjera për ta përpunuar një temë.”

**Zhvillimi i programeve lokale e fleksibile.** Angazhimet e Gardnerit për “kuptimin e thellë”, arritja, hulumtimi dhe kreativiteti nuk mund të aplikohet lehtë në kuadër të kurrikulumit të detjuar të “dorëzuar”, të planifikuar jashtë kontekstit të arsimimit imediat. “Teza e inteligjencës së shumëfishtë anulohet nëse kurrikulumit është tepër i ngurtë, apo nëse ekziston vetëm një formë e notimit.”

**Shikimi në moralin.** “Duhet të sajojmë mënyrë që inteligjenca e morali të funksionojnë bashkë”, pohon Gardner, “që të mund të krijojmë botën në të cilën dëshirojnë të jetojnë njerëz të ndryshëm. Ndonëse ekziston mirëqenia e konsiderueshme në zhvillimin e kuptimit të lëndëve arsimore, nevojitet diç më tepër.

## **Përfundim**

Teoria e Hauard Gardnerit e ka ngritur cilësinë e arsimimit. U ka ndihmuar një numri të madh të mësimdhënësve ta rishikojnë punën e tyre dhe i ka inkurajuar të shikojnë përtej kufizimit të ngushtë të rrjedhave dominuese të mësimdhënies, planifikimit e programimit dhe të notimit.

Është bërë hulumtimi i cili ka treguar se ekziston leverdi e konsiderueshme nga aplikimi i kësaj teorie lidhur me arritjet në testin përfundimtar, me pjesëmarrjen e prindërve dhe me disiplinën. Nëse merret parasysh se teoria e Gardnerit për inteligjencën e shumëfishtë u ka ndihmuar mësimdhënësve për ta rishikuar punën e tyre, u ka mundësuar atyre t'i shtrijnë horizontet dhe të kultivojnë atë që mund t'u ndihmojë njerëzve për të jetuar më mirë, atëherë ajo mund të konsiderohet kontribut i dobishëm.

Gjatë hulumtimit janë konstatuar disa karakteristika themelore të shkollës në të cilat aplikohet me sukses teoria e inteligjencës së shumëfishtë:

**Kultura: mbështetja e llojeve të ndryshme e të të mësuarit dhe punës së mundimshme.**

Mbështetet mbi sistemin me vlerë i cili mundëson që nxënësit e ndryshëm të mësojnë në mënyra të ndryshme dhe të arrijnë sukses, dhe që të mësuarit për ta të jetë i pëlqeshëm. Gjithashtu, nxit dhe e vlerëson punën e mundimshme të mësimdhënësit.

**Vegla:** Inteligjenca e shumëfishtë është mënyrë që të kultivohet puna me cilësi të lartë. Shfrytëzimi i inteligjencës së shumëfishtë duhet të shërbejë si vegël për promovimin e punës me cilësi të lartë të personelit mësimor, e jo si teori e cila i mjafton vetvetes.

**Bashkëpunimi:** këmbimi joformal dhe formal. Këmbimi i ideve dhe i propozimeve konstruktive të personelit mësimor në situatat formale e joformale.


**Zgjedhja:** kriter i sajuar dhe mënyrat e ndryshme të notimit. Inkorporimi i aktiviteteve të cilat i çmojnë nxënësit njësoj dhe bashkësia e gjërë kulturore në kurikulum dhe notim.

**Arti:** Shfrytëzimi i artit për zhvillimin e shkathtësive të nxënësve dhe të kuptimit brenda dhe midis lëndëve.

### 3. UDHËZIM PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT

Skenarët e punishteve që pasojnë janë dhënë si propozim, një nga variantet e mundshme. Ju mbetet juve t'ua përshtatni nevojave të nxënësve tuaj në harmoni me mundësitë e shkollës dhe ambientit shkollor. Punishtet janë konceptuar në mënyrë të tillë që disa mund të realizohen në kuadër të një ore shkollore, e disa në kuadër të dy orëve. Nëse dy orëshi nuk është i mundshëm, është propozuar se ku mund të ndërpritet punishtja. Në një numër të punishteve janë cekur shembujt të disa lojërave edukative, ndërsa për numrin më të madh të punishteve ato nuk janë specifikuar. Zgjedhja e aktiviteteve të lojërave do të varet nga dinamika dhe karakteristikat e grupit.

<sup>2</sup> Literatura që ofron zgjidhje të madhe të aktiviteteve për lojëra: Joviq, Kuveliq: “Si të krijohet atmosfera e mirë për të mësuar”, botues Qendra kreative; Musiq, Marjanoviq: “303 lojëra dhe aktivitete për edukim”, botues Propolis plus; Kovaç-Ceroviq, Popadiq: “Mësonjëtorja e vullnetit të mirë”, botues Grupa Most.



6  
orë

## NJOHJA E ELEMENTEVE KRYESORE TË PROGRAMIT



**MIRATIMI I RREGULLAVE**



**90 minuta**



**Njohja e nxënësve  
Miratimi i përbashkët i rregullave të sjelljes**

### 1. Njoftimi – 10 minuta

Nxënësit rrinë ulur në rreth, secili e thotë emrin e vet dhe një veti të veten me të cilët mburret (mësimdhënësi rri ulur dhe e nis duke thënë emrin dhe vetinë e vet).

### 2. Aktiviteti hyrës – loja Valle - 5 minuta

Instrukcioni: Të gjithë do të kapemi për dore. Secili le të mendohet në cilin drejtim do të kthehet në shenjën time. Është me rëndësi që të mos i lëshojmë duart kur fillojmë vallen.

### 3. Diskutimi – 5 minuta

Diskutimi mbi atë çfarë ka ndodhur, çfarë është dashur të bëhet që të mos krijohet rrëmujë, çfarë do të ndodhte sikur të kishte ekzistuar marrëveshja në cilën anë të nisemi...Loja përsëritet me hapat e dakorduar.

### 4. Përmbledhja e mësimdhënësit – 5 minuta

Rregullat i rregullojnë marrëdhëniet, të drejtat dhe detyrimet e secilit individ në ndonjë bashkësi. Sikurse edhe në lojën tonë “Valle,” nëse sjellja në shkollë do t'i lëhej vullnetit të secilit individ pa dakordim, do të shkaktohej kaos. Rregullat në shkollë janë të rëndësishme që të gjithëve t'iu mundësohen pa pengesa të mësuarit cilësor cilësor dhe avancimi, shoqërimi e argëtimi..

### 5. Puna në grupe - 20 minuta

Gjatë vitit do të njihemi më afër me të drejtat dhe përgjegjësitë e të gjithë aktorëve në jetën shkollore me anë të studimit të dokumenteve e masave të ndryshme dhe propozimin e disa zgjidhjeve për avancimin e punës në shkollë. Është me rëndësi të nxjerrim rregulla të përbashkëta të sjelljes së grupit tonë, që secili nga ne duke respektuar të tjerët të kontribuojë në realizimin e suksesshëm të asaj që është planifikuar për këtë vit shkollor, Nxënësit ndahen në katër grupe. Detyra është që secili grup të propozojë nga tri rregulla që janë të rëndësishme për atë. Përgatiten edhe arsyetimet përse mendojnë se një rregull i caktuar është qenësor.

**VËRREJTJE: NËSE NUK MUND TË ORGANIZOHET DY ORËSHI, KËTU PUNISHTJA MUND TË NDRËPRITET**

### 6. Raportimi i grupeve – 25 minuta

Mësimdhënësi i shënon rregullat e propozuara dhe tri katër të parat më shpesh përqafohen si rregulla të paraleles të cilat do të respektohen.

### 7. Vështrim i shkurtër i mësimdhënësit në procesin e miratimit të rregullave- 5 minuta:

Rregullat janë rezultat i ujdisë. Në miratimin e rregullave duhet të marrin pjesë të gjithë. Nëse është e nevojshme rregullat mund të ndryshohen, me ujdi të përbashkët.

### 8. Loja për fund- 15 minuta

Nevojitet që mësimdhënësi paraprakisht t'i presë letrat në formë të fletës së drurit dhe në një letër të madhe ta vizatojë lisin. Nxënësit do t'i lusë të shëtisin nëpër lokal dhe të shikojnë njëri-tjetrin. Në shenjën e mësimdhënësit “stop” të gjithë duhet të ndalen me personin me të cilin në atë moment po shikoheshin. Ashtu në çifte lypset për dy minuta t'i gjejnë dy gjëra apo veti që i kanë të përbashkëta (çfarë duan, nga çfarë frikësohen, cilin film e kanë më të pëlqyer, çfarë muzike dëgjojnë, cilën lëndë e duan më shumë...). Nxënësit e shënojnë në listë atë që e kanë të përbashkët dhe e ngjisin në lis. Pastaj përsëritet kjo me çiftet e tjera derisa lisi nuk merr kurorë. Sipas mundësive të ruhet dhe të lihet druri i punuar ashtu në një vend ku shihet.





## TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË



45 minuta



### Njohja e Konventës mbi të drejtat e fëmijës



Shtojcë 1. Kartat e të drejtave

Shtojcë 2. Konventat mbi të drejtat e fëmijës

Shtojcë 3. Të vërtetat dhe lajthitjet mbi të drejtat e fëmijës

#### 1. Hyrje – 5 minuta

Mësimdhënësi ua rikujton nxënësve Konventën mbi të drejtat e fëmijëve dhe e ndërlydh atë me dijet që nxënësit i posedojnë tashmë. Konventa mbi të drejtat e fëmijëve është dokumenti i cilin e ka miratuar Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 1989, dhe paraqet katalogun gjithëpërfshirës të drejtave të fëmijëve me qëllim që të mbrohet dhe avancohet pozita e fëmijës në botë.

Të gjitha të drejtat të përmendura në Konventë janë njësoj të rëndësishme dhe u përkasin të gjithë fëmijëve, pavarësisht nga gjinia e tyre, besimi fetar, prejardhja nacionale apo ndonjë status tjetër i fëmijës.

Të gjitha shtetet nënshkruese të Konventës kanë marrë detyrimin dhe përgjegjësinë që këto të drejta t'i garantojnë, të sigurojnë kushte për zbatimin e tyre pa pengesa dhe t'i mbrojnë ato në rastet kur janë rrezikuar. Shteti ynë është nënshkrues i Konventës mbi të drejtat e fëmijëve, që do të thotë se Konventa është bërë pjesë përbërëse e ligjeve tona.

Këto të drejta askush nuk mund të na i japë ose marrë, sepse na takojnë me vetë lindjen. Kufizimet e vetme që kemi në aplikimin e të drejtave tona janë të drejtat e të tjerëve. Kështu, për shembull, kemi të drejtë për shprehje të lirë, por kjo nuk do të thotë se kemi të drejtë të fyejme të tjerët.

#### 2. Puna në grupe – 25 minuta

Secilit grup t'i jepen kartat e kopjuara të të drejtave. Nxënësit lypset t'i grupojnë kartat sipas ngjashmërisë dhe të sajojnë se cilin emër të përbashkët mund tua japin secilit grup të të drejtave.

#### 3. Raportimet e grupeve dhe përmbledhja – 15 minuta

Pas raportimeve të grupeve, mësimdhënësi ua vë në pah nxënësve faktin se është me rëndësi që t'i njohin të drejtat e veta, por gjithashtu është me rëndësi që ato të aplikohen e respektohen.



## PARTICIPIMI Ç' ËSHTË KJO?



45 minuta



### Njohja e nocionit të participimit Të kuptuarit e rëndësisë së informimit

#### 1. Asociacionet - 5 minuta

Mësimdhënësi: Kur unë e them fjalën participim - çfarë mendoni fillimisht, çfarë ju kujton kjo? Gjatë numërimit, mësimdhënësi i shënon të gjitha përgjigjet e nxënësve, pa komentim. Mësimdhënësi mbështetet në përgjigjet e nxënësve dhe e sqaron domethënien e termit participim. Në këtë mund të ndihmojë komentit në vijim: participimi nënkupton çdo aktivitet me të cilin përfshihemi aktivisht, marrim pjesë në zgjidhjen e disa çështjeve të rëndësishme për ne dhe ashtu ndikojmë në cilësinë e jetës tonë. Nxënësve mund tu thuhet edhe se fjala participim ka prejardhje latine dhe domethënë pjesëmarrje, marrje pjesë, me pas pjesë.

#### 2. Puna në grupe – 20 minuta

Mësimdhënësi thekson se për participimin e përgjegjshëm paraprakisht nevojitet informim i mirë mbi temën në mënyrë që të mund të ofrojmë disa propozime konstruktive dhe të marrim pjesë në zbatimin e tyre. Nxënësit ndahen në katër grupe dhe secili grup i merr pyetjet e shkruara në të cilat lypset të përgatisë përgjigjet.

1. Si i merrni informatat në shkollë?
2. Nga kush kërkoni informata në shkollë kur ju intereson diçka?
3. Cekni një shembull nga shkolla juaj kur janë bërë lëshime në informim dhe cilat kanë qenë pasojat?

### 3. Raportimet e grupeve – 15 minuta

4. Mësimdhënësi përfundon se në çdo bashkësi ekziston sistemi i rregulluar i informimit dhe plotëson nëse nxënësit nuk kanë cekur diçka nga sistemi i informimit të shkollës së tyre në prezantimet e veta. Informimi i gabueshëm ose jo i plotë vazhdimisht ka pasoja të dëmshme dhe pengon procesin e marrjes së vendimeve. Është me rëndësi të dimë ku mund të kërkojmë informatat e sakta e të plota, në bazë të së cilave mund të marrim vendime përgjegjëse.



## PJESËMARRJA E NXËNËSVE NË JETËN E SHKOLLËS



45 minuta



### Kuptimi i mundësive dhe i rëndësisë së pjesëmarrjes së nxënësve në jetën shkollore



#### Shtojcë 4. Pyetjet e mundshme me të cilat mund të merren nxënësit

#### 1. Puna në grupe – 25 minuta

Nxënësit mund të ndahen në grupe në këtë mënyrë: mësimdhënësi e mban një vandak (tufë) me shirita. Nga dy shirita (apo litra) paraprakisht të lidhen me ndonjë pe të trashë. Nxënësit afrohen dhe secili e merr nga një skaj të shiritit. Kur secili e ka skajin e vet në dorë, mësimdhënësi e lëshon vandakun, kurse nga katër nxënës mbeten të lidhur me shirita. Mësimdhënësi u tregon nxënësve se me përfshirjen e tyre aktive në avancimin e jetës shkollore, mësojnë sesi mund të japin kontributin e tyre në ndryshimet që dëshirojnë t'i shohin. Në mënyrë që nxënësit të shprehën vetë se si dhe pse lypset të marrin pjesë në avancimin e jetës shkollore, secili merr pyetjet e shkruara në të cilat lypset të përgatisë përgjigjet.

1. Në cilat çështje dhe probleme nga jeta shkollore marrin pjesë nxënësit?
2. Në cilat çështje dhe probleme lypset të marrin pjesë nxënësit?
3. Si dhe në çfarë mënyrë nxënësit mund të marrin pjesë në krijimin dhe avancimin e jetës shkollore?
4. Pse është e rëndësishme që nxënësit të marrin pjesë në krijimin dhe avancimin e jetës shkollore?

#### 2. Raportimi i grupit – 15 minuta

#### 3. Përfundimi i mësimdhënësit -15 minuta

Mësimdhënësi i strukturon përgjigjet e nxënësve me anë të Shtojcat 4.



## FORMIMI I EKIPIT TË KLASËS



45 minuta



### Njoftimi i nocionit të punës ekipore



#### Shtojca 5. Regjistri i lojërave për ndërtimin e ekipit Shtojca 6. Pyetjet për zhvillimin e diskutimit mbi punën ekipore


#### 1. Aktiviteti hyrës – lojëra për formimin e ekipit - 25 minuta

Mësimdhënësi e organizon me nxënësit lojën për ndërtimin e ekipit (shihe Shtojcën 5. Regjistri i lojërave për ndërtimin e ekipit).

#### 2. Diskutimi – 20 minuta

Pas mbajtjes së lojës me fëmijët, mësimdhënësi organizon diskutimin mbi:

1. procesin
2. raportet dhe
3. rezultatin e punës ekipore në ushtrimin e mëparshëm (shihe Shtojcan 6. Pyetjet për zhvillimin e diskutimit mbi punën ekipore)



4  
orë

## KUNDRIMI I KUSHTEVE TË JETËS SHKOLLORE



**PROBLEMET NË SHKOLLË**



**90 minuta**



**Aftësimi i nxënësve për të vërejtur problemet  
në shkollë**

### 1. Aktiviteti hyrës – loja anija dhe shkëmbi – 5 minuta

Një nxënësi vullnetar i janë lidhur sytë, kurse të tjerët sistemohen në paralele si shkëmbinj në det. Nxënësi që i ka sytë e lidhur lypset të kalojë nga njëri skaj i klasës në skajin tjetër e të mos i mëshojë shkëmbit. Të tjerët i ndihmojnë në mënyrë të tillë që kur u afrohet nxënësi me sy të lidhur, ushtojnë si deti për ta paralajmëruar se përpara tij është shkëmbi dhe duhet ta ndërrojë drejtimin e lëvizjes. Komenti i mësimdhënësit: Në jetë ekzistojnë pengesa e probleme të ndryshme. Nëse i dëgjojmë sinjalet rreth nesh dhe ambientit tonë, ekzistojnë mënyra që ato pengesa të evitohen me sukses dhe të arrihet qëllimi.

### 2. Shfletimi i problemeve – 15 minuta

Mësimdhënësi u jep instruksione nxënësve të mendojnë mbi problemet e ndryshme në shkollë. Në fletëza secili nxënës lypset t'i shkruajë të paktën tre probleme cilat do të dëshironte t'i shohë në shkollë, ose situatat dhe çështjet që do të dëshironte t'i zgjidhë, diçka që do të donte ta avanconte. Në një letër të vogël shkruhet një problem.

### 3. Puna në grupe – 25 minuta

Përzieri letrat dhe ndajuni grupeve në mënyrë të barabartë. Detyrë për secilin grup është t'i lexojnë problemet që i kanë marrë, të bisedojnë mbi to dhe t'i renditin sipas shpeshtësisë. Në letrat e mëdha përgatisin prezantimin siç që do t'i prezantojnë problemet që i kanë marrë.

VËREJTJE: NËSE NUK MUND TË ORGANIZOHET DY ORËSHI, KËTU MUND TË NDRËPRITET PUNISHTJA

### 4. Raportim i grupeve – 20 minuta

Mësimdhënësi i secilit grup i prezanton rezultatet e punës së grupit të vet.

Mësimdhënësi i shkruan të gjitha problemet e ekspozuara dhe në bazë të shpeshtësisë i rendit problemet që janë cekur.

### 5. Komenti i mësimdhënësit – 20 minuta

Mësimdhënësi përmend se në hapat e ardhshëm nxënësit do t'ë përcaktohen për një problem me të cilin do të merren gjatë vitit. Që këtë vendim të mund ta marrin si duhet, nevojitet që paraprakisht të hulumtojnë për së afërmi të gjitha këto probleme dhe të mbledhin informata të domosdoshme në bazë të të cilave mund të bëjnë zgjedhjen. Grupet lypset që deri në orën tjetër të mbledhin:

1. Informatat mbi rolin e trupave të caktuara - organeve dhe individëve në shkollë;
2. Sa më shumë informata mbi temat që i kanë numëruar.

Mësimdhënësi i jep detyrë secilit grup.

1. grupi ka për detyrë të zhvillojë bisedime me sa më shumë arsimtarë dhe të arrijë deri tek informatat nga përfaqësuesi i këshillit të klasës, këshillit të mësimdhënësve, aktiveve profesionale.
2. grupi ka detyrë të zhvillojë bisedime me përfaqësuesit e këshillit të Shkollës, drejtorin, psikologun, pedagogun dhe bibliotekarin;
3. grupi ka për detyrë të bisedojë me përfaqësuesit e Pleqësisë së prindërve, me njerëzit nga ambienti i vet më i afërt, komshinjtë, miqtë;
4. grupi ka për detyrë të zhvillojë bisedime me sa më shumë nxënës, përfaqësues të Lidhjes së fëmijëve, të Parlamentit apo të ndonjë organizate tjetër të nxënësve.

Për marrjen sa më të lehtë të informatave nxënësit mund t'i shfrytëzojnë këto pyetje:

- Çfarë bëni dhe me çfarë merreni?
- A jeni përfaqësues i ndonjë trupi në kuadër të organizatës shkollore dhe i cilit?
- Edhe kush tjetër është përfaqësues në atë trup?
- Mbi çfarë vendos ai trup, cilat janë kompetencat e tij?
- Cilët pjesëmarrës në jetën shkollore mund të merren me zgjidhjen e këtyre pyetjeve?
- Cilët pjesëmarrës të jetës shkollore mund të merren me zgjidhjen e këtyre çështjeve?
- Në kompetencën e kujt është zgjidhja e këtyre pyetjeve (cekni një nga një problemet)?
- A dini për ndonjërin nga këto pyetje se janë rregulluar me rregullore ose me ndonjë dokument tjetër juridik?
- A është iniciuar zgjidhja e ndonjëres nga këto pyetje?
- Në çfarë mënyre mund të zgjidhen disa nga këto pyetje?
- Ku dhe nga kush mund të mblidhen informata shtesë mbi këto pyetje?

Në fund mësimdhënësi thekson se me rastin e mbledhjes së të dhënave, nevojitet të tregohet kujdes mbi këtë:

- caktoni takimin përpara,
- merruni vesh kush do të zhvillojë bisedën, e kush do të shënojë,
- në fund falënderojeni përzemësisht...



**MBLEDHJA E TË DHËNAVE  
MBI PROBLEMET SHKOLLORE  
Puna në terren**



**sipas nevojës**



**Nxitja e raportit aktiv ndaj mbledhjes së të dhënave  
Ushtrimi i shkathtësive komunikuese dhe i punës ekipore**

Në këtë periudhë nxënësve iu duhet mundësuar të mblidhin sa më shumë të dhëna mbi problemet e vërejtura.



**RAPORTIMI DHE DISKUTIMI  
MBI TË DHËNAT E MBLEDHURA**



**90 minuta**



**Përgatitja e nxënësve për zgjedhjen e një problemi  
në të cilin do të punojnë**

1. Puna në grup – 30 minuta

Në grupet që i kanë mbledhur informatat, nxënësit bisedojnë si ka kaluar mbledhja e të dhënave, a ka ekzistuar ndonjë kuriozitet, çfarë ka qenë e vështirë e çfarë e lehtë. I përgatisin informatat që i kanë mbledhur për njoftimin e nxënësve të tjerë.

2. Raportimi i gupeve – 25 minuta


**VËREJTJE: NËSE NUK MUND TË ORGANITOHET DY ORËSHI, RAPORTIMI I GRUPEVE TË NDAHET NË DY ORË**

3. Diskutimi - 25 minuta

Mësimdhënësi organizon diskutimin. Disa nga pyetjet që mund të shfrytëzohen janë:

1. Çfarë keni mësuar mbi problemet nga njerëzit me të cilët keni biseduar?
2. Cilat probleme janë më urgjente për tu zgjidhur?
3. Cilat probleme ju brengosin më së shumti?
4. Në cilat probleme ju mund të ndikoni?

4. Loja për fund- 10 minuta



## ZGJEDHJA E PROBLEMIT NË TË CILIN DO TË PUNOHET



**ZGJEDHJA E PROBLEMIT  
TË PËRBASHKËT**



**90 minuta**



**Të praktikuarit e mënyrës demokratike të marrjes  
së vendimeve**

Vërejtje: Zgjedhja korrekte e problemit është jashtëzakonisht e rëndësishme për punë të mëtejshme, prandaj është e domosdoshme që t'i kushtohet vëmendje shtesë. Është me rëndësi që të gjithë nxënësit të kenë ndjenjën se ai është problemi i tyre i përbashkët dhe nevojitet të bashkëpunojnë dhe hulumtimin e mëtejshëm. Mësimdhënësi lypset tu ndihmojë nxënësve që me rastin e zgjedhjes të shikojnë me kujdes çdo problem të vërejtur nga anët e ndryshme.

### 1. Puna në grupe – 25 minuta

Mësimdhënësi përmend se nevojitet të përzgjidhet një problem në të cilin do të punojnë nxënësit gjatë vitit shkollor. Formohen grupet ashtu që nxënësit të mos jenë në grupe të njëjtë si me rastin e mbledhjes së të dhënave. Grupet lypset të zgjedhin dy probleme për të cilët konsiderojnë se janë më të qenësishëm për zgjedhje, duke pasur parasysh të gjitha informatat që i kanë marrë në orët e mëhershme dhe të përgatisin prezantimin e argumentuar të propozimeve të veta. Ndihmë në përkufizimin e argumenteve mund të jenë këto pyetje:

1. A është ky problem i shkollës tonë?
2. Cilin ndryshim dëshironi ta realizoni me zgjidhjen e këtij problemi?
3. Për kënd ky ndryshim do të jetë me rëndësi?
4. Cilët janë pjesëmarrësit në jetën shkollore të cilët mund të merren me këtë problem?
5. A është problemi i zgjidhshëm?
6. Cilat janë mënyrat për zgjidhjen e tij?
7. Sa njerëz konsiderojnë se problemi është qenësor?

### 2. Propozimi dhe argumentimi – 20 minuta

Secili grup propozon nga dy probleme dhe paraqet argumentet për propozimet e veta. Mësimdhënësi i shkruan të gjitha problemet e propozuara në letër të madhe- tabelë.


**VËREJTJE: NËSE NUK MUND TË ORGANIZOHET DY ORËSHI, RAPORTIMI I GRUPEVE TË NDAHET NË DY ORË**

### 3. Votimi – 25 minuta

Secili nxënës del dhe voton për një problem duke vënë ndonjë shenjë pranë tij në letrën e madhe. Në qoftë se shumë probleme fitojnë numër të njëjtë të votave, për ato probleme votimi përsëritet. Përzgjidhet problemi që fiton më shumë vota.

### 4. Përfundimi i mësimdhënësit - 20 minuta

Biseda mbi përshtypjet dhe ndjenjat e nxënësve me rastin e zgjedhjes dhe aplikimit të procedurës demokratike në zgjedhjen e problemit. Mësimdhënësi thekson se të gjithë nxënësit kanë pasur rastin të propozojnë dhe diskutojnë mbi pyetjet të cilat për to janë të rëndësishme. Duke i pyetur të tjerët mbi rëndësinë e zgjidhjes së këtyre pyetjeve, kemi fituar pasqyrën mbi problemet që i kemi përmendur se ekzistojnë në shkollën tonë. Tani kemi arritur së bashku tek fakti se çfarë është më e rëndësishme për tu zgjidhur për momentin.



8  
orë

## MBLEDHJA E TË DHËNAVE MBI PROBLEMIN E PËRZGJEDHUR



**BURIMET E TË DHËNAVE**



**45 minuta**



**Njohja e burimeve të ndryshme të të dhënave**

1. Aktiviteti hyrës – loja për bashkëpunim – 5 minuta

2. Puna në grupe – 20 minuta

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në katër grupe dhe secili grup merr detyrën të cekë sa më shumë burime të të dhënave që janë relevante për problemin e zgjedhur.

Nxënësit mund të përgjigjen në disa nga pyetjet vijuese në kuadër të grupeve të veta:

- Kush mund të jetë burim i të dhënave mbi problemin e zgjedhur?
- Me kë mund të bisedojmë?
- Ku mundemi akoma të gjejmë të dhëna?

3. Raportimi i grupeve – 20 minuta

Derisa zgjat raportimi, mësimdhënësi harton listën e burimeve të të dhënave dhe bashkë me nxënësit e plotëson listën sipas nevojës:

Individët apo shërbimet – stomatologu shkollor, polici shkollor, sekretari, personeli teknik, shërbimi financiar, mediatekari, redaktori i revistës shkollore...

Burimet e shkruara - dispozitat, procesverbalet, literatura profesionale, mediat e shtypura, interneti...



**TEKNIKAT DHE MËNYRAT E  
MBLEDHJES SË TË DHËNAVE**



**90 minuta**



**Hartimi i instrumenteve për mbledhjen e të dhënave  
dhe problemin e përzgjedhur**

1. Hyrje - 5 minuta

Mësimdhënësi i fton nxënësit që të kujtojnë burimin i të dhënave nga ora e kaluar (shfrytëzohet pankarta me të njejtin burim)

2. Puna në grupe – 20 minuta

Nxënësit nëpër grupe marrin detyrën të hartojnë pyetëtorin për marrjen e të dhënave nga burime të ndryshme që sipas tyre janë relevante për problemin e zgjedhur.

3. Raportimi i grupeve – 20 minuta

VËREJTJA: NËSE MUND TË ORAGNIZOHET DY ORËSHI, RAPORTIMI I GRUPEVE TË NDAHET NË DY ORË

4. Puna në ifte – korrigjimi i pyetësorit – 15 minuta

Nxënësve u propozohet që në qifte t'i analizojnë pyetësorët e prezantuar dhe pas kësaj të propozojnë korrigjime të nevojshme.

5. komunikimi – 25 minuta

Nxënësit komunikojnë korrigjimet dhe merren vesh mbi formën përfundimtare të pyetësorit.

6. Loja për fund – 5 minuta



## USHTRIMI NË MBELDHIJEN E TË DHËNAVE



90 minuta



### Përgatitja e nxënësve për mbledhjen e të dhënave me anë të simulimit

#### 1. Hyrja – 5 minuta

Që nxënësit të përgatiten sa më mirë për bisedë të mirëfilltë , lypset të ushtrojnë shfrytëzimin e instrumenteve që i kanë punuar në orët e mëparshme. Nevojitet ta përfytyrojnë situatën në të cilën do t'i luajnë rolet sikur zhvillohet bisedë e vërtetë. Qëllimi është që me anë të simulimit të parashikohen vështirësitë e mundshme dhe mënyrat e tejkalimit të tyre.

#### 2. Puna në grupe – 30 minuta

Nxënësit përgatisin simulimin e situatave të mundshme në mbledhjen e të dhënave.

#### 3. Simulimi i detyrës – 30 minuta

Nxënësit nëpër grupe i paraqesin situatat që i kanë përgatitur.

VËREJTJE: NËSE NUK MUDNET TË ORGANIZOHET DY ORËSHI, RAPORTIMI I GRUPEVE TË NDAHET NE DY ORË

#### 4. Diskutimi dhe analiza e simulimit – 20 minuta

Mësimdhënësi bisedon me nxënësit mbi situatat e treguara. Pyetjet vijuese mund të shfrytëzohen në bisedë me nxënësit:

1. Ajeni të kënaqur me situatën prezantuar?
2. A keni pasur ndonjë vështirësi dhe si i keni tejkaluar?
3. A konsideroni se në këtë mënyrë dot ë mblidhni informata të mjaftueshme?
4. A do të ndryshonit diç kur të zhvilloni bisedat?

#### 5. Komentit përfundimtar i mësimdhënësit – 5 minuta

Mësimdhënësi rikujton mbi çka duhet shfaqur kujdes me rastin e mbledhjes së të dhënave:

1. Merruni vesh rreth ndarjes së roleve: kush do të thirr kush do ti zhvillojë bisedimet, kush do ti shënojë përgjigjet...
2. Caktoni bisedat paraprakisht- shumica e njerëzve nga të cilët do të kërkoni të dhëna ka mjaftë obligime. Prandaj është me rëndësi që të merreni vesh paraprakisht për kohën dhe vendin...
3. Gjatë bisedimeve të shfaqet kujdes mbi këtë:
  - Prezantohuni- thoni si quheni, nga vini dhe cekni qëllimin e bisedës;
  - Shikoni bashkëbiseduesin në sy gjatë bisedës;
  - Falënderojeni për zemërsisht në fund të bisedës;



## MBLEDHJA E TË DHËNAVE MBI PROBLEMIN E ZGJEDHUR puna në terren



sipas nevojës



### Nxitja e raportit aktiv ndaj të dhënave të mbledhura Ushtrimi i shkathtësisë së komunikimit dhe punës ekipore

Në këtë periudhë nxënësve iu duhet mundësuar të mbledhin sa më shumë të dhëna mbi problemin e zgjedhur



## ANALIZA E PROCESIT TË MBLEDHJES SË TË DHËNAVE



45 minuta



### Evaluimi i punës në terren

#### 1. Hyrje – 5 minuta

Mësimdhënësi përmend se për vazhdimin e punës në mbledhjen e të dhënave me rëndësi është që nxënësit të bisedojnë çfarë kanë arritur në mbledhjen e të dhënave, si dhe të këmbëjnë idetë mbi tejkalimin e pengesave në të cilat kanë hasur.

#### 2. Detyra individuale – 10 minuta

Secili për vete e shkruan në një letër të vogël se çfarë ka qenë e lehtë kur ka mbledhur të dhënat, kurse në letrën tjetër çfarë ka qenë e rëndë. Letrat i ngjisin në pankarta të cilat i kanë përgatitur për këtë.

#### 3. Diskutimi – 25 minuta

Mësimdhënësi lexon nga pankarta se çfarë ka qenë e lehtë gjatë mbledhjes së të dhënave e çfarë e vështirë dhe organizon diskutimin mbi mënyrën e tejkalimit të pengesave.

#### 4. Loja në fund – 5 minuta



## RAPORTIMI MBI MBLEDHJEN E TË DHËNAVE



45 minuta



### Njohja e të dhënave të mbledhura Të praktikuarit e paraqitjes publike

#### 1. Hyrja – 5 minuta

Mësimdhënësi rikujton nxënësit se ku kanë mbërritur në punë dhe se lypset ta përgatisin raportin mbi të dhënat e mbledhura të cilat do t'ua prezantojnë nxënësve tjerë.

#### 2. Puna në grupe – 20 minuta

Nxënësit në grupe përgatisin prezantimin e materialit dhe të informatave që kanë mbledhur. Secili grup i pavarur do ta mendojë se si do të duket prezantimi.

#### 3. Raportimi i grupeve – 20 minuta



## EVALUIMI I PUNËS NË MBLEDHJEN E TË DHËNAVE



45 minuta



### Vlerësimi dhe cilësimi i punës në mbledhjen e të dhënave

#### 1. Puna në grupe – 20 minuta

Secili grup ka për detyrë të përgjigjet në pyetjet që i kanë marrë në një letër.

Pyetjet mund të jenë:

- A dini më shumë tani mbi problemin e zgjedhur?
- Sa do të na ndihmojë kjo në punën e mëtejshme?
- A kemi mundur të punojmë diçka në mënyrë tjetër?
- A kemi lëshuar diçka apo akoma duhet ta punojmë?
- A jeni të kënaqur me të dhënat që i keni mbledhur?
- A konsideroni se ato të dhëna janë të mjaftueshme për punë në problem?
- A do ta pyesni dikë tani edhe për diçka apo këtë fazë të punës e konsideroni të përfunduar me sukses?

#### 2. Raportimi i grupit – 15 minuta

#### 3. Përfundimi i mësimdhënësit – 5 minuta

Mësimdhënësi paralajmëron hapat e ardhshëm si dhe të dhënat e mbledhura që do të shfrytëzohen në punën e mëtejshme.

**Vërejtje:** Nëse ekziston akoma nevoja për mbledhjen e të dhënave, nxënësit këtë mund ta bëjnë shkurtimisht me raportim në fillim të orëve të ardhshme.

#### 4. Loja në fund – 5 minuta



## AKTIVIZMI DHE PARTICIPIMI



**PSE ËSHTË E RËNDËSISHME  
TË MARRIM PJSË**



**45 minuta**



**Thellimi i rëndësisë së nocionit participim  
Të kuptuarit e rëndësisë së pjesëmarrjes**



**Shtojca 7. Nivelet e participimit me shembuj**

### 1. Aktiviteti hyrës – 5 minuta

Mësimdhënësi: “Kur them problem (në tabelë është shkruar problemi të cilin e kanë zgjedhur nxënësit) gjëja e parë që mendoj është...”

Nxënësit e shënojnë në stiker (etiketa dekorative në mur) atë që e kanë menduar më parë kur mësimdhënësi e shqipton problemin të cilin e kanë zgjedhur dhe ngjisin stiker rreth problemit që është shkruar në tabelë me shkronja të mëdha. Varianti tjetër është që mësimdhënësi t'i shkruaj asociacionet në tabelë (nëse nuk ka stikerë për punë).

### 2. Puna në grupe – 25 minuta

Mënyra e mundshme e ndarjes së nxënësve: priteni katër fotografi të ndryshme nga gazetatat në aq pjesë sa do të duhej të kishte anëtarë të grupit. Secili nxënës e tërheq nga një pjesë të prerë. Detyra për të gjithë nxënësit është që me bashkimin e pjesëve të prera ta ngjisin fotografinë në mnëyrë korrekte. Kur ta bëjnë këtë nxënësit, pjesët e të cilëve e përbëjnë fotografinë, janë anëtarë të një grupi.

Secili grup merr kartelet në të cilat janë shkruar situatat ku nxënësit participojnë në mënyra të ndryshme (shtojca 7, kolona e djathtë). Në kuadër të grupeve të veta merren vesh se sipas cilit rend do t'i rendisin kartelet duke pasur parasysh nivelin më të ulët të pjesëmarrjes së fëmijëve në shkollë, deri tek niveli më i lartë i pjesëmarrjes së fëmijëve.

Secili grup i ngjit kartelet në letër. Kur të gjitha grupet ta kryejnë punën, i ngjisin letrat në tabelë njërin pranë tjetrës.

### 3. Diskutimi – 15 minuta

Mësimdhënësit mund t'i ndihmojnë këto pyetje në diskutim:

1. A ekzistojnë dallime në kuadër të grupeve sesi i kanë renditur kartelet?
2. Pse ndodhin dallimet (mësimdhënësi i nxit nxënësit të sqarojnë pse kartelet janë renditur në atë mënyrë)?
3. A ekziston vazhdimisht mundësia që fëmija të vendosë vetë?
4. Në cilat situata është më e madhe liria e vendosjes, e në cilat është më pak e mundshme?

### Vërejtje:

Për këtë punishte të shfrytëzohet Doracaku “Participimi/ pjesëmarrja e nxënësve” në faqen 11-13. Pjesëmarrja e plotë e nxënësve nuk është e mundshme përherë. Kjo varet nga faktorë të ndryshëm: çfarë është objekti i vendosjes, moshja e nxënësve, konteksti në të cilin merret vendimi. Mirëpo, vetë mundësia që nxënësit të kenë të drejtë të jenë të konsultuar dhe që mendimi të respektohet, mund të ndikojë në ndryshimin e situatës e cila për ata është e rëndësishme.



## NIVELI I PARTICIPIMIT



45 minuta



### Njohja e nivelit të participimit të vërtetë



#### Shtojca 8. Kartelet për nxënësit - niveli i participimit

##### 1. Aktiviteti hyrës – 5 minuta

Tu jepen grupeve prej dy-tre nxënësve nga një shkronjë prej fjalës participim, e cila është e shkruar në letër. Detyra është që ta shkruajnë një fjalë e cila ka lidhje me atë që kanë mësuar mbi participimin e që të nisë me shkronjën që e kanë fituar. Mësimdhënësi para kësaj e ka shkruar vertikalisht në tabelë fjalën PARTICIPIMI, kurse secili grup ngjit letrat pranë shkronjës së vet. Në fund mësimdhënësi i lexon fjalët e krijuara.

##### 2. Nivelet e participimit – 20 minuta

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në pesë grupe dhe secilit grup ua jep nga një nivel të participimit nga Shtojca 8. Detyra e nxënësve është që në kuadër të grupeve të japin shembuj nga përvoja e tyre që e kanë fituar për nivelet e participimit.

##### 3. Raportimi i grupeve – 15 minuta

Përfaqësuesi i secilit grup paraqet shembujt tek të cilët kanë arritur.

##### 4. Aktiviteti përfundimtar – 5 minuta

Çfarë është ajo që më bie e para ndërmend tani, kur mendoj për problemin që e kemi zgjedhur.



## AKSIONET E VOGLA SJELLIN TEK NDRYSHIMET



45 minuta



### Pamja e rëndësisë së hapave të vegjël për zgjidhjen e problemit / Kuptimi i rëndësisë së përgjegjësisë personale

##### 1. Aktiviteti hyrës – tregimi “Pyka-çorba” – 5 minuta

Secili nxënës merr paraprakisht tekstin e përgatitur të tregimit “Pyka-çorba”.

Tregimi “PYKA – ÇORBA”

I pastrehu ka shkruar nga shtëpia në shtëpi dhe ka kërkuar ushqim. Të gjithë e kanë refuzuar, derisa e ndeshi një katundar i cili i ofroi një kusi dhe pak ujë. Udhëtari e hodhi “pykën e vet magjike” në ujin që vlonte dhe u tha të gjithëve se po zien Pykë-çorbë. Tha se çorba do të ishte edhe më e mirë sikur secili kalimtar t’ia shtonte nga një përbërje e cila çorbën do ta bënte edhe më të shijshme. Kalimtarin i qitnin përbërje çorbës secili atë që kishte tek vetja (qepë, karotë, mëlmesë ...) dhe u bë çorba shumë e shijshme.

##### 2. Detyrat individuale – 5 minuta

Secili nxënës e lexon tregimin dhe me stiker shënon një gjë që mund ta punojë lidhur me problemin të cilin e kanë zgjedhur si klasë. Stikerët i hedhin në kuti, kapele, apo qese dhe mësimdhënësi i përzier stikerët.

##### 3. Puna me grupet – 15 minuta

Secili grup merr disa stikerë (të zgjedhur kuturu) i analizon dhe bën poster.

Mënyra si do ta bëj posterin është çështje e marrëveshjes së tyre.

Nxënësit vihen në situatë të të menduarit mbi mënyrat e ndryshme për zgjidhjen e problemit, si dhe të shprehen me kreativitet.

##### 4. Raportimi i grupeve – 15 minuta

Përfaqësuesi i secilit grup paraqet posterin të cilin e ka bërë grupi.

## 5. Përfundim i i mësimdhënësit – 5 minuta

Me rastin e integritimit, mësimdhënësi theksin e vë në këto gjëra:

1. është me rëndësi që kur dallohet dhe vërehet ndonjë problem secili nga ju shtron pyetje çfarë është ajo që secili nga ne mund ta bëjë;
2. çfarë është ajo që mund ta bëjnë tjerët lidhur me atë problem;
3. cilat janë mënyrat që të bëhet aksioni i përbashkët për të vepruar në problemin;
4. rëndësia e hapave të vegjël është të na shpjerin në zgjidhjen e problemit – sikur secili nga ne ta bëjë pjesën e vet lidhur me problemin që është shfaqur, siguria është më e madhe që të zgjidhet problemi (dhe të zihet çorba më e shijshme). Mund t'ia dalim kur merremi vesh dhe bashkërisht shkojmë drejt qëllimit.



### KUPTIMDHËNIA PLANIT TË AKSIONIT



45 minuta



### Kuptimi i rëndësisë së vizionit për planifikimin e aksionit / Nxitja e qëndrimit pro-aktiv

#### 1. Hyrja – 5 minuta

Mësimdhënësi e cek rëndësinë e vizionit për zgjidhjen e problemit.

Vizioni është projektim i të ardhmes, imazhi cilin e synojmë. Lypset pasur vizion sepse vështirë mund ti realizojmë disa gjëra nëse nuk jemi të gatshëm ti shohim si mund të duken ato në të ardhmen. Nikolla Teslla më parë e ka “menduar mirë” motorin e vet induktiv dhe tek pastaj e ka konstruktuar.

#### 2. Puna në grupe – 20 minuta

Mësimdhënësi e përgatit zhetonin në boja të ndryshme për aq grupe sa dëshiron të formojë.

Secili nxënës tërheq nga një zheton. Nxënësit të cilët kanë bojën njëjtë e përbëjnë një grup. Pastaj secili grup e bën imazhin në të cilin e paraqet vizionin e shkollës në të cilën është zgjidhur problemi i zgjedhur.

#### 3. Raportimi i grupeve – 20 minuta

Secili grup e paraqet vizionin e vet.



### PLANI I AKSIONIT



45 minuta



### Mbajtja e gjendjes fillestare dhe e qëllimit që duhet të arrihet në raport me problemin e zgjedhur Të vërejturit e faktorëve rëndues dhe lehtësues



### Shtojca 9. Shembulli i kornizës së planit të aksionit

#### 1. Hyrja – 10 minuta

Mësimdhënësi paraqet një kornizë të planit të aksionit me ndihmën e Shtojcat 9. Thekson rëndësinë e caktimit të situatës fillestare, caktimin e objektivit, identifikimin e faktorëve rëndues dhe lehtësues. Theksin e vë në dy mënyra të cilat mund të shfrytëzohen për realizimin më të lehtë të objektivit, në mënyrë të tillë që do të:

1. forcojmë ato forca të cilat na ndihmojnë për arritje tek objektivi;
2. dobësojmë ato forca cilat na pengojnë arritjen tek objektivi;

#### 2. Puna në grupe – 20 minuta

Secili grup harton planin e aksionit për problemin të cilin e ka zgjedhur paralelja. E definojnë gjendjen fillestare të objektivit të cilin dëshirojnë ta realizojnë dhe faktorë lehtësues e rëndues.

#### 3. Paraqitja e planit të aksionit – 15 minuta



## FINALJA E PLANIT TË AKSIONIT



90 minuta



### Të vërejturit e rëndësisë së planifikimit si hap në zgjidhjen e problemit Njohja e elementeve të rëndësishme për planifikimin e aksionit

#### 1. Lidhja me orën e mëparshme – 15 minuta

Mësimdhënësi udhëheq diskutimin mbi planet që janë prezantuar në orën e mëparshme. Disa nga pyetjet që mund t'ua shtrojë nxënësve janë:

1. Si e kemi definuar objektivin - a ka dallime midis grupeve?
2. Cilët janë faktorët lehtësues - a ka dallime midis grupeve?
3. Cilët janë faktorët rëndues – a ka dallime midis grupeve?

#### 2. Prezantimi grafik i rrugës prej gjendjes fillestare deri në cak - 10 minuta

Secili grup e merr planin e vet të aksionit nga ora e mëparshme dhe detyrën: Duke pasur parasysh gjendjen fillestare të objektivit që është parashikuar në planin e aksionit, secili grup lypset të diskutojë mbi rrugën nga gjendja fillestare deri në cak dhe ta prezantojë grafikisht realizimin e objektivit që është shtruar në planin e aksionit.

#### 3. Prezantimi i produkteve të grupit – 10 minuta

Pasqyrimet grafike ngjiten në tabelë dhe të gjithë nxënësit ftohen t'i shikojnë produktet e grupit.

#### 4. Përkufizimi i objektivit të përbashkët – 10 minuta

Nxënësit lypset të pajtohen rreth një objektivi që duhet ta arrijnë, e i cili është më real për realizim, duke pasur parasysh faktorët lehtësues e rëndues.

VËREJTJE: NËSE NUK MUND TË ORGANIZOHET DYORËSHI, KËTU MUND TË NDËRPRITET PUNISHTJA

#### 5. Ndarja e elementeve qenësore të planit të aksionit - 25 minuta

Pjesëmarrësit ndahen në shtatë grupe dhe secili grup tërheq detyrën të cilën paraprakisht mësimdhënësi e ka shkruar në letër.

Detyrat e grupit:

1. Kujt i është dedikuar aksioni? Cilat janë grupet e interesuara?
2. A janë të nevojshme për ekzekutimin e aksionit disa mjete si pajisja, materiali?
3. A nevojitet leja e dikujt për ekzekutimin e aksionit?
4. Si do ta dimë se e kemi realizuar planin e aksionit?
5. Si do t'i ruajmë të dhënat mbi realizimin e aksionit?
6. A është domosdoshme për ekzekutimin e këtij plani të aksionit, që të zotërohen disa shkathtësi, dijeni...dhe nëse janë, cilat janë ato dije apo shkathtësi?
7. Kujt duhet t'ia prezantojmë planin e aksionit? Si do ta bëjmë këtë? Grupet përgjigjen në pyetjet e shtruara. Mësimdhënësi e ndihmon secilin grup.

#### 6. Raportimi i grupeve – 15 minuta

Secili grup i ngjet përgjigjet e veta në letrën e madhe të cilin mësimdhënësi e ka përgatitur paraprakisht.

#### 7. Përmbyllja e mësimdhënësit - 5 minuta

Mësimdhënësi e lexon që e kanë shkruar nxënësit dhe i cek elementet të cilët i kanë theksuar nxënësit.



## PLANIFIKIMI I PUNËS SË EKIPEVE



90 minuta



**Analiza e aktiviteteve konkrete në realizimin e planit të aksionit**  
Vënja në pah e ndarjes së rëndësisë së përgjegjësisë dhe e bashkëpunimit për arritje tek objektivi i shtruar



**Shtojca 10. Tabela e dinamikës kohore**

### 1. Puna në grupe – 45 minuta

Nxënësit ndahen në katër ekipe. Ekipet i zbërthejnë elementet e aksionit, dhe pas kësaj i vënë në planin kohor të aktiviteteve.

Ekipi i parë: Cilat mjete, pajisje, materiale na nevojiten?

A posedojmë ne si grup ndonjë mjet, pajisje, materiale?

A mundemi dhe çfarë mundemi të kërkojmë nga dikush? Si do të kërkojmë, si do të negociojmë? A duhet ta thërrasim dikë në ndihmë, në ato bisedime? Kë do ta thërrasim?

Ekipi i dytë: Nëse për ekzekutimin e aksionit nevojitet leja e dikujt, ky ekip e harton planin për aksion nëse do ta kërkojmë lejen dhe nga kush? Çfarë do të bënim nëse nuk e marrim lejen? Si do t'i tejkalojmë ato probleme? A na nevojitet ndihma e dikujt kur të zhvillojmë bisedime për marrjen e lejes?

Ekipi i tretë: A është e domosdoshme të zotërohen disa shkathtësi dhe dije për ekzekutimin e këtij plani aksioni dhe nëse janë, cilat janë ato dije ose shkathtësi? Kujt do t'i adresohemi që të na stërvitë në nxënien e dijeve dhe shkathtësive të nevojshme? Kush do ta zhvillojë bisedën me ata që na stërvitin?

Ekipi i katërt: Ku do të bëhet prezantimi (hapësira dhe koha)? Cilat janë qëllimet e prezantimit? (A do ta shfrytëzojmë prezantimin e planit për të vënë në pah rëndësinë e zgjidhjes së problemit, marrjen e mjeteve që janë të domosdoshme për realizimin e aksionit apo prezantimi do të bëhet me qëllim të njoftimit të të interesuarve se çfarë është bërë...) Çfarë na nevojitet për prezantim? Si do të duket prezantimi? Kë do ta thërrasim dhe si? Kur do ta bëjmë këtë dhe si? Cilat pyetje mund t'i shtrojnë publiku? Si do të përgjigjemi në to?

### Vërejtje:

Në të gjitha këto aktivitete është tepër me rëndësi roli i mësimdhënësit i cili i bashkërendon aktivitetet dhe punën në ekipe, dhe ofron informata të cilat për nxënësit janë të domosdoshme që t'i punojnë detyrat me sa më shumë sukses...

VËREJTJE: NËSE NUK MUND TË ORGANIZOHET DYORËSHI, KËTU MUND TË NDËRPRITET PUNISHTJA

### 2. Prezantimi i punës së ekipeve – 45 minuta

Ekipet i paraqesin aktivitetet e planifikuara. Mësimdhënësi ndihmon që të harmonizohen afatet dhe aktivitetet. Nxënësit i nënshkruajnë planet e veta të aksionit dhe i vënë në vende të dukshme në mësonjëto.



## REALIZIMI I AKSIONIT



sipas nevojës



**Aplikimi i përvojave dhe shkathtësive të fituara**

Pasi nxënësit në punishtet e mëparshme e kanë hartuar planin e aksionit, në këtë periudhë nxënësve iu lypset mundësuar të realizojnë aksionin që e kanë planifikuar. Mund të ndodhë që aksioni të mos mund të realizohet në tërësi në afatin e dhënë kohor, por është me rëndësi të ndërmerren hapat e parë.



## PËRGATITJA PËR PREZANTIM PUBLIK



45 minuta



### Organizimi i prezantimit publik

#### 1. Përgatitja për prezantim publik – 15 minuta

Ekipi që i ka përpunuar elementet e prezantimit publik e paraqet planin e vet. Nxënësit pastaj merren vesh rreth ndarjes së roleve:

Cilët nxënës do t'i ftojnë mysafirët?

Cilët nxënës do t'i ftojnë përfaqësuesit e mediave të shtypa dhe elektronike?

Cilët nxënës do t'i presin mysafirët, tu tregojnë ku lypset të ulen dhe tu ndajnë material?

Cilët nxënës do ta prezantojnë planin e aksionit?

Çfarë duhet akoma paraparë dhe kush do të jetë i ngarkuar për këtë?

Vërejtje:

Është me rëndësi të sigurohet që me rastin e prezantimit publik të gjithë nxënësit në paralele të jenë përgjegjës për ndonjë detyrë.

#### 2. Puna në grupe – 15 minuta.

Të ndahen nxënësit në grupe dhe tu jepet detyra ta krijojnë materialin për prezantim. Nxënësit mund ta gjejnë moton e aksionit të vet dhe të bëjnë bexhe të vogla ose të shkruajnë në kartonë të vegjël që do t'i ndajnë. Mund ta punojnë si trakt me informatat themelore, të cilin e fotokopjojnë dhe e shpërndajnë. Mund të punojnë edhe listë anketimi për mysafirët me pyetjen se në çfarë mënyre mund të ndihmojnë në aksion. Gjithashtu mund t'i shfrytëzojnë edhe vizatimet e grumbulluara, grafikonet, pankartat, fotografitë...

#### 3. Prezantimi dhe rezymimi – 15 minuta

Grupet i prezantojnë materialet të cilët do t'i shfrytëzojnë në prezantimin publik.

Mësimdhënësi i veçon momentet qenësore që janë dakorduar dhe paralajmëron për orën e ardhshme ushtrimin e prezantimit publik.



## USHRTIMI I PREZANTIMIT PUBLIK



90 minuta



### Ushtrimi i shkathtësive të prezantimit dhe argumentimit me anë të simulimit



#### Shtojca 11. Prezantimi publik

#### 1. Hyrja – 5 minuta

Qëllimi i prezantimit publik në edukatën qytetare për klasën e pestë është dhënia e mbështetjes në realizimin e planit të aksionit por edhe rast që nxënësit ta prezantojnë publikisht procesin e tërësishëm të punës në problemin përzgjedhur.

#### 2. Ushtrimi i prezantimit publik – 30 minuta

Nxënësit prezantojnë rezultatet e punës së vet, e përshkruajnë problemin, i cekin informatat tek të cilat kanë arritur dhe e paraqesin planin e aksionit.

Mënyra e prezantimit varet nga mënyra si e kanë sajuar këtë nxënësit në orët e mëparshme.

#### 3. diskutimi – 30 minuta

Pas prezantimit nxënësit që kanë qenë në rolin e publikut shtrojnë pyetje. Mund të ftohen edhe arsimtarë të tjerë apo prindër të cilët do të ndihmonin me rastin e ushtrimit të prezantimit.

#### 4. Rezymimi - 20 minuta

Prezantuesit pas bisedës me publikun propozojnë ndryshime të cilat do ta avanconin prezantimin publik.

#### 5. Loja për bashkëpunim – 5 minuta.



## PREZANTIMI PUBLIK I PLANIT TË AKSIONIT

1  
orë



### PREZANTIMI PUBLIK




45 minuta



### Prezantimi publik i procesit të tërësishëm të punës

Në marrëveshje me nxënësit duhet caktuar prezantimi publik, në bazë të planit të organizimit, në të cilin do të merrnin pjesë të gjithë nxënësit e interesuar, mësimitdhënësit, prindërit dhe përfaqësuesit e bashkësisë lokale.



## VËSHTRIMI I TË MËSUARËS -EVALUIMI

4  
orë

#### 1. Komenti hyrës i mësimitdhënësit – 5 minuta

Në procesin e të mësuarit është me rëndësi të vështrojmë atë që është punuar dhe të shohim me çfarë jemi të kënaqur dhe çfarë do të ndryshojmë tani. Me cilësimin objektiv të asaj që është punuar secili nga ne e jep kontributin e vet në zhvillimin e mësimit dhe arsimimit, e gjithashtu dijenitë e shkathtësitë e fituara mund t'i shfrytëzojmë edhe në situata të tjera të jetës.

#### 2. Puna në grupe – 10 minuta

Nxënësit ndahen në katër grupe. Secili grup lypset ti cek aktivitetet që janë realizuar prej fillimit të vitit shkollor.

#### 3. Raportimi i grupeve – 10 minuta

Mësimitdhënësi i shkruan në tabelë aktivitetet të cilat i cekin përfaqësuesit e grupeve.

Nëse nuk janë cekur të gjitha aktivitetet, mësimitdhënësi i plotëson (mësimitdhënësi i ka përgatitur përmbajtjet nga programi mësimor që janë realizuar me nxënësit gjatë vitit).

#### 4. Diskutimi – 20 minuta

Pyetjet për diskutim me nxënësit:

1. Çfarë keni mësuar t'i dhe shokët, shoqet e tua të shkollës?
2. Si e keni mësuar atë?
3. Çfarë kemi mësuar mirë ne si ekip?

VËRREJTJE: NËSE NUK MUND TË ORAGNIZOHET DYORËSHI, KËTU MUND TË NDËRPRITET PUNISHTJA

#### 5. Propozimet për avancimin e realizimit – 20 minuta

Në cilësimin e asaj që është punuar është me rëndësi të identifikohet çfarë do të punonim ndryshe që sërish të kalojmë nëpër këto aktivitete. Secili grup merr detyrën të propozojë se si për nxënësit e ardhshëm mund ta përmirësojë procesin e tërësishëm të mësimit të edukatës qytetare në klasën e pestë duke pasur parasysh përvojën nëpër të cilën kanë kaluar lidhur me:

- a) problemin të cilin do ta zgjedhin,
- b) të dhënat të cilat do t'i mbledhin mbi problemin që e kanë zgjedhur,
- c) planin e aksionit,
- d) prezantimin publik.

## 6. Kumtimi i propozimit – 15 minuta

Përfaqësuesi i secilit grup i prezanton propozimet. Nxënësit nga grupet e tjera nëse kanë mundur të japin ndonjë propozim i cili nuk është shkruar.

## 7. Përmbyllja e mësimdhënësit – 10 minuta

Mësimdhënësi i bashkon kumtesat e grupeve dhe cek se imazhi i fituar për punën e tërësishme njëvjeçare flet mbi dijeninë dhe shkathtësitë e fituara të nxënësve, si dhe mbi disa elemente që do të shfrytëzohen në punën e ardhshme me nxënës.



## EVALUIMI



45 minuta



## Cilësimi i procesit të tërësishëm të punës



## Shtojca 12. Caku i gjendjes

### 1. Hyrje – 5 minuta

Me ndihmën e teknikës së cakut të gjendjes, nxënësit e cilësojnë se çfarë kanë punuar dhe sa është arritur gjatë vitit shkollor. Cilësohen këto fusha:

1. Programi i punës;
2. Atmosfera në grup;
3. Puna e mësimdhënësit;
4. Dijet dhe shkathtësitë e fituara.

Para se nxënësit të nisin me notimin, mësimdhënësi i nxit të jenë sa më objektiv gjatë notimit.

### 2. Puna në grupe – 25 minuta

Secilit grup i ndahet caku në të cilin do të shkruhen rezultatet. Secili nxënës në grup e jep notën e vet për secilën fushë dhe e vë shenjën në hapësirën prej 1 deri 5 me ç'rast 1-shi është nota më e vogël kurse 5 më e madhe.

### 3. Kumtimi i rezultateve dhe përmbledhja - 15 minuta

Përfaqësuesi i grupit e kumton shumën e notave për secilën fushë që është cilësuar. Mësimdhënësi i shkruan rezultatet në letrën e madhe në të cilin është vizatuar caku i gjendjes dhe e kumton notën mesatare për secilin element dhe notën e fundit mesatare.



## KREMTIMI



45 minuta



## Kremtimi i të punuarit

### 1. Këmbimi i përshtypjeve – 5 minuta

Kur them edukata qytetare, gjëja e parë që mendoj është?


### 2. I kremtojmë rezultatet tona – 30 minuta

Secili nxënës ka në shpinë të ngjitur një letër të formatit A4 dhe secili ia shkruan tjetrit një gjë pozitive që e ka vërejtur tek shoku/shoqja e vet gjatë punës dhe shoqërimit në kuadër të lëndës edukata qytetare.

### 3. Dëshiroj të them atë që nuk më keni pyetur – 10 minuta

Në qoftë se ndonjëri nga nxënësit dëshiron të lexojë me zë mesazhet të cilat i janë shkruar, kjo duhet t'i mundësohet. Iu duhet ofruar mundësi nxënësve të thonë edhe diçka nëse dëshirojnë, të cilën nuk kanë pasur rast deri më tani.





# SHTOJCAT

## Shtojca 1. Kartelet e të drejtave

Neni 1: Ti je fëmijë, edhe për ty vlejnë të drejtat nga kjo Konventë derisa në tortën tënde të ditëlindjes të ndriçojnë 18 qirinj	Neni 2: Të gjitha të drejtat nga Konventa aplikohen për të gjithë fëmijët dhe të gjithë fëmijët do të jenë të mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit
Neni 3: Të gjitha procedimet që të përkasin ty do të merren për interesat tua më të mira dhe shteti do të shfaqë kujdes për ty nëse këtë nuk e bëjnë prindërit apo kujdestarët.	Neni 4: Shteti është i detyruar të sigurojë përmbushjen e të drejtave të tua të parapara me këtë Konventë.
Neni 5: Shteti duhet patjetër t'i respektojë të drejtat dhe përgjegjësitë e prindërve që të ta sigurojnë kujdesin dhe edukimin në harmoni me mundësitë e tua zhvillimore.	Neni 6: Ke të drejtë për jetë dhe të drejtë që të të sigurohet zhvillimi dhe ekzistenca.
Neni 7: Ke të drejtën e emrit dhe të shtetësisë, të drejtë të dish kush janë prindërit e tu dhe të drejtën e përkujdesjes nga ana e tyre.	Neni 8: Shteti ka detyrim që ta mbrojë emrin tënd, shtetësinë dhe lidhjet familjare.
Neni 9: Ke të drejtë të jetosh me prindërit e tu, përpos nëse ndarja nga ata është më mirë për ty, por edhe atëherë ke të drejtë të kesh kontakt me ta.	Neni 10: Nëse je i/e ndarë nga prindi dhe dëshiron të jesh me të, për ty nuk ekzistojnë kufij shtetëror.
Neni 11: Shteti duhet patjetër të të mbrojë nga rrëmbimi dhe duhet të të ndihmojë nëse dëshiron të kthehesh në atdhe.	Neni 12: Ke të drejtë që ta shprehësh lirisht mendimin tënd dhe që atij t'i kushtohet vëmendje meritore në të gjitha çështjet që të përkasin ty.
Neni 13: Ke të drejtë të kërkosh, marrësh dhe japësh informata dhe ide të të gjitha llojeve, pavarësisht nga kufinj të.	Neni 14: Ke të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes, dhe të besimit fetar me orientime të caktuara nga ana e prindërve.
Neni 15: Ke të drejtë e bashkimit të lirë dhe të tubimit të qetë.	Neni 16: Ke të drejtë e mbrojtjes nga përzierja në privatësinë, familjen, shtëpinë tënde ose në letërkëmbimin personal dhe të drejtën e mbrojtjes nga sulmet në nderin dhe prestigjin tënd.
Neni 17: Ke të drejtë të kërkosh informata që të interesojnë, kurse shteti duhet të të mbrojë nga materialet dhe informatat e dëmshme.	Neni 18: Prindërit duhet të kujdesen së bashku për ty, kurse shteti që tu ndihmojë në këtë.
Neni 19: Ke të drejtë të jesh i/e mbrojtur nga të gjitha format e mospërfilljes dhe keqtrajtimit, e shteti duhet të ta sigurojë këtë.	Neni 20: Nëse ndodh të mbetesh pa familje, ke të drejtë për mbrojtje të veçantë dhe kujdes përkatës.

Neni 21: Nëse vjen në situatën që lypset të të adoptojnë, ke të drejtë që kjo të bëhet ashtu si është më mirë për ty.	Neni 22: Nëse vjen në situatën të bëhesh refugjat, ke të drejtë për mbrojtje të posaçme.
Neni 23: Nëse je i penguar fizikisht apo mentalisht në zhvillim, ke të drejtat e njëjta si edhe të tjerët, e gjithashtu ke edhe të drejtë për kujdes, arsimim e aftësim të veçantë për punë.	Neni 24: Ke të drejtë për mbrojtjen më të mirë shëndetësore.
Neni 25: Nëse shteti shfaq kujdesin direkt për ty, ai duhet edhe të verifikojë si je.	Neni 26: Ke të drejtë e mbrojtjes dhe të sigurisë sociale.
Neni 27: Ke të drejtë për standardin përkatës të jetesës cilin duhet të at sigurojnë prindërit, kurse shteti tu ndihmojë në këtë.	Neni 28: Ke të drejtë që shteti të të sigurojë arsimim fillor pa pagesë, e nëse dëshiron më shumë në bazë të aftësive tua. Disiplina në shkollë zbatohet në harmoni me të drejtat e fëmijëve dhe dinjitetin njerëzor.
Neni 29: Arsimimi duhet ta zhvillojë personalitetin tënd dhe aftësitë, duhet të të përgatisë për jetë aktive shoqërore dhe të të mësojë ta respektosh kulturën tënde dhe kulturat e popujve e grupeve tjera.	Neni 30: Nëse je pjesëtar i ndonjë pakice, ke të drejtë për kulturën, besimin dhe gjuhën tënde.
Neni 31: Ke të drejtën e kohës së lirë, lojës dhe pushimit, si dhe të marrësh pjesë në aktivitetet kulturore e artistike.	Neni 32: Ke të drejtë për mbrojtje nga puna e cila është e dëmshme për shëndetin tënd ose e pengon zhvillimin dhe arsimimin tënd.
Neni 33: Ke të drejtë për mbrojtje nga përdorimi i drogës dhe shfrytëzimi në prohimin dhe shitjen e tyre.	Neni 34: Ke të drejtën e mbrojtjes nga shfrytëzimi dhe keqpërdorimi seksual, përfshirë edhe pornografinë e prostitucionin.
Neni 35: Shteti duhet patjetër të të mbrojë nga rrëmbimi, shitja apo trafikimi.	Neni 36: Shteti duhet patjetër të të mbrojë nga cilado formë e shfrytëzimit që është dëmshme për ty.
Neni 37: Askush nuk guxon të të mendojë, të sillet vrazhdë ndaj teje ose të të dënojë, të të arrestoj ose privoj nga liria në mënyrë të paligjshme . Je i/e mbrojtur nga dënimi me vdekje dhe burgimi i përjetshëm. Nëse bie në burg ke të drejtë për kontakt me familjen dhe për ndihmë juridike.	Neni 38: Nëse ke më pak se 15 vjeç, ke të drejtë të mos marrësh pjesë në luftë, kurse në konfliktin e armatosur ke të drejtë për kujdes dhe mbrojtje të veçantë.
Neni 39: Nëse ke qenë i/e ekspozuar ndaj konflikteve të armatosura, mundimeve, mospërfilljes, keqpërdorimit apo shfrytëzimit, ke të drejtën e ndihmës për shërim fizik e psikik.	Neni 40: Nëse bie në konflikt me ligjin, ke të drejtë që ndja teje të veprohet me dinjitet dhe me respektim.



## Shtojca 2. Konventa mbi të drejtat e fëmijës

E miratuar në Asamblenë e Përgjithshme të KB, më 20 Nëntor 1989.

Teksti	Rezumeja jozyrtare e vërejtjeve kryesore
<p><b>PREAMBULA</b></p> <p>Shtetet kontraktuese të kësaj Konventë,</p> <p>Duke marrë parasysh se, në përputhje me parimet e shpallura në Kartën e Kombeve të Bashkuara, njohja e dinjitetit që u përket të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore dhe të drejtave të tyre të barabarta të patjetërsueshme përbën themelin e lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë,</p> <p>Duke marrë parasysh se popujt e Kombeve të Bashkuara kanë ripohuar në Kartë besimin e tyre në të drejtat themelore të njeriut dhe në dinjitetin dhe vlerën e njeriut dhe kanë vendosur të nxisin përparimin shoqëror e të krijojnë kushte më të mira jetese, në një liri më të madhe,</p> <p>Duke pranuar se Kombet e Bashkuara, në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe në Paktet ndërkombëtare mbi të Drejtat e Njeriut, kanë shpallur dhe kanë pranuar që çdonjëri mund të përfitojë nga të gjitha të drejtat dhe të gjitha liritë e parashtruara në to, pa asnjë dallim race, ngjyre, gjinie, gjuhe, feje, opinionin politik ose çdo lloji opinionin tjetër, origjinë kombëtare ose shoqërore, pasurie, lindjeje apo çdo lloj statusi tjetër,</p> <p>Duke rikujtuar se në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Kombet e Bashkuara kanë shpallur që mosha e fëmijërisë ka të drejtë për një përkujdesje dhe përkrahje të veçantë,</p> <p>Të bindura se familja, si njësi bazë e shoqërisë dhe mjedis natyror për rritjen dhe mirëqenien e të gjithë anëtarëve të saj dhe veçanërisht të fëmijëve, duhet të ketë mbrojtjen dhe përkrahjen e nevojshme që të mund të marrë përsipër plotësisht rolin e saj në bashkësi,</p> <p>Duke pranuar se fëmija, me qëllim të zhvillimit të plotë e të harmonishëm të personalitetit të tij, duhet të rritet në mjedis familjar, në një atmosferë lumturie, dashurie dhe mirëkuptimi,</p> <p>Duke marrë parasysh se fëmija duhet të përgatitet plotësisht për të bërë një jetë individuale në shoqëri dhe të edukohet në frymën e idealeve të shpallura në Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe sidomos në frymën e paqes, të dinjitetit, tolerancës, lirisë, barazisë dhe solidaritetit,</p> <p>Duke mbajtur parasysh se domosdoshmëria për t'i dhënë një mbrojtje të veçantë fëmijës është pohuar në Deklaratën e Gjenevës mbi të Drejtat e Fëmijës, të vitit 1924 dhe në Deklaratën mbi të Drejtat e Fëmijës të miratuar nga Kombet e Bashkuara më 20 nëntor 1959 dhe që është njohur në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, në Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike</p>	<p><b>PREAMBULA</b></p> <p><i>Preambula na i rikujton principet kryesore të Kombeve të Bashkuara dhe dispozitat e veçanta të kontratave dhe deklaratave të caktuara, relevante mbi të drejtat e njeriut. Ajo konfirmon se fëmijëve, për shkak të ndieshmërisë së tyre, u nevojitet kujdesi i posaçëm dhe mbrojtja e osaçme, dhe në veçanti spikat rolin parësor të familjes për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijës. Në të, gjithashtu riafirmohen: domosdoshmëria e mbrojtjes juridike e tjetër të fëmijës para dhe pas lindjes, rëndësia e respektimit të vlerave kulturore të bashkësisë nga e cila rrjedh fëmija, dhe roli vital i bashkëpunimit ndërkombëtar në mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.</i></p>

(në veçanti në nenet 23 dhe 24), në Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore (në veçanti në nenin 10) dhe në statutet e instrumentet përkatëse të agjencive të specializuara dhe të organizatave ndërkombëtare, që merren me mirëqenien e fëmijës,

Duke mbajtur parasysh se, ashtu siç është thënë në Deklaratën e të Drejtave të Fëmijës "fëmija, për shkak të papjekurisë së tij fizike dhe intelektuale ka nevojë për një mbrojtje dhe kujdes të veçantë, përfshirë mbrojtjen juridike të përshtatshme, si para ashtu dhe pas lindjes",

Duke rikujtuar dispozitat e Deklaratës mbi Parimet Sociale dhe Juridike lidhur me Mbrojtjen dhe Mirëqenien e Fëmijëve, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me vendosjen e fëmijës në një familje ushqyese dhe birësimin e fëmijës brenda dhe jashtë vendit; me rregullat minimale standard të Kombeve të Bashkuara mbi administrimin e drejtësisë për të miturit (Rregullat e Pekinit) dhe të Deklaratës mbi Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve në Periudha të Gjendjes së Jashtëzakonshme dhe Konfliktit të Armatosur,

Duke pranuar se në të gjitha vendet e botës ka fëmijë që jetojnë në kushte jashtëzakonisht të vështira dhe se është e nevojshme që këtyre fëmijëve t'u kushtohet një vëmendje e veçantë,

Duke i kushtuar vëmendje meritore rëndësisë së traditave dhe të vlerave kulturore të çdo populli në mbrojtjen dhe zhvillimin e harmonishëm të fëmijës,

Duke pranuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar për përmirësimin e kushteve të jetesës së fëmijëve në të gjitha vendet, dhe veçanërisht në vendet në zhvillim,

## PJESA I

### Neni 1

Për nevojat e kësaj Konvente, fëmijë është çdo genie njerëzore nën moshën 18 vjeç, në qoftë se sipas ligjit i cili aplikohet për fëmijët, moshë madhore nuk fitohet më herët.

### Neni 2

1. Palët kontraktuese të kësaj Konvente do t'i respektojnë të drejtat e përmendura në këtë Konventë dhe t'ia garantojnë ato çdo fëmije, që përfshihet në juridiksionin e tyre, pa asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinionin politik ose çdo opinion tjetër, nga origjina kombëtare, etnike ose shoqërore, pasuria, paaftësia, prejardhja familjare apo çdo gjendje tjetër e fëmijës ose prindërve të tij ose përfaqësuesve të tij ligjorë.

2. Palët kontraktuese marrin të gjitha masat e duhura, me qëllim që fëmija të jetë efektivisht i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit ose ndëshkimit, për shkak të pozitës, veprimtarive, opinionëve të shprehura ose bindjeve të prindërve të tij, të përfaqësuesve të tij ligjorë ose të anëtarëve të familjes së tij.

### **(1) Definicioni i fëmijës**

*Me fëmijë konsiderohet personi nën 18 vjeç, në qoftë se sipas ligjit të Vendit në fjalë, moshë madhore nuk fitohet më herët.*

### **(2) Mos-diskriminimi**

*Të gjitha të drejtat aplikohen në të gjithë fëmijët pa diskriminim. Shtetet kanë detyrim t'i mbrojnë fëmijët nga të gjitha format e diskriminimit dhe ndërmarrin aksione pozitive me qëllim të promovimit të drejtave të tyre.*

### Neni 3

1. Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislativë, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese.

2. Palët kontraktuese angazhohen që t'i sigurojnë fëmijës mbrojtjen dhe kujdesin e nevojshëm për mirëqenien e tij, duke pasur parasysh të drejtat dhe detyrat e prindërve të tij, të kujdestarëve të tij ligjorë ose të personave të tjerë ligjërisht përgjegjës për të dhe, për këtë qëllim, ata marrin të gjitha masat legjislativë dhe administrative përkatëse.

3. Palët kontraktuese marrin masa që institucionet, shërbimet dhe qendrat që përgjigjen për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve të veprojnë në përputhje me normat e caktuara nga autoritetet kompetente, veçanërisht në fushën e sigurisë, të shëndetit, të numrit dhe aftësive të personelit të tyre si dhe të kontrollit të duhur.

### Neni 4

Palët kontraktuese angazhohen të marrin të gjitha masat legjislativë, administrative e të tjera të nevojshme, për të vënë në jetë të drejtat e njohura në këtë Konventë. Lidhur me të drejtat ekonomike, shoqërore e kulturore, Shtetet Palë marrin të gjitha masat e mundshme, në bazë të burimeve që disponojnë dhe, kur është nevoja, në kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

### Neni 5

Palët kontraktuese do t'i respektojnë përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrat që kanë prindërit ose, sipas rastit, anëtarët e familjes së zgjeruar ose të bashkësisë, siç parashikohet nga zakoni i vendit, kujdestarët ose persona të tjerë ligjërisht përgjegjës për fëmijën, për t'i dhënë këtij, në përputhje me zhvillimin e aftësive të tij, drejtimin dhe udhëheqjen e duhur për ushtrimin e të drejtave që i njihen atij me këtë Konventë.

### Neni 6

1. Palët kontraktuese njohin se çdo fëmijë ka të drejtën e pamohueshme për të jetuar.

2. Palët kontraktuese marrin të gjitha masat e mundshme për të siguruar mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës.

### Neni 7

1. Fëmija regjistrohet menjëherë sapo lind dhe qysh atëherë ka të drejtën të ketë një emër, të drejtën për të fituar një shtetësi dhe, brenda mundësive, të drejtën për të njohur prindërit e tij dhe për të pasur kujdesin e tyre.

2. Palët kontraktuese sigurojnë zbatimin e këtyre të drejtave, në përputhje me legjisllacionin e tyre kombëtar dhe me detyrimet që rrjedhin nga instrumentet përkatëse ndërkombëtare në këtë fushë, sidomos në rastet kur, në mungesë të tyre, fëmija do të mbetej pa shtetësi.

### **(3) Interesat më të mira të fëmijës**

*Të gjitha procedimet që i përkasin fëmijës do të merren në harmoni me interesat e tij më të mira. Shtetet do të sigurojnë kujdesin përkatës mbi fëmijën në rastin kur prindërit ose kujdestarët këtë nuk e bëjnë.*

### **(4) Realizimi i të drejtave**

*Shtetet duhet patjetër të bëjnë krejt që është në fuqinë e tyre që të drejtat të parashikuara me këtë Konventë të realizohen.*

### **(5) Të drejtat dhe detyrimet e**

*prindërve në raport me mundësitë zhvillimore të fëmijës Shtetet duhet patjetër të respektojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e prindërve, respektivisht shtrirjen e familjes, që të orientojnë dhe këshillojnë fëmijën lidhur me të drejtat e tija, në harmoni me mundësitë e tij zhvillimore.*

### **(6) Ekzistenca dhe zhvillimi**

*Secili fëmijë ka të drejtë të patjetërsueshme për jetë, kurse shteti ka detyrim ta sigurojë ekzistencën dhe zhvillimin e tij.*

### **(7) Emri dhe shtetësia**

*Fëmija ka të drejtë për emrin nga lindja. Fëmija ka të drejtë të fitojë shtetësinë dhe, nëse është e mundshme, të drejtën t'i dijë prindërit e vet dhe të ruhet nga kujdestari.*

#### Neni 8

1. Palët kontraktuese marrin përsipër të respektojnë të drejtën e fëmijës për të ruajtur identitetin e tij, përfshirë këtu shtetësinë, mbiemrin dhe lidhjet familjare, sipas ligjit, pa ndërhyrje të paligjshme.

2. Në rastet kur fëmija i mohohen në mënyrë të paligjshme disa ose të gjithë elementet e identitetit të tij, Shtetet Palë i japin atij ndihmën dhe mbrojtjen e duhur, me qëllim që identiteti i tij të rivendoset shpejt.

#### Neni 9

1. Palët kontraktuese garantojnë që fëmija të mos ndahet nga prindërit kundër dëshirës së tyre, përveç rastit kur autoritetet kompetente, në bazë të rishikimit gjyqësor, vendosin që, në përputhje me ligjin dhe procedurat përkatëse kjo ndarje është e domosdoshme, në interesin më të lartë të fëmijës. Ky vendim mund të jetë i nevojshëm në raste të veçanta, si ai kur prindërit keqtrajtojnë ose nuk kujdesen për fëmijën, ose kur ata jetojnë të ndarë dhe kur duhet vendosur se ku duhet të banojë fëmija.

2. Në të gjitha rastet e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni, të gjitha palët e interesuara duhet të kenë mundësinë të marrin pjesë në diskutim dhe të bëjnë të njohura mendimet e tyre.

3. Palët kontraktuese respektojnë të drejtën e fëmijës së ndarë nga njëri ose nga të dy prindërit, që të mbajë rregullisht marrëdhënie vetjake dhe takime të drejtpërdrejta me të dy prindërit e tij, me përjashtim të rasteve kur kjo nuk është në interesin më të lartë të fëmijës.

4. Kur ndarja është rrjedhojë e çdo mase të marrë nga një Shtet Palë, si ndalimi, burgimi, internimi, dëbimi ose vdekja, (përfshirë këtu vdekjen për çfarëdo shkak, kur personi është i ndaluar nga shteti) e njërit ose të dy prindërve, ose të fëmijës, ky Shtet Palë, sipas kërkesës, u jep prindërve, fëmijës ose, kur është rasti, një anëtar tjetër të familjes, të dhëna të hollësishme mbi vendin ku ndodhen anëtarit ose anëtarët e familjes, me përjashtim të rasteve kur dhënia e këtyre të dhënave dëmton mirëqenien e fëmijës. Shtetet Palë sigurojnë gjithashtu, që paraqitja e një kërkesë të tillë të mos sjellë në vetvete pasoja të dëmshme për personin ose personat të cilëve u përket.

#### Neni 10

1. Në përputhje me detyrimin Palët kontraktuese sipas paragrafit 1 të nenit 9, kërkesat e bëra nga një fëmijë ose nga prindërit e tij, me qëllim që të hyjnë në një Shtet Palë ose të largohen prej tij, për arsye ribashkimi të familjes, trajtohen nga Palët kontraktuese në një frymë pozitive, me humanizëm dhe me shpejtësi. Palët kontraktuese sigurojnë gjithashtu që paraqitja e një kërkesë të tillë të mos sjellë pasoja të dëmshme për autorët e kërkesës dhe anëtarët e familjes së tyre.

#### **(8) Ruajtja e identitetit**

*Shteti ka detyrim të mbrojë dhe nëse nevojitet të sigurojë rivendosjen e të gjithë aspekteve të qenësishëm të identitetit të fëmijës. Kjo përfshin emrin, shtetësinë dhe lidhjet familjare.*

#### **(9) Ndarja nga familja**

*Fëmija ka të drejtë të jetojë me prindërit e vet, përpos në rastin kur në procedurën përkatëse, vlerësohet se ndarja nga prindërit është në interesin më të mirë të fëmijës. Fëmija ka të drejtë të mbajë kontakte me të dy prindërit nëse është i ndarë prej njërit nga ata ose prej të dy prindërve.*

#### **(10) Bashkimi i familjes**

*Fëmijët dhe prindërit e tyre kanë të drejtë ta braktisin cilindo vend dhe të hyjnë në vendin e vet me qëllim të bashkimit të familjes apo ruajtjes së marrëdhënieve midis fëmijëve dhe prindërve.*

2. Fëmija, prindërit e të cilit banojnë në shtete të ndryshme, ka të drejtë të mbajë marrëdhënie personale dhe takime të rregullta të drejtpërdrejta me të dy prindërit e tij, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme. Për këtë qëllim dhe në përputhje me detyrimin e Palëve kontraktuese, sipas paragrafit 1 të nenit 9, Palët kontraktuese respektojnë të drejtën e fëmijës dhe të prindërve të tij për t'u larguar nga çdo vend, përfshirë këtu edhe të vetin, si dhe të kthehen në vendin e tyre. E drejta për t'u larguar nga çdo vend bëhet objekt kufizimesh vetëm në rastet e përcaktuara me ligj, të cilat janë të nevojshme për të mbrojtur sigurimin kombëtar, rendin publik, shëndetin dhe moralin publik ose të drejtat dhe liritë e të tjerëve dhe që janë në pajtim me të drejtat e njohura në këtë Konventë.

#### Neni 11

1. Palët kontraktuese marrin masa për të luftuar zhvendosjet dhe mos-rikthimet e paligjshme të fëmijëve në vend të huaj.

2. Për këtë qëllim, Palët kontraktuese nxisin përfundimin e marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe ose aderimin në marrëveshjet ekzistuese.

#### Neni 12

1. Palët kontraktuese i garantojnë fëmijës, i cili është i aftë të ketë pikëpamjet e tij, të drejtën për t'i shprehur lirisht këto pikëpamje, për çdo çështje që ka të bëjë me të, duke i vlerësuar ato në përputhje me moshën dhe shkallën e pjekurisë së tij.

2. Për këtë qëllim, fëmijës i jepet mundësia që të dëgjohet në çdo procedurë gjyqësore ose administrative, që ka të bëjë me të, qoftë drejtpërdrejt, qoftë nëpërmjet një përfaqësuesi ose të një organi të përshtatshëm, në përputhje me rregullat e procedurës së legjislacionit kombëtar

#### Neni 13

1. Fëmija ka të drejtën e lirisë së shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë për të kërkuar, për të marrë dhe për të përcjellë informacione dhe ide të çdo lloji, pa marrë parasysh kufijtë, në formë gojore, të shkruar, të shtypur ose artistike, ose me çdo mjet tjetër të zgjedhur nga fëmija.

2. Ushtrimi i kësaj të drejte mund t'i nënshtrohet disa kufizimeve, por vetëm kur përcaktohen me ligj dhe janë të domosdoshme për:

(a) për respektimin e të drejtave ose të prestigjit të të tjerëve; ose

(b) për mbrojtjen e sigurimit kombëtar, apo të rendit publik, (ordre public) të shëndetit ose të moralit publik.

#### Neni 14

1. Palët kontraktuese respektojnë të drejtën e fëmijës për lirinë e mendimit, të ndërgjegjes dhe të fesë.

#### **(11) Transferimi i paligjshëm**

*dhe moskthimi i fëmijëve Shteti ka detyrim të pengojë rrëmbimin dhe mbajtjen e fëmijëve në botën e jashtme, edhe në qoftë se këtë e bën prindi apo dikush tjetër dhe në ato raste ndërmerr masat përkatëse.*

#### **(12) Shprehja e mendimit**

*Fëmija ka të drejtë për shprehjen e lirë të mendimit dhe të drejtën që mendimi i tij të merret në konsideratë në të gjitha gjërat dhe procedimet të cilat i përkasin direkt.*

#### **(13) Liria e të shprehurit**

*Fëmija ka të drejtë që t'i shpreh lirisht pikëpamjet e veta, të kërkojë, marrë dhe kumtojë informatat dhe dijet e të gjitha llojeve dhe në mënyrë të ndryshme, pavarësisht nga vitet.*

2. Palët kontraktuese respektojnë të drejtat dhe detyrimet e prindërve dhe, sipas rastit, të përfaqësuesve ligjorë të fëmijës, për ta drejtuar atë në ushtrimin e të drejtës së tij, në përputhje me zhvillimin e aftësive të tij.

3. Liria e shprehjes së fesë ose bindjeve mund t'u nënshtrohet vetëm kufizimeve të përcaktuara me ligj dhe që janë të domosdoshme për të mbrojtur sigurinë publike, rendin publik, shëndetin dhe moralin publik, ose liritë dhe të drejtat themelore të tjerëve.

Neni 15

1. Palët kontraktuese njohin të drejtat e fëmijës për lirinë e organizimit dhe lirinë e grumbullimit paqësor.

2. Asnjë kufizim nuk mund të ketë në ushtrimin e këtyre të drejtave, përveç atyre të përcaktuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurimit kombëtar, të sigurisë publike ose të rendit publik, ose për të mbrojtur shëndetin ose moralin publik, ose të drejtat dhe liritë e të tjerëve.

Neni 16

1. Asnjë fëmijë nuk u nënshtrohet ndërhyrjeve arbitrare ose të paligjshme në jetën e tij private, në familje, në shtëpi ose në korrespondencën e tij, as cënimeve të kundërligjshme të nderit dhe reputacionit të tij.

2. Fëmija ka të drejtën e mbrojtjes me ligj kundër ndërhyrjeve ose cënimeve të tilla.

Neni 17

Palët kontraktuese njohin funksionin e rëndësishëm që përmbushin mjetet e komunikimit masiv dhe garantojnë që fëmija të marrë informacione dhe materiale që vijnë nga burime të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, sidomos ato që synojnë të rrisin mirëqenien e tij shoqërore, shpirtërore e morale, si dhe shëndetin e tij fizik dhe mendor. Për këtë qëllim Palët kontraktuese:

(a) Inkurajojnë mjetet e komunikimit masiv për të përhapur një informacion dhe materiale me dobi shoqërore dhe kulturore për fëmijën dhe në përputhje me frymën e nenit 29;

(b) Inkurajojnë bashkëpunimin ndërkombëtar në prodhimin, shkëmbimin dhe shpërndarjen e informacioneve dhe materialeve të tilla nga burime të ndryshme kulturore, kombëtare e ndërkombëtare;

(c) Inkurajojnë prodhimin dhe përhapjen e librave për fëmijë;

(d) Inkurajojnë mjetet e komunikimit masiv, mbajnë parasysh, në mënyrë të veçantë nevojat gjuhësore, të fëmijës që i përket një grupi etnik ose është autokton;

(e) Nxisin përpunimin e orientimeve të nevojshme për mbrojtjen e fëmijës nga informacioni dhe materialet që dëmtojnë mirëqenien e tij, duke pasur parasysh dispozitat e neneve 13 dhe 18.

**(14) Liria e mendimit, vetëdijes dhe e besimit fetar** Shteti do ta respektojë të drejtën e fëmijës për lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe të besimit fetar dhe të drejtën e detyrimit e prindërve që t'i orientojnë në këtë.

**(15) Liria e bashkimit** Fëmijët kanë të drejtë për bashkim të lirë dhe lirinë e tubimit të qetë.

**(16) Mbrojtja e privatësisë** Fëmijët kanë të drejtë për mbrojtjen nga përzierja në privatësinë, shtëpinë, familjen e tyre dhe letërkëmbimin personal dhe të drejtën për mbrojtjen e nderit dhe prestigjit të vet

**(17) Qasja në informatat përkatëse** Shteti do të sigurojë që fëmijët të kenë qasje në informata dhe materiale nga burimet e ndryshme. Shteti do të nxisë mjetet e informimit publik të përhapin informatat me dobi shoqërore e kulturore për fëmijët, e do të marrë masat që t'i mbrojnë fëmijët nga informatat dhe materialët e dëmshme.



#### Neni 18

1. Palët kontraktuese përpiqen me të gjitha mundësitë, për të siguruar njohjen e parimit, sipas të cilit të dy prindërit kanë përgjegjësi të përbashkët për edukimin dhe zhvillimin e fëmijës.

Përgjegjësinë kryesore për edukimin dhe zhvillimin e fëmijës e kanë prindërit, ose sipas rastit, përfaqësuesit e tij ligjorë. Ata duhet të udhëhiqen, në radhë të parë, nga interesi më i lartë i fëmijës.

2. Me qëllim të garantimit dhe avancimit të drejtat nga kjo Konventë, Palët kontraktuese u japin ndihmën e duhur prindërve dhe përfaqësuesve ligjorë të fëmijës, në ushtrimin e përgjegjësisë që u bie atyre për rritjen e fëmijës dhe sigurojnë ngritjen e institucioneve, qendrave ose shërbimeve të kujdesit për fëmijët.

3. Palët kontraktuese marrin të gjitha masat e nevojshme për t'u siguruar fëmijëve, prindërit e të cilëve janë në marrëdhënie pune, të drejtën të përfitojnë nga shërbimet dhe lehtësitë e kujdesit për fëmijët, për të cilat janë ngritur.

#### Neni 19

1. Palët kontraktuese marrin të gjitha masat legislative, administrative, shoqërore dhe edukative për mbrojtjen e fëmijës nga çdo formë e dhunës fizike ose mendore, fyerja ose keqtrajtimi, braktisja apo mospërfillja, nëpërkëmbja ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual, për sa kohë që ai është nën ruajtjen e prindërve të tij ose të njërit prej tyre, të përfaqësuesit ose përfaqësuesve të tij ligjorë ose të çdo personi tjetër të cilit i është besuar.

2. Këto masa mbrojtjeje përfshijnë, sipas nevojës, procedime të efektshme për miratimin e programeve shoqërore për sigurimin e mbështetjes së domosdoshme të fëmijës dhe atyre që kujdesen për të, si dhe të formave mbrojtëse e parandaluese, identifikimit, raportimit, referimit, hetimit, trajtimit dhe ndjekjeje të rasteve të keqtrajtimit të fëmijës, të përshkruara më lart, duke përfshirë, në se duhet, të drejtuarit në gjykatë.

#### Neni 20

1. Fëmija, të cilit i mohohet në mënyrë të përkohshme ose të përhershme mjedisi i tij familjar, ose kur nuk është në interesin e tij më të lartë të qëndrojë në këtë mjedis, ka të drejtë për një mbrojtje dhe një ndihmë të posaçme nga shteti.

2. Palët kontraktuese sigurojnë për këtë fëmijë një përkujdesje alternative, në përputhje me legjislacionin e tyre të brendshëm.

3. Kjo përkujdesje alternative mund të ketë, përpos të tjerash, formën e vendosjes në një familje, "Kafalah" sipas të drejtës islame, të birësimit ose, në rast nevojë, të vendosjes në një qendër të përshtatshme të kujdesit për fëmijët. Në gjetjen e këtyre zgjidhjeve, kujdesi meritator do t'i kushtohet nevojës së vendosjes së vazhdimësisë në edukimin e fëmijës, si dhe origjinës së tij etnike, fetare, kulturore dhe gjuhësore.

#### **(18) Përgjegjësia e prindërve**

*Të dy prindërit kanë përgjegjësi të përbashkët për ngritjen e fëmijës. Shteti do tu ofrojë ndihmë prindërve në realizimin e përgjegjësisë për ngritjen e fëmijëve dhe do të sigurojë zhvillimin e enteve, kapaciteteve dhe shërbimeve për mbrojtjen dhe kujdesin mbi fëmijët.*

#### **(19) Mbrojtja nga keqtrajtimi**

*dhe mospërfillja Shteti do ta mbrojë fëmijën nga të gjitha format e keqtrajtimit derisa është nën kujdesin e prindërit apo personave tjerë të cilët kujdesen për të, dhe do të inaugurojë programe përkatëse parandaluese dhe do tu ndihmojë viktimave të keqtrajtimit.*

#### **(20) Mbrojtja e fëmijëve pa**

*prindër Shteti ka detyrim tu sigurojë mbrojtje të veçantë fëmijëve të privuar nga kujdesi i prindërve dhe të sigurojë strehim fëmijëve të tillë në familje apo ente përkatëse alternative. Në përkujdesjen e fëmijëve të privuar nga kujdesi i prindërve kujdesi meritator do t'i kushtohet prejardhjes kulturore të fëmijës.*

## Neni 21

Palët kontraktuese, të cilët pranojnë dhe/ose lejojnë sistemin e birësimit, garantojnë që konsiderata mbizotëruese të jetë interesi më i lartë i fëmijës dhe:

(a) Sigurojnë që birësimi i fëmijës të autorizohet vetëm nga autoritetet kompetente, të cilët përcaktojnë, në përputhje me ligjin dhe procedurat e zbatueshme dhe mbi bazën e të gjitha të dhënave përkatëse dhe të besueshme, që birësimi të lejohet duke mbajtur parasysh gjendjen e fëmijës në raport me prindërit, të afërmit dhe përfaqësuesit e tij ligjorë dhe, kur është e nevojshme, personat e interesuar të kenë dhënë pëlqimin e tyre të ndërgjegjshëm për birësimin, mbi bazën e këshillimit të nevojshëm;

(b) Pranojnë se birësimi në një vend tjetër mund të shihet si një alternativë për të siguruar kujdesin për fëmijën, në qoftë se fëmija nuk mund të vendoset në një familje ushqyese ose birësuese, ose të ketë një mënyrë tjetër të përshtatshme për kujdesjeje në vendin e tij të origjinës;

(c) Sigurojnë që, në rast birësimi në një vend tjetër, fëmija të gëzojë mbrojtjen dhe normat e barazvlershme me ato që ekzistojnë në rastin e birësimit në vendin e tij;

(d) Marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar që, në rast birësimi në një vend tjetër, vendosja e fëmijës të mos kthehet në një përfitim material të pavend për personat e implikuar në të;

(e) Mbështesin, sipas rastit, objektivat e këtij neni, duke përfunduar rregullime ose marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe dhe përpiqen në këtë kuadër të sigurojnë që vendosja e fëmijës në një vend tjetër të bëhet nga autoritetet ose organet kompetente.

## Neni 22

1. Palët kontraktuese marrin masat e duhura për të siguruar që një fëmijë, i cili kërkon të marrë statusin e refugjatit ose që konsiderohet si i tillë sipas rregullave dhe procedurave të së drejtës ndërkombëtare ose të brendshme të zbatueshme, qoftë vetëm apo i shoqëruar nga prindërit e tij ose nga çdo person tjetër, të përfitojë nga mbrojtja dhe përkrahja humanitare e duhur, për t'i lejuar atij të gëzojë të drejtat që i njohin kjo Konventë dhe instrumentet e tjera ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut ose me karakter humanitar, në të cilat Shtetet janë Palë.

2. Për këtë qëllim, Shtetet Palë bashkëpunojnë, kur e gjejnë të nevojshme, në çdo përpjekje të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe të organizatave të tjera ndërqeveritare ose joqeveritare kompetente, që bashkëpunojnë me Organizatën e Kombeve të Bashkuara për të mbrojtur dhe ndihmuar fëmijën dhe për të kërkuar prindërit ose anëtarët e tjerë të familjes të çdo fëmije refugjat, me qëllim që të sigurojnë informacionin e nevojshëm për bashkimin me familjen. Në rastet kur as prindërit, as anëtarët e tjerë të familjes nuk gjenden, fëmijës do t'i jepet e njëjta mbrojtje, si çdo fëmije tjetër që i mungon ngaherë ose përkohësisht mjedisi familjar, cilado qoftë arsyeja, sikundër parashikohet në këtë Konventë.

## **(21) Birësimi**

*Në vendet të cilat e njohin dhe lejojnë birësimin ajo do të ekzekutohet në harmoni me interesat më të mira të fëmijës dhe kjo vetëm me pëlqimin e autoriteteve kompetente dhe me masa mbrojtëse ndaj fëmijës.*

## **(22) Fëmijët refugjatë**

*Fëmija refugjat ose fëmija i cili kërkon status prej refugjati ka të drejtë për mbrojtje të veçantë. Shteti ka detyrim të bashkëpunojë me organizatat përkatëse të cilat ofrojnë mbrojtje dhe ndihmë të tillë*

#### Neni 23

1. Palët kontraktuese pranojnë se fëmija me paaftësi mendore ose fizike duhet të bëjë një jetë normale dhe të përshtatshme, në kushte që garantojnë dinjitetin e tij, që nxisin autonominë dhe lehtësojnë pjesëmarrjen e tij aktive në jetën e bashkësisë.

2. Palët kontraktuese njohin të drejtën e fëmijës me paaftësi për kujdes të posaçëm dhe nxisin e sigurojnë, brenda mundësive të të ardhurave të disponueshme, dhënien fëmijës, i cili përmbush kushtet, si dhe atyre që kujdesen për të, të ndihmës që kërkohet dhe që i përshtatet gjendjes së fëmijës dhe gjendjes financiare të prindërve të tij, ose të atyre që kujdesen për të.

3. Duke njohur nevojat e veçanta të fëmijës me paaftësi, ndihma e dhënë sipas paragrafit 2 të këtij neni jepet falas sa herë të jetë e mundur, duke pasur parasysh burimet financiare të prindërve të tij ose të atyre që kujdesen për të dhe kjo synon që fëmijët me paaftësi të kenë mundësi efektive të marrin arsim, kualifikim, shërbime shëndetësore, shërbime riaftësimi, përgatitje për punësim dhe veprimtari argëtuese, në mënyrë që fëmija të sigurojë një integrim shoqëror dhe zhvillim vetjak sa më të plotë, përfshirë zhvillimin e tij kulturor dhe shpirtëror.

4. Palët kontraktuese, në frymën e bashkëpunimit ndërkombëtar, nxisin shkëmbimin e informacionit të përshtatshëm në fushën e kujdesit shëndetësor parandalues dhe të trajtimit mjekësor, psikologjik dhe funksional të fëmijëve me paaftësi, përfshirë përhapjen dhe mundësinë e marrjes së informacionit lidhur me metodat e riaftësimit, edukimit dhe shërbimeve të formimit profesional, me qëllim që Shtetet Palë të kenë mundësi të përmirësojnë cilësitë dhe aftësitë e tyre dhe të zgjerojnë përvojën e tyre në këto fusha. Në këtë drejtim, duhet të mbahen parasysh në mënyrë të veçantë nevojat e vendeve në zhvillim.

#### Neni 24

1. Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për të gëzuar një gjendje shëndetësore sa më të mirë dhe për të përfituar nga shërbimet për trajtimin e sëmundjes dhe riaftësimin e shëndetit.

Shtetet Palë përpiqen të sigurojnë që asnjë fëmijë të mos i mohohet e drejta për të pasur këto shërbime të kujdesit shëndetësor.

2. Shtetet Palë ndjekin zbatimin e plotë të kësaj të drejte dhe në veçanti marrin masat e duhura:

(a) Për të ulur vdekshmërinë foshnjore dhe feminare;

(b) Për t'u siguruar të gjithë fëmijëve ndihmën e nevojshme mjekësore dhe kujdesin për shëndetin, duke e vënë theksin në zhvillimin e kujdesit shëndetësor parësor;

(c) Për të luftuar sëmundjen dhe kequshqyerjen, edhe në kuadrin e kujdesit shëndetësor parësor, me anë të përdorimit, ndër të tjera, të teknikave lehtësisht të arritshme si dhe të sigurimit të produkteve ushqimore të përshtatshme dhe ujit të pijshëm të pastër, duke pasur parasysh rreziqet e ndotjes së mjedisit natyror;

#### **(23) Fëmijët me pengesa**

*në zhvillim Fëmija me pengesa mendore e fizike në zhvillim ka të drejtë për kujdes të veçantë, arsimim dhe aftësim për punë, i cili do t'i sigurojë jetë të plotë e të denjë dhe arritjen, për të, të shkallës më të lartë të pavarësisë dhe të integritit social.*

#### **(24) Shëndeti dhe mbrojtja**

*shëndetësore Fëmija ka të drejtë për standard më të lartë të mundshëm të shëndetit dhe të mbrojtjes shëndetësore. Shtetet do t'i kushtojnë vëmendje të veçantë mbrojtjes primare shëndetësore dhe preventivës, arsimimit shëndetësor dhe pakësimit të vdekshmërisë të foshnjave dhe fëmijëve. Në këtë kuptim shtetet do të përfshihen në bashkëpunimin ndërkombëtar dhe do të synojnë që asnjë fëmijë të mos privohet nga mundësia e mbrojtjes efektive shëndetësore.*

(d) Për t'u siguruar nënave kujdesin e duhur shëndetësor, para dhe pas lindjes;

(e) Për të mundësuar që gjithë grupet shoqërore dhe në veçanti prindërit dhe fëmijët të marrin informacion, të kenë mundësi edukimi dhe të përkrahen për të përdorur dijet bazë për shëndetin dhe të ushqyerit e fëmijës, përparësitë e ushqyerjes me gji, higjienën dhe shëndoshjen e mjedisit dhe parandalimin e aksidenteve;

(f) Për të zhvilluar kujdesin shëndetësor parandalues, këshillimin e prindërve, edukimin dhe shërbimet në fushën e planifikimit familjar.

3. Palët kontraktuese marrin të gjitha masat e efektshme dhe të nevojshme për të zhdukur praktikat tradicionale të dëmshme për shëndetin e fëmijëve.

4. Palët kontraktuese marrin përsipër të nxisin dhe inkurajojnë bashkëpunimin ndërkombëtar, me qëllim që të sigurojnë gradualisht realizimin e plotë të së drejtës së njohur në këtë nen. Për këtë, mbahen parasysh në mënyrë të veçantë nevojat e vendeve në zhvillim.

Neni 25

Palët kontraktuese i njohin fëmijës, për të cilin është vendosur nga autoritetet kompetente për të qenë nën kujdesi, mbrojtje ose trajtim fizik ose mendor, të drejtën e një ekzaminimi periodik të këtij trajtimi dhe të çdo rrethane tjetër lidhur me këtë vendosje.

Neni 26

1. Palët kontraktuese i njohin çdo fëmije të drejtën për të përfutur përkrahje shoqërore, përfshirë sigurime shoqërore dhe marrin masat e nevojshme për të arritur realizimin e plotë të kësaj të drejte, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar.

2. Ndihamat, ku është e nevojshme, duhet të jepen duke pasur parasysh të ardhurat dhe kushtet e fëmijës dhe personave përgjegjës për mbajtjen e tij si dhe çdo konsideratë tjetër që lidhet me kërkesën për ndihmë të bërë nga vetë fëmija ose në emër të tij.

Neni 27

1. Palët kontraktuese njohin të drejtën e çdo fëmije për një nivel jetese të mjaftueshëm për zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror.

2. Përgjegjësinë për të siguruar kushtet e nevojshme të jetesës për zhvillimin e fëmijës, brenda kufijve të mundësive dhe mjeteve të tyre financiare, e kanë në radhë të parë prindi ose prindërit ose personat e tjerë përgjegjës për rritjen e fëmijës.

### **(25) Kontrolli periodik i**

*vendosjes Fëmija të cilit shteti i ka siguruar kujdes, mbrojtje apo shërim, ka të drejtë për verifikimin periodik të procedimit dhe kushteve të vendosjes.*

### **(26) Mbrojtja sociale**

*Fëmija ka të drejtë për mbrojtje sociale. përfshirë sigurimin social.*

### **(27) Standardi i jetës**

*Secili fëmijë ka të drejtë për standard të jetës, i cili i përgjigjet zhvillimit të tij fizik, mental, shpirtëror, moral e social. Prindërit kanë përgjegjësi primare që fëmijës t'i sigurojnë standard adekuat jetësor. Detyrim i shtetit është të ndihmojë dhe sigurojë që prindërit ta përmbushin atë përgjegjësi të veten. Ky detyrim i shtetit mund të përfshijë ndihmën materiale ndaj prindërve dhe fëmijëve.*

3. Palët kontraktuese marrin masat e duhura, sipas kushteve kombëtare dhe mundësive të tyre, për të ndihmuar prindërit dhe personat e tjerë përgjegjës për fëmijën, që të vënë në jetë këtë të drejtë dhe, në rast nevojë, për të siguruar një përkrahje materiale dhe programe mbështetjeje, sidomos lidhur me ushqimin, veshmbathjen dhe banimin.

4. Palët kontraktuese marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar marrjen e pensionit ushqimor të fëmijës nga prindërit e tij ose nga personat e tjerë që kanë përgjegjësi financiare ndaj tij, qoftë brenda ose jashtë vendit. Në veçanti, në rastet kur personi që ka një përgjegjësi financiare ndaj fëmijës jeton në një shtet tjetër nga ai i fëmijës, Palët kontraktuese favorizojnë aderimin në marrëveshjet ndërkombëtare ose përfundimin e marrëveshjeve të tilla si dhe miratimin e rregullimeve të tjera të duhura.

Neni 28

1. Palët kontraktuese njohin të drejtën e fëmijës për arsimim dhe, me qëllim që të arrihet kjo e drejtë, hap pas hapi dhe mbi bazën e mundësive të barabarta, në mënyrë të veçantë ata:

(a) Bëjnë arsimin fillor të detyrueshëm dhe falas për të gjithë;

(b) Inkurajojnë zhvillimin e formave të ndryshme të arsimit të mesëm si të përgjithshëm, dhe profesional, i bëjnë ato të hapura e të mundshme për çdo fëmijë dhe marrin masa të përshtatshme, si vendosja e arsimit falas dhe dhënia e një ndihme financiare në rast nevojë;

(c) U sigurojnë të gjithëve arsimin e lartë, sipas aftësive të secilit, me të gjitha mjetet e përshtatshme;

(d) Bëjnë të mundshëm dhe të arritshëm për çdo fëmijë informacionin dhe orientimin shkollor e profesional;

(e) Marrin masa për të inkurajuar frekuentimin e rregullt të shkollës dhe uljen e përqindjes së braktisjes së shkollës.

2. Palët kontraktuese marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që disiplina shkollore të zbatohet në mënyrë të pajtueshme me dinjitetin njerëzor të fëmijës dhe në përputhje me këtë Konventë.

3. Palët kontraktuese nxisin dhe inkurajojnë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e arsimit, për të kontribuar, në mënyrë të veçantë, në zhdukjen e padijes dhe të analfabetizmit kudo në botë dhe për të lehtësuar përvetësimin e njohurive shkencore e teknike dhe të metodave moderne të mësimdhënies. Për këtë, mbahen parasysh në mënyrë të veçantë nevojat e vendeve në zhvillim.

### **(28) Arsimimi**

*Fëmija ka të drejtë për arsimim. Shteti është i detyruar të sigurojë arsimim obligues fillor pa pagesë, nxit format e ndryshme të arsimit të mesëm të përshtatshëm për të gjithë, dhe të mundësojë qasjen arsimimit të lartë në harmoni me aftësitë e fëmijës. Disiplina shkollore do të zbatohet në harmoni me të drejtat e fëmijës dhe merrespektimin e dinjitetit të tij. Shteti do të përfshihet në bashkëpunimin ndërkombëtar me qëllim të realizimit të kësaj të drejte.*

Neni 29

1. Palët kontraktuese u morën vesh që arsimimi i fëmijës të ketë për synim:

(a) Të zhvillojë potencialin e plotë të personalitetit, dhuntive dhe aftësive mendore e fizike të fëmijës;

(b) Të rrisë respektin për të drejtat e liritë themelore të njeriut dhe për parimet e mishëruara në Kartën e Kombeve të Bashkuara;

(c) Të rrisë respektin për prindërit e fëmijës, për identitetin e tij, gjuhën dhe vlerat kulturore, për vlerat kombëtare të vendit ku fëmija jeton, të vendit të origjinës dhe të qytetërimeve të ndryshme nga i veti;

(d) Ta përgatisë fëmijën për një jetë të përgjegjshme në një shoqëri të lirë, në frymë e mirëkuptimit, paqes, tolerancës, barazisë midis sekseve dhe miqësisë midis të gjithë popujve, grupeve etnike, grupeve kombëtare e fetare dhe personave me origjinë autoktone;

(e) T'i zhvillojë fëmijës respektin për mjedisin natyror.

2. Asnjë dispozitë e këtij neni ose e nenit 28 nuk do të interpretohet në mënyrë të atillë që të cenojë lirinë e personave fizikë ose juridikë, për të krijuar e drejtuar qendra arsimore, gjithmonë me kusht që parimet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni të respektohen dhe që arsimi që jepet në këto qendra të jetë në përputhje me normat minimale që përcaktohen nga Shteti.

Neni 30

Në Shtetet ku ekzistojnë pakica etnike, fetare apo gjuhësore, ose persona me origjinë autoktone, një fëmije që i përket një minoriteti ose është autokton, nuk mund t'i mohohet e drejta për të pasur kulturën e vet, të ushtrojë dhe praktikojë fenë e vet, ose të përdorë gjuhën e vet së bashku me anëtarët e tjerë të grupit të tij.

Neni 31

1. Shtetet Palë i njohin fëmijës të drejtën të pushojë dhe argëtohet, të praktikojë lojëra dhe veprimtari çlodhëse, në përshtatje me moshën, si dhe të marrë pjesë lirisht në jetën kulturore dhe artistike.

2. Palët kontraktuese respektojnë dhe nxisin të drejtën e fëmijës për pjesëmarrje të plotë në jetën kulturore dhe artistike, inkurajojnë sigurimin e mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kohën e lirë dhe për veprimtari kulturore, artistike, argëtuese dhe çlodhëse.

Neni 32

1. Palët kontraktuese njohin të drejtën e fëmijës për t'u mbrojtur nga shfrytëzimi ekonomik dhe nga kryerja e çdo pune që paraqet rreziqe ose që cenon edukimin e tij ose dëmton shëndetin apo zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral ose shoqëror.

### **(29) Objektivat e arsimimit**

*Arsimimi do të ketë për objektiv zhvillimin e personalitetit të fëmijës, talentit dhe të aftësive mentale e fizike deri në mundësitë e tyre të fundit. Arsimimi do ta përgatisë fëmijën për jetë aktive në shoqërinë e lirë dhe do të kultivojë tek ai respektin ndaj prindërve, prejardhjes së tyre kulturore, gjuhës dhe besimit fetar si dhe respektin ndaj prejardhjes kulturore dhe vlerave të tjerëve.*

### **(30) Pakicat etnike**

*Fëmijët, pjesëtarë të pakicave etnike dhe të popullatës autoktone kanë të drejtë ta gëzojnë kulturën e tyre, ta predikojnë fenë përkatëse dhe ta shfrytëzojnë gjuhën e tyre.*

### **(31) Pushimi, loja, rekreacioni dhe aktiviteti kulturor**

*Fëmija ka të drejtë për pushim, lojë, kohë të lirë dhe pjesëmarrje në aktivitete kulturore e artistike.*

### **(32) Puna e fëmijëve**

*Fëmija ka të drejtë në mbrojtjen nga puna e cila e rrezikon shëndetin e tij, arsimimin ose zhvillimin. Shteti do ta normojë moshën minimale për punësim dhe do t'i rregullojë kushtet e punës.*

2. Palët kontraktuese marrin masa legislative, administrative, shoqërore dhe edukative, për të siguruar zbatimin e këtij neni. Për këtë qëllim dhe duke pasur parasysh dispozitat përkatëse të instrumenteve të tjera ndërkombëtare, Palët kontraktuese në mënyrë të veçantë:

(a) Përcaktojnë një moshë minimale ose moshat minimale të pranimit në punë;

(b) Parashikojnë një rregullim të përshtatshëm të orarit të punës dhe të kushteve të punës;

(c) Japin dënime ose sanksione të tjera të përshtatshme për të siguruar zbatimin efektiv të këtij neni.

Neni 33

Palët kontraktuese marrin të gjitha masat e duhura, duke përfshirë ato legislative, administrative, shoqërore dhe edukative, për të mbrojtur fëmijët nga përdorimi i paligjshëm i drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope, siç përcaktohen në konventat përkatëse ndërkombëtare dhe për të mos lejuar që fëmijët të përdoren për prodhimin dhe trafikun e paligjshëm të këtyre lëndëve.

Neni 34

Palët kontraktuese marrin përsipër të mbrojnë fëmijën nga çdo lloj forme e shfrytëzimit seksual dhe keqtrajtimit seksual. Për këtë qëllim, Palët kontraktuese marrin në mënyrë të veçantë të gjitha masat e duhura në planin kombëtar, dypalësh dhe shumëpalësh për të mos lejuar që:

(a) Fëmijët të nxiten ose të detyrohen për t'u përfshirë në veprimtari të paligjshme seksuale;

(b) Fëmijët të shfrytëzohen për qëllime prostitucioni ose praktika të tjera seksuale të paligjshme;

(c) Fëmijët të shfrytëzohen për shfaqje ose materiale pornografike.

Neni 35

Palët kontraktuese marrin të gjitha masat e nevojshme në planin kombëtar, dypalësh dhe shumëpalësh, për të mos lejuar rrëmbimin, shitjen, ose trafikun e fëmijëve për çdo qëllim dhe në çfarëdo forme qoftë.

Neni 36

Palët kontraktuese mbrojnë fëmijën nga çdo formë tjetër shfrytëzimi, që dëmton në çfarëdo aspekti mirëqenien e tij.

Neni 37

Palët kontraktuese sigurojnë që:

(a) Asnjë fëmijë të mos i nënshtrohet torturës, as trajtimeve ose dënimeve mizore, çnjerëzore ose poshtëruese. As dënimi me vdekje, as burgimi i përjetshëm nuk duhet të jepet për shkelje të ligjit; të kryera nga persona nën 18 vjeç;

### **(33) Keqpërdorimi i fëmijëve**

*Fëmijët janë të drejtë në mbrojtjen nga përdorimi i narkotikëve dhe drogave psikotrale. Shtetet kanë obligim ta pengojnë përdorimin e fëmijëve për prodhimin dhe qarkullimin e drogave.*

### **(34) Shfrytëzimi seksual**

*Shteti do të mbrojë fëmijët nga shfrytëzimi dhe keqtrajtimi seksual, përfshirë prostitucionin dhe pornografinë.*

### **(35) Rrëmbimi dhe tregtimi me fëmijë**

*Shteti është i obligueshëm të marrë të gjitha masat respektive për të penguar rrëmbimin, shitjen dhe tregtimin me fëmijë.*

### **(36) Format tjera të shfrytëzimit**

*Fëmija ka të drejtën e mbrojtjes nga çdo formë e shfrytëzimit të dëmshme për të mirën e tij, përpos atyre të cekura në nenet 32, 33 dhe 34.*

### **(37) Mundimi dhe privimi nga liria**

*Asnjë fëmijë nuk mund ti nënshtrohet mundimit, procedimit të vrazhdë apo dënimit as arrestimit të paligjshëm dhe privimit nga liria. As dënimi me vdekje, as burgu i përjetshëm pa mundësi të lirim, nuk do të gjykohen për kundërvajtjet që kryejnë personat nën moshën 18 vjeçe. Secili fëmijë i privuar nga liria veçohet prej të rriturve, përpos nëse nuk konsiderohet se kjo është në interesin më të mirë të fëmijës; ka të drejtë për ndihmë juridike e tjetër dhe të drejtën të mbajë kontakte me familjen e vet.*

(b) Asnjë fëmijë të mos i mohohet liria në mënyrë të paligjshme ose arbitrare. Arrestimi, ndalimi ose burgimi i një fëmijë duhet të jetë në përputhje me ligjin dhe të përdoret vetëm si një masë e fundit dhe për një kohë sa më të shkurtër.

(c) Çdo fëmijë i privuar nga liria të trajtohet në mënyrë njerëzore dhe me respektin që i takon dinjitetit të njeriut dhe në mënyrë të tillë; që të kihen parasysh nevojat e personave të moshës së tij. Në veçanti, çdo fëmijë i privuar nga liria duhet të veçohet nga të rriturit, me përjashtim të rastit kur mendohet se është në interesin më të lartë të fëmijës që kjo të shmanget dhe ai të ketë të drejtën të mbajë lidhje me familjen me korrespondencë dhe vizita, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme;

(d) Çdo fëmijë i privuar nga liria duhet të ketë të drejtën që t'i jepet menjëherë ndihmë juridike ose çdo ndihmë tjetër e përshtatshme, si dhe të drejtën të kundërshtojë vendimin për heqjen e lirisë përpara një gjykate ose një autoriteti tjetër kompetent, të pavarur dhe të paanshëm si dhe për një vendim të shpejtë për çdo rast të tillë.

Neni 38

1. Palët kontraktuese marrin përsipër të respektojnë dhe të bëjnë të respektohen rregullat e së drejtës humanitare ndërkombëtare, që janë të zbatueshme për ta në rast konflikti të armatosur dhe që kanë të bëjë me fëmijën.

2. Palët kontraktuese marrin të gjitha masat e mundshme për të siguruar që personat, të cilët nuk kanë mbushur moshën pesëmbëdhjetë vjeç, të mos marrin pjesë drejtpërdrejt në veprimet luftarake.

3. Palët kontraktuese nuk rekrutojnë në forcat e tyre të armatosura asnjë person që nuk ka mbushur moshën pesëmbëdhjetë vjeç. Kur ata rekrutojnë persona më të rritur se 15 vjeç por më të vegjël se 18 vjeç, Palët kontraktuese përpiqen të rekrutojnë më përpara më të mëdhenjtë në moshë.

4. Në përputhje me detyrimin që u takon në bazë të së drejtës humanitare ndërkombëtare, për të mbrojtur popullsinë civile në rast konflikti të armatosur, Palët kontraktuese marrin të gjitha masat e mundshme, për të siguruar mbrojtjen dhe kujdesin për fëmijët e prekur nga konflikti i armatosur.

Neni 39

Palët kontraktuese marrin të gjitha masat e duhura për të lehtësuar riaftësimin fizik e psikologjik dhe riintegrimin në shoqëri të çdo fëmijë që është viktimë: e çdo forme pakujdesie, shfrytëzimi ose keqtrajtimi, torture ose çdo forme tjetër të një trajtimi ose dënimi mizor, çnjerëzor e poshtërues ose konflikti të armatosur. Ky riaftësim dhe ky riintegrim duhet të bëhen në kushtet e një mjedisi, që ndihmon shëndetin, personalitetin dhe dinjitetin e fëmijës.

### **(38) Konfliktet e armatosura**

*Palët kontraktuese ndërmarrin të gjitha masat praktikisht të ekzekutueshme që fëmijët nën 15 vjeç të mos marrin pjesë direkt në konfliktet e armatosura. Fëmijët nën 15 vjeç nuk mund të rekrutohen në forcat e armatosura. Shtetet gjithashtu do të sigurojnë mbrojtjen dhe kujdesin mbi fëmijët të goditura me konfliktet luftarake, ashtu siç është paraparë kjo me ligjet respektive n ndërkombëtare.*

### **(39) Këndellja**

*Shteti ka detyrim të sigurojë këndellje Respektive Fizike e psikike dhe riintegrimin social të fëmijëve të cilët janë viktimë e konflikteve luftarake, të mundimit, elidimit, shfrytëzimit ose keqtrajtimit.*



Neni 40

1. Palët kontraktuese i njohin çdo fëmijë të dyshuar, të akuzuar ose për të cilin është thënë se ka kryer shkelje të ligjit penal, të drejtën e një trajtimi të tillë, që zhvillon te fëmija ndjenjën e dinjitetit dhe të vlerës së personit, që përforcon tek ai ndjenjën e respektit të tij për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve dhe që merr parasysh moshën e fëmijës si dhe dëshirën për të ndihmuar në riintegrimin e tij në shoqëri dhe në mënyrë që ai të luajë një rol konstruktiv në gjirin e saj.

2. Për këtë qëllim dhe duke pasur parasysh dispozitat përkatëse të instrumenteve ndërkombëtare, Palët kontraktuese kujdesen në veçanti që:

(a) Asnjë fëmijë të mos jetë i dyshuar, i akuzuar ose i cilësuar për shkelje të ligjit penal për arsye të veprimeve ose mosveprimeve që nuk kanë qenë të ndaluara nga e drejta e brendshme ose ndërkombëtare në momentin kur ato janë kryer;

(b) Çdo fëmijë i dyshuar ose i akuzuar për shkelje të ligjit penal të ketë të paktën garancitë që vijojnë:

(I) Të supozohet i pafajshëm derisa të provohet pafajësia ligjërisht;

(II) Të informohet menjëherë dhe drejtpërdrejt për akuzat e ngritura kundër tij, nëse është e përshtatshme, me anë të prindërve të tij ose të përfaqësuesve ligjorë, dhe të ketë ndihmë juridike ose nga çdo ndihmë tjetër të duhur për përgatitjen dhe paraqitjen e mbrojtjes së tij;

(III) Çështja e tij të shqyrtohet pa vonesë nga një autoritet ose instancë gjyqësore kompetente, e pavarur dhe e paanshme, sipas një procedure të drejtë ligjore, në praninë e ndihmës juridike ose të një ndihme tjetër të përshtatshme, dhe, kur gjykohet se kjo nuk është në interesin më të lartë të fëmijës, sidomos për arsye të moshës ose gjendjes së tij, në prani të prindërve ose përfaqësuesve të tij ligjorë.

(IV) Të mos detyrohet të dëshmojë ose të pohojë veten fajtor; të pyeten ose të bëjë të pyeten dëshmitarët e akuzës dhe të sigurojë paraqitjen dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve të mbrojtjes së tij, në kushte të barabarta.

(V) Në qoftë se vendoset se ka shkelur ligjin penal, të bëjë ankim kundër këtij vendimi si dhe çdo masë të marrë si pasojë, para një autoriteti ose një instance gjyqësore kompetente më të lartë, të pavarur dhe të paanshme, në përputhje me ligjin.

(VI) Të ndihmohet falas nga një përkthyes, në qoftë se ai nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën që përdoret.

(VIII) Të respektohet plotësisht jeta e tij private në të gjitha fazat e procedurës.

#### **(40) Gjyqësia për të mitur**

*Fëmija që është në konflikt me ligjin ka të drejtën e procedimit me të cilin nxitet dinjiteti i tij dhe ndjenjat e vlerave personale, i cili shfaq kujdes mbi moshën e tij dhe që shpie në riintegrimin e tij social. Fëmija ka të drejtë për ndihmë juridike e tjetër me qëllim të mbrojtjes së vet. Procedimi gjyqësor dhe vendosja në institucionet ndëshkimore do të evitohet sa herë që kjo është e mundshme.*

3. Palët kontraktuese përpiqen të nxisin krijimin e ligjeve, procedurave, organeve dhe institucioneve të posaçme për fëmijët që dyshohen, akuzohen ose që vlerësohen se kanë kryer shkelje të ligjit penal dhe në veçanti:

(a) Përcaktojnë një moshe minimale, nën të cilën fëmijët prezumohen të paaftë për të shkelur ligjin penal;

(b) Marrin masa, sa herë është e nevojshme dhe e dëshirueshme, për t'i trajtuar këta fëmijë pa iu drejtuar procedurës gjyqësore, me kusht që të respektohen plotësisht të drejtat e njeriut dhe mbrojtja ligjore.

4. Vihen në dispozicion masa të ndryshme, siç janë kujdesi, orientimi dhe kontrolli; këshillat; periudha e provës; kujdesi në familje; programet e edukimit të përgjithshëm dhe profesional dhe zgjidhje të tjera, veç atyre institucionale, për t'u siguruar fëmijëve një trajtim në përputhje me mirëqenien e tyre dhe në raport me gjendjen e tyre dhe me shkeljen e ligjit.

Neni 41

Asnjë nga dispozitat e kësaj Konvente nuk cenon dispozitat më të favorshme për realizimin e të drejtave të fëmijës, që mund të parashikohen:

(a) në legjislacionin e një Pale kontraktuese; ose

(b) në të drejtën ndërkombëtare në fuqi për atë shtet.

## PJESA II

Neni 42

Palët kontraktuese marrin përsipër t'ua bëjnë gjerësisht të njohura parimet dhe dispozitat e kësaj Konvente, si të rriturve ashtu edhe fëmijëve, me anë të mjeteve energjike të përshtatshme.

Neni 43

1. Me qëllim që të shqyrtohen përparimet e arritura nga Palët kontraktuese në përmbushjen e detyrimeve të marra përsipër prej tyre në bazë të kësaj Konvente, krijohet një Komitet mbi të Drejtat e Fëmijës, i cili kryen funksionet e caktuara si më poshtë.

2. Komiteti përbëhet nga dhjetë ekspertë me moral të lartë dhe që njihen si

kompetentë në fushën që trajton kjo Konventë. Anëtarët e tij zgjidhen nga Palët kontraktuese midis shtetasve të tyre dhe marrin pjesë me titull personal, duke pasur parasysh një shpërndarje gjeografike të drejtë dhe sistemet juridike kryesore.

3. Anëtarët e Komitetit zgjidhen me votë të fshehtë, nga një listë personash të caktuar nga Palët kontraktuese. Çdo Palët kontraktuese mund të caktojë një kandidat nga shtetasit e tij.

**(41) Respektimi i standardeve më të larta** Në qoftë se standardet e të drejtave të fëmijëve të ligjeve kombëtare e ndërkombëtare në fuqi më të larta nga ato që i parashikon kjo Konventë, do të zbatohen standardet më të larta.

**(42) Njohja me Konventën**

Palët kontraktuese kanë detyrim që me të Drejtat që i mbanë kjo Konventë ti Njohin si të rriturit ashtu edhe fëmijët.

**Zbatimi dhe hyrja në fuqi e Dispozitave të neneve 43 deri 54 parashikojnë**

(I) Formimi i Komitetit për të Drejtat e Fëmijës, i për bërë nga 10 ekspertë, të cilët do të shqyrtojnë raportet e shteteve anëtare të konventës, pas 2, respektivisht 5 vitesh pas ratifikimit të Konventës. Konventa hy në fuqi pasi ta ratifikojnë 20 shtetet e para.

(II) Shtetet janë të detyrueshme që raportet e veta tua bëjnë të kapshëm opinionit më të gjerë të vendeve të veta.

(III) Komiteti për të drejtat e fëmijëve mund të propozojë që të bëhen studime të veçanta mbi çështjet e të drejtave të fëmijëve dhe vlerësimet e veta të raportit mund t'ia në shikim secilës palë kontraktuese dhe Asamblesë së Përgjithshme të KB.

(IV) Për "nxitjen e zbatimit efektiv të Konventës dhe të avancimit të bashkëpunimit Ndërkombëtar",

4. Zgjedhja e parë bëhet jo më vonë se gjashtë muaj nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente. Më pas zgjedhjet bëhen çdo dy vjet. Të paktën katër muaj para datës së çdo zgjedhjeje, Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara fton me shkrim Palët kontraktuese të propozojnë kandidatët e tyre brenda një afati dymujor. Sekretari i Përgjithshëm bën më pas listën alfabetike të kandidatëve të caktuar, duke cilësuar Palët kontraktuese që i kanë caktuar dhe ua paraqit ata Shteteve Palë në këtë Konventë.

5. Zgjedhjet bëhen gjatë mbledhjeve të Palëve kontraktuese, të organizuara nga Sekretari i Përgjithshëm në Selinë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Në këto mbledhje, në të cilat duhet të jenë të pranishëm jo më pak se dy të tretat e Palëve kontraktuese, kandidatët të zgjedhur në Komitet janë ata që fitojnë numrin më të madh të votave dhe shumicën absolute të votave të Palëve kontraktuese të pranishëm dhe votues.

6. Anëtarët e Komitetit zgjidhen për një mandat katërvjeçar. Ata mund të rizgjidhen në qoftë se kandidatura e tyre paraqitet përsëri. Mandati i pesë prej anëtarëve të zgjedhur në zgjedhjen e parë mbaron pas dy vjetësh. Emrat e këtyre pesë anëtarëve hidhen në short nga Kryetari i mbledhjes, menjëherë pas zgjedhjes së parë.

7. Në rast se një anëtar i Komitetit vdes ose jep dorëheqjen ose deklaron se për çdo arsye tjetër nuk mund t'i kryejë më funksionet e tij në Komitet, Shteti Palë, që kishte paraqitur kandidaturën e tij, emëron një tjetër ekspert nga shtetasit e vet, për të plotësuar vendin e lirë deri në përfundimin e mandatit korrespondues, gjë që i nënshtrohet miratimit të Komitetit.

8. Komiteti miraton rregulloren e tij të brendshme.

9. Komiteti zgjedh byronë e tij për një periudhë prej dy vjetësh.

10. Mbledhjet e Komitetit zakonisht mbahen në Selinë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara ose në çdo vend tjetër të përshtatshëm, të caktuar nga Komiteti. Komiteti mbledhet zakonisht çdo vit. Zgjatja e sesioneve të tij përcaktohet dhe ndryshohet, në rast se është e nevojshme, nga një mbledhje e Palëve kontraktuese në këtë Konventë, me rezervën e miratimit nga Asambleja e Përgjithshme.

11. Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara vë në dispozicion të Komitetit personelin dhe pajisjet e nevojshme, për të kryer me efektivitet funksionet që i janë besuar në bazë të Konventës.

12. Me miratimin e Asamblesë së Përgjithshme, anëtarët e Komitetit të krijuar në bazë të kësaj Konvente paguhën nga të ardhurat e OKB-së, sipas kushteve dhe modaliteteve të caktuara nga Asambleja e Përgjithshme.

*agjencitë specializuara të KB, sikurse janë: UNESCO, UNICEF, Organizata Botërore e Shëndetësisë, kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet e Komitetit për të drejtat e fëmijës. Këto organizata si dhe trupat tjerë kompetentë, përfshirë organizatat joqeveritare me status konsultues pranë Kombeve të Bashkuara, mund të ofrojnë informata ose këshilla të çmueshme me qëllim të zbatimit optimal të Konventës.*

#### Neni 44

1. Palët kontraktuese marrin përsipër të paraqitin në Komitet, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, raporte mbi masat e marra për të përmbushur të drejtat e njohura në këtë Konventë dhe mbi përparimet e realizuara në gëzimin e këtyre të drejtave:

- (a) Brenda dy vjetëve, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente për Palët kontraktuese;
- (b) Në vazhdim në çdo pesë vjet.

2. Raportet e paraqitura në zbatim të këtij neni tregojnë faktorët dhe vështirësitë, në rast se ka, që kanë ndikuar në shkallën e përmbushjes nga Palët kontraktuese të detyrimeve të parashikuara në këtë Konventë. Raportet duhet të përmbajnë gjithashtu të dhëna të mjaftueshme për t'i dhënë Komitetit një ide të plotë për zbatimin e Konventës në vendin përkatës.

3. Palët kontraktuese, që kanë paraqitur në Komitet raportin e parë të plotë, nuk përsërisin në raportet që i paraqesin atij në vazhdim, sipas pikës (b) të paragrafit të parë të këtij neni, sqarimet kryesore, të komunikuar qysh më parë.

4. Komiteti mund t'u kërkojë Palëve kontraktuese të dhëna plotësuese, që kanë të bëjnë me zbatimin e Konventës.

5. Komiteti i paraqit çdo dy vjet Asamblesë së Përgjithshme, nëpërmjet Këshillit Ekonomik dhe Shoqëror, një raport mbi veprimtarinë e tij.

6. Palët kontraktuese sigurojnë një shpërndarje të gjerë të raporteve të tyre në vendet e tyre.

#### Neni 45

Për të arritur zbatimin efektiv të Konventës dhe për të inkurajuar bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën që mbulon kjo Konventë:

(a) Agjencitë e specializuara, Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët dhe organe të tjera të Kombeve të Bashkuara, kanë të drejtë të përfaqësohen gjatë shqyrtimit të zbatimit të dispozitave të kësaj Konvente, që kanë të bëjnë me mandatin e tyre. Komiteti mund të ftojë agjencitë e specializuara, Fondin e Kombeve të Bashkuara për Fëmijët dhe të gjitha organet e tjera kompetente, që ai do ta gjykojë të arsyeshme, për të dhënë mendime të specializuara mbi zbatimin e Konventës në fusha që kanë të bëjnë me mandatin e tyre përkatës. Ai mund të ftojë agjencitë e specializuara, Fondin e Kombeve të Bashkuara për Fëmijët dhe organe të tjera të Kombeve të Bashkuara për t'i paraqitur raporte mbi zbatimin e Konventës në sektorët që kanë të bëjnë me fushën e veprimtarisë së tyre;

(b) Komiteti u transmeton agjencive të specializuara, Fondit të Kombeve të Bashkuara për Fëmijët dhe organeve të tjera kompetente, në rast se e sheh të nevojshme, çdo raport të Palëve kontraktuese, që përmban një kërkesë ose që tregon një nevojë për këshilla ose ndihmë teknike, së bashku me vërejtjet dhe sugjerimet e Komitetit, në rast se ka të tilla;

(c) Komiteti mund t'i rekomandojë Asamblesë së Përgjithshme, që t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm, të ndërmarrë në emër të tij studime për çështje të veçanta, që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijës;

(d) Komiteti mund të bëjë sugjerime dhe rekomandime të përgjithshme, të bazuara në të dhënat e marra në zbatim të neneve 44 dhe 45 të kësaj Konvente. Këto sugjerime dhe rekomandime të natyrës së përgjithshme i transmetohen çdo Pale kontraktuese të interesuar dhe i përcillen për dijeni Asamblesë së Përgjithshme, të shoqëruara, në rast se ka të tilla, me vërejtjet e Shteteve Palë.

## PJESA III

Neni 46

Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim nga të gjithë Shtetet.

Neni 47

Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit. Instrumentet e ratifikimit depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Neni 48

Konventa do të qëndrojë e hapur për aderim nga çdo shtet. Instrumentet e aderimit depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Neni 49

1. Kjo Konventë hyn në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës së depozitimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, të instrumentit të njëzetë të ratifikimit ose aderimit.

2. Për secilin Shtet që ratifikon këtë Konventë ose aderon në të, pas depozitimit të instrumentit të njëzetë të ratifikimit ose aderimit, Konventa hyn në fuqi ditën e tridhjetë pas depozitimit nga ky shtet, të instrumentit të tij të ratifikimit ose aderimit.

Neni 50

1. Çdo Shtet Palë mund të propozojë një amendament dhe të depozitojë tekstin pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Sekretari i Përgjithshëm ua komunikon pastaj amendamentin e propozuar Palëve kontraktuese, duke kërkuar që t'i bëjnë të ditur nëse janë për thirrjen e një konference të Palëve kontraktuese për shqyrtimin e propozimit dhe të hedhjes në votë. Nëse brenda katër muajve pas datës së këtij komunikimi, të paktën një e treta e Palëve kontraktuese shprehen për thirrjen e një konference të tillë, Sekretari i Përgjithshëm thërret konferencën nën kujdesin e Organizatës të Kombeve të Bashkuara. Çdo amendament i miratuar nga shumica e Palëve kontraktuese të pranishëm dhe votues në konferencë i paraqitet për miratim Asamblesë së Përgjithshme.

2. Një amendament i miratuar në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni hyn në fuqi pasi të jetë miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara dhe të jetë pranuar nga dy të tretat e Palëve kontraktuese.

3. Kur një amendament hyn në fuqi, ai bëhet i detyrueshëm për të gjithë Palët kontraktuese, që e kanë pranuar dhe shtetet e tjerë që mbeten të lidhur me dispozitat e kësaj Konvente dhe me të gjithë amendamentet e mëparshme të pranuar prej tyre.

#### Neni 51

1. Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara merr dhe ua dërgon të gjithë shteteve tekstin e rezervave të bëra nga Shtetet në çastin e ratifikimit ose të aderimit.

2. Nuk lejohet asnjë rezervë e papajtueshme me objektin dhe qëllimin e kësaj Konvente.

3. Rezervat mund të tërhiqen në çdo kohë, nëpërmjet njoftimit drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, i cili informon për këtë të gjithë Palët kontraktuese në Konventë. Njoftimi hyn në fuqi në datën kur ky është marrë nga Sekretari i Përgjithshëm.

#### Neni 52

Çdo Palë kontraktuese mund ta denoncojë këtë Konventë me anë të një njoftimi me shkrim, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Denoncimi hyn në fuqi një vit pas datës kur njoftimi është marrë nga Sekretari i Përgjithshëm.

#### Neni 53

Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara caktohet si depozitues i kësaj Konvente.

#### Neni 54

Origjinali i kësaj Konvente, e punuar në gjuhët angleze, arabe, kineze, spanjolle, franceze dhe ruse, me vlerë të barabartë, depozitohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Për vërtetim, të nënshkruarit, të plotfuqishëm e të ngarkuar ligjërisht nga qeveritë përkatëse, nënshkruan këtë Konventë.

## Shtojca 3. TË VËRTETAT DHE LAJTHITJET MBI TË DREJTAT E FËMIJËS<sup>3</sup>

Fëmijët kanë të drejtë të bëjnë çfarë të donë!

JO SAKTË. Të drejtat e fëmijës nuk nënkuptojnë lirinë absolute të bërjes. Duke mësuar se ka të drejta, fëmija mëson se të drejtat kanë kufizimet e veta, se po të njëjtat të drejta u takojnë edhe tjerëve dhe se realizimi i të drejtave veta nuk guxon tir rrezikojë tjerët në realizimin e të drejtave të tyre.

Detyrimet më të mëdha në realizimin e Konventës mbi të drejtat e fëmijës u takojnë prindërve!

JO SAKTË. Përgjegjësia dhe detyrimet më të madha janë në shtetin. Roli i prindërve është më i rëndësishëm dhe shteti duhet ta respektojë të drejtën dhe përgjegjësinë e prindërve që ta orientojnë fëmijën e vet në përputhje me mundësit e tija. Njëkohësisht, shteti lypset tu ndihmojë prindërve në realizimin e përgjegjësve të tyre ashtu që do të sigurojë zhvillim të institucioneve, të kapaciteteve dhe shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve, dhe njëkohësisht ndihmën materiale kur kjo është e domosdoshme.

Më shumë të drejta për fëmijë- më pak të drejta për të rriturit!

JO SAKTË. Domethënia e të drejtave të fëmijëve nuk është zëvendësimi i autoritetit ose i anarkisë, veç krijimi i parakushteve për realizimin e të drejtave të njeriut të secilit individ pavarësisht nga mosha. Të respektosh të drejtave të fëmijës do të thotë të sigurosh jetë dhe zhvillim në siguri dhe në ambientin e shëndosh ku nxitet realizimi i potencialeve të fëmijës për t'i dhënë kontribut shoqërisë edhe si fëmijë edhe si i rritur.

Disa të drejta janë më të rëndësishme nga tjerat!

JO SAKTË. Nuk ka më, respektivisht, më pak të drejta të rëndësishme, nuk ekziston hierarkia e të drejtave. Fjala është vetëm për faktin se secila e drejtë në situatë të caktuar për ndonjë fëmijë mund të bëhet më e rëndësishme dhe se realizimi/mbrojtja e saj bëhet prioritet.

U japim fëmijëve të drejtë, por çka është me përgjegjësinë e tyre!? Le të tregojnë se i meritojnë të drejtat e veta!

JO SAKTË. Së pari, nuk ua japim ne të drejtat fëmijëve dhe të drejtat nuk meritojnë, veç se ato takojnë me vetë lindjen. Së dyti, duke u angazhuar për realizimin e të drejtave të veta, fëmijët e zhvillojnë ndjenjën përgjegjësisë dhe të respektimit të drejtave të individëve tjerë dhe të grupeve. Rrethi i cili e respekton fëmijën si personalitet dhe partner, njëkohësisht domethënë edhe nxitje për veprim të përgjegjshëm.

Fëmijët nuk janë mjaftë të pjekur të marrin pjesë në miratimin e vendimeve të rëndësishme!

JO SAKTË. A është ndonjë vendim i rëndësishëm për vetë fëmijën, do ta dimë tek atëherë kur këtë e pyesim. Në jetën e çdo fëmije dhe në të gjitha moshat ekzistojnë gjëra të cilat i përkasin direkt dhe të cilat për atë janë të rëndësishme. Ka shumë tema e përmbajtje në familje, shkollë, bashkësi mbi të cilat fëmija mund të dëgjohet, kurs mendimi i tij/i saj është respektuar. Nëse në m mënyrë të drejtë merren parasysh qëndrimet e fëmijëve, dhe mendimet e vendimet të cilat mbështeten në to do të jenë më të vlefshme dhe më kuptimore.

Me imponimin e përgjegjësisë fëmijëve shkelet e drejta për fëmijëri të qetë e fatlume.

JO SAKTË. Krijimi i rrethanave në të cilat fëmijët kanë mundësi të thonë, të veprojnë dhe të vlerësohen, nuk bartë vetvetiu mohimin e fëmijërisë. Me atë që do të ketë kontrollin më të madh mbi jetën e vet. Nuk do të thotë se do të ketë më pak kohë për lojë dhe më shumë brenga, veç se zhvillimi i tij do të jetë më i plotë dhe më i begat.

<sup>3</sup>Broshura e Qendrës për të Drejtat e Fëmijës ([www.cpd.org.rs](http://www.cpd.org.rs)) dhe i grupit Fëmijët Fëmijëve ([www.decadeci.org.rs](http://www.decadeci.org.rs))

## Shtojca 4

# PYETJET E MUNDSHME ME TË CILAT MUND TË MERREN NXËNËSIT

Në vazhdim janë disa nga shembujt e pyetjeve me të cilat mund të merren nxënësit, mirëpo me këtë nuk shteret lista e situatave të mundshme ose e problemeve. Në secilin mësimdhënës është që në harmoni me e specifikat e ambientit shkollor, si dhe të nevojave të nxënësve të vet, ti ndihmojë grupit të cek problemet të cilët i konsideron të qenë

**Mësimi i rregullt:** Propozimi i metodës së mësimit dhe i të mësuarit; i orarit të pyetjes, orarit të detyrave kontrolluese; njohja e nxënësve me notimin; opinioni, kriteret...;

**Mësimi plotësues dhe shtues:** Përmbajtjet e nevojshme, organizim i kohës së mbajtjes së këtyre orëve, mënyra e realizimit (edukata e moshatarëve, e mësimdhënësve të lëndëve të caktuara dhe prindërve);

### **Aktivitetet jashtëmësimore:**

Organizimi i ligjëratave në shkolla për temat sikurse janë narkomania, alkoolizmi, arsimimi seksual, dhuna në shkollë, edukata e trafikut, inicimi i seksioneve shkollore nëse sipas mendimit të nxënësve oferta e seksioneve në shkollë nuk është në harmoni me interesimin e tyre, inicimi apo aktivizimi i revistës shkollore në të cilën nxënësit do të punojnë, organizimi i vallëzimeve në shkollë apo i aktiviteteve me karakter zbavitës, shitës humanitar, bursa e librave të përdorur, kuizit të dijenisë, të zbatohet anketa midis nxënësve tjerë rreth çështjeve të ndryshme që u interesojnë...

**Aktivitetet jashtëshkollore:** Pjesëmarrja në vendimmarrjen mbi destinacionin e piknikut, mësimin rekreativ, ekskursioneve...;

**Shoqatat dhe organizatat e nxënësve:** Njëra nga iniciativat mund të jetë aktivizimi i punës së lidhjes së fëmijëve në shkollë (në klasën shtatë të parlamentit të nxënësve), propozimi i aktiviteteve të cilat do t'i inicionte ajo shoqatë...

**Organizimi hapësinor:** Pajisja e bibliotekës së shkollës, pajisja e dispanzerit të shkollës, rinovimi i lokaleve të caktuara të shkollës, ndërtimi i sallës për edukatë fizike, blerja e mjeteve themelore për punë në shkollë...

**Rregullat në nivel të shkollës:** Me cilat rregullore do të njihen nxënësit, për nxjerrjen e cilave rregulla janë konsultuar, në nxjerrjen e cilave rregulla mund të marrin pjesë apo kanë marrë pjesë: Rregullorja mbi notimin, Rregullorja mbi sjelljen, Rregullorja mbi masat edukativo-disiplinore...

Problemi të cilin mund ta zgjedhin nxënësit mund të jetë edhe ndonjë i cili kërkon strategjinë gjithëpërfshirëse kombëtare për zgjidhje. Mirëpo, nxënësit mund të propozojnë mënyrat me të cilat ai problem mund të zgjidhet në nivel të shkollës së tyre. Grupi i nxënësve nga Sokobanja të cilët janë marrë me problemin e dhunës në shkollë e kanë kundruar në nivel të raporteve midis nxënësve dhe kanë propozuar këtë: (a) organizimin e takimeve të prindërve në të cilat do të bisedohej mbi sjelljen e nxënësve dhe problemet me të cilat po ndeshen nxënësit të kësaj moshe.; (b) futja e orëve të sjelljes së mirë dhe e komunikimit pa-dhunë; (c) angazhimin policit i cili do të kujdesej mbi sigurinë e nxënësve në oborrin e shkollës; (ç) vendosja e dollapit të vogël në korridoret e shkollës për lënien e sendeve, që të evitohet goditja me këmbë dhe hedhja e gjësendeve nga ana e nxënësve agresiv. Nxënësit i kanë ekspozuar propozimet në Këshillin e prindërve, Këshillin e mësimdhënësve dhe Këshillin shkollor, duke pritur nga ata ndihmë konkrete në realizim. Rolin e shërbimit pedagogjik psikologjik të shkollës nxënësit e kanë pa në organizimin e punishteve në temën e dunës midis nxënësve, si dhe në zhvillimin e bisedës me nxënësit agresiv dhe me prindërit e tyre. Me propozimin nxënësve, drejtori i shkollës ka biseduar me shefin postëkomandës së policisë në Sokobanja, pas çka shkolla e mori policin i cili ishte i ngarkuar për sigurinë në oborrin e shkollës dhe në rrethinën e afërt të shkollës.



## Shtojca 5. LOJËRAT PËR NDËRTIMIN E EKIPIT

1. Në mesin e hapësirës në të cilën punohet vihet në tenxhere e cila nuk ka dorëza. Rreth tenxheres vihen gjashtë persona (sa persona do të vihen rreth tenxheres varet nga madhësia tenxheres). Detyra për grupet është të ulën dhe secili me gishtin e vet tregues ta ngrit tenxheren mbi nivelin e trupit.
2. Për grupin prej 15 pjesëmarrësve nevojiten katër letra të formatit L'. Grupi duhet ta bëjë strategjinë që letrën e të gjithë 15 pjesëmarrësve ta mbajnë në dorë e me atë rast këmbët të mos i kenë në dysHEME.
3. Ushtrimi bëhet në grupe nga pesë veta. Detyra për grupet është që secili grup nga trupat e vet ta bëjë makinën (kositësen, mikserin, TV...). Në kuadër të grupeve të veta pjesëmarrësit duhet të merren vesh si do ta bëjnë makinën, kush cila pjesë do të jetë, dhe kush tjerëve do tua prezantojë makinën. Detyra për tjerët është ta qëllojnë se për cilën makinë është fjala.
4. Ushtrimi bëhet në grupe nga pesë veta. Nga secili grup ndahet nga një person. Atyre personave moderatori u tregon si bëhet kutia prej letre. Kur kthehen në grupet e veta kanë detyrë që të gjithë bashkë të bëjnë sa më shumë kuti për 15 minuta.
5. Ndani nxënësit në grupe (prej 5-6 nxënës) dhe secilit grup jepni nga një qese “smoki” dhe nga një kuti shkrepe. Secilit grup jepni detyrë që në afatin prej 5 minutash ta bëjë shtëpizën nga materiali në fjalë, por ashtu që secili nga ata të shfrytëzojë vetëm një dorë. Nëse keni kushte, mund të bëni edhe këtë: Ndani nxënësit në grupe (prej 5-6 nxënës) dhe secilit jepni nga 8 letra të mëdha, 4 gota plastike, shirit për ngjitje. Secilit grup jepni detyrë që në afatin prej 15 minutash ta ndërtojë shtëpizën ashtu që ajo nga njëra anë të ketë hyrje nëpër të cilën mund të hyjë një nxënës.

## Shtojca 6. DISA NGA PYETJET PËR ZHVILLIMIN E DISKUTIMIT MBI PUNËN E KIPIT

- A keni nisur menjëherë me punën apo më parë e keni menduar mirë strategjinë?
- Sa propozime ka pasur grupi?
- A pati vështirësi në harmonizimin e grupit?
- Si jeni përcaktuar për një zgjidhje?
- A kanë qenë të angazhuar të gjithë anëtarët e ekipit?
- A ka ekzistuar ndarja e punëve brenda ekipit?
- A janë veçuar rolet në ekip (lideri, finisheri...)?
- A keni menduar mbi materialin dhe kushtet për punë?
- A ka pasur shmangie nga zgjidhja e dakorduar?
- A ka pasur ndihmë reciproke dhe bashkëpunim midis anëtarëve?
- A është kujdesur dikush për kohën?
- Rreth çkaje më parë jeni marrë vesh?
- A keni dyshuar në sukses?
- A ka pasur ide të ndryshme për zgjidhjen e problemit?
- Si jeni përcaktuar për atë mënyrë të zgjidhjes së problemit?
- A ka pasur kundërshtime lidhur me zgjidhjet e përzgjedhura?
- A jeni të kënaqur me mënyrën e zgjidhjes?
- Nëpër cilat faza ka kaluar puna juaj?
- A është arritur objektivi?
- Çka keni bërë nëse ka pasur mendime të kundërta?
- A keni kremtuar?
- Çka keni menduar kur e keni dëgjuar detyrën?
- Si jeni ndie në fund të ushtrimit?
- A e keni dhe në çka e keni dalluar fuqinë e këtij ekipi?


## Shtojca 7. Nivelet e participimit me shembuj

NIVELET E PARTICIPIMIT	SHEMBUJT
<b>Të rriturit e iniciojnë ndonjë temë/ aksion. Nga fëmijët kërkohet të marrin pjesë, u thuhet çka duhet të bëjnë dhe thonë.</b>	<b>Të rriturit kërkojnë nga fëmijët të marrin pjesë në pritjen e mysafirëve në shfaqjen e shkollës dhe u jepet fjalimi që duhet ta lexojnë si shenjë e mirëseardhjes.</b>
Të rriturit iniciojnë ndonjë temë/ aksion. Fëmijët kyçen në proces (janë të informuar mbi temën e aksionit, dinë përse dhe si duhet të kyçen) por nuk mund të marrin pjesë në hartimin e programit të aktiviteteve. Të rriturit pas kësaj e zhvillojnë aksionin.	Të rriturit organizojnë shfaqjen e shkollës, i informojnë fëmijët mbi qëllimin e shfaqjes, fëmijët dinë kujt i është destinuar shfaqja dhe kush do të jetë i pranishëm prej mysafirëve. Kanë mënyrë si të kyçen në programin e shfaqjes, por nuk mund ta ndryshojnë programin.
Të rriturit iniciojnë ndonjë temë/ aksion. Fëmijët kyçen në proces. Të rriturit pas kësaj marrin vendimin/ e zhvillojnë aksionin dhe i informojnë fëmijët.	Të rriturit e iniciojnë aksionin e mbledhjes së reciklzhës. Fëmijët kyçen në mbledhjen e reciklzhës. Të rriturit mbledhin para dhe marrin vendimin ku do të shpenzojnë.
Fëmijët iniciojnë ndonjë temë/ aksion. I thërrasin të rriturit të kyçen dhe të marrin pjesë e të ndihmojnë. Barabartë marrin vendime/i realizojnë aktivitetet	Fëmijët e iniciojnë aksionin e mbledhjes së reciklzhës. I thërrasin të rriturit të kyçen e që edhe ata të marrin në mbledhjen e reciklzhës.
Fëmijët e iniciojnë ndonjë temë/ aksion. I thërrasin të rriturit të kyçen dhe të marrin pjesë e të ndihmojnë. Barabartë marrin vendime/ e realizojnë aktivitetin.	Fëmijët e iniciojnë aksionin e mbledhjes së reciklzhës. I thërrasin fëmijët të kyçen. Bashkë marrin vendim si do të shpenzojnë të hollat që i kanë mbledhur nga shitja e reciklzhës. Bashkë marrin vendimin si do të shpenzojnë paratë që i kanë mbledhur nga shitja e reciklzhës.
Fëmijët iniciojnë ndonjë iniciativë/ aksion. Vendi i marrin plotësisht të pavarur/ i realizojnë aktivitetet.	Fëmijët marrin iniciativën për mbledhjen e reciklzhës. Marrin vendime të pavarura si do të organizojnë aksionin dhe si do të shpenzohen mjetet e mbledhje nga aksioni.

## Shtojca 8. Kartelet për nxënës- nivelet e participimit

NIVELET E PARTICIPIIMIT	SHEMBUJT
<p>Të rriturit iniciojnë ndo një temë/aksion.  Fëmijët kyçën në proces (janë të informuar  Mbi temën e aksionit, dinë se përse dhe si  Duhet të kyçën), por nuk mund të marrin  Pjesë në hartimin e programit të aktiviteteve.  Të rriturit pas kësaj e zhvillojnë aksionin.</p>	
<p>Të rriturit iniciojnë ndo një temë/aksion.  Fëmijët kyçën në proces.  Të rriturit pas kësaj marrin vendimin/  e zhvillojnë aksionin dhe i informojnë  fëmijët.</p>	
<p>Të rriturit e iniciojnë ndo një temë/aksion.  I thërrasin fëmijët që të kyçën.  Barabar i marrin vendimet/ e realizojnë  aktivitetin.</p>	
<p>Fëmijët e iniciojnë ndo një temë/aksion.  I thërrasin të rriturit që të kyçën dhe të  marrin pjesë e të ndihmojnë.  Barabar marrin vendime/ e realizojnë  aktivitetin.</p>	
<p>Fëmijët marrin ndonjë iniciativë/aksion.  Plotë të pavarur i marrin vendimet/i  realizojnë aktivitetet.</p>	

## Shtojca 9. Shembulli i kornizës së planit të aksionit



# Shtojca 10. Tabela e dinamikës kohore

AKTIVITETI	DATA										NGARKIMET	MJETET MATERIALET PAISJET

## **Shtojca 11. PREZANTIMI PUBLIK**

Të flitet në opinion ndoshta është gjëja më e vështirë që pritet nga dikush. Shumica janë të frikësuar dhe nuk ndihen mirë derisa qëndrojnë përpara publikut dhe flasin. Frikësohet se do të koritën dhe do të poshtërohen, se do ta prishin imazhin mbi vetveten. Është interesant se shumica e njerëzve të cilët frikësohen nga paraqitja publike, a s që mund ta caktojë se nga çka frikësohet. Thjeshtë, ata frikësohen.

Mësimi dhe zhvillimit i zotësisë së parashtrimit mësohet si edhe cila do shkathtësi tjetër komplekse ose zanat. Nëse dikujt i themi thjeshtë të qëndrojnë përpara publikut dhe ti kujtohet çka duhet të thotë, që atë ta thotë qartë e më atë rast ajo të tingëllojë interesant dhe, patjetër, ta shikojë publikun derisa flet, nuk mund ta shpresojmë suksesin. Zotësia e parashtrimit përqendrohet në tetë fusha kyçe në të cilat zhvillohen teknikat e domosdoshme për paraqitje efektive oratorike. Këto fusha janë:

1. Përfytyrimi
2. Dëgjimi aktiv
3. Të mbajturit mend
4. Vendosja e raportit me publikun
5. Të folurit e trupit
6. Mundësitë e zërit
7. Të përmbajturit
8. Kritika

Komunikimi i suksesshëm nuk është diç që “ndodh ashtu”. Ai është rezultat i grumbullit kompleks të shkathtësive të cilat zhvillohen, perfeksionohen, ushtrohen, nxiten dhe u përshtaten rrethanave. Aftësia për të folur qartë, siç ka thënë Aristoteli, e paraqet artin. Përgatitja për të folur në opinion kërkon nga individit ti hulumtojë raportet që krijon gjuha, e jo vetë gjuha. Natyrisht, dobia e dyfishtë nga paraqitja publike pikërisht është vendosja e raporteve dhe komunikimit.

### **PËRFYTYRIMI**

Imagjinata paraqet bazën për mendime kreative dhe punë kreative edhe tek ai i cili flet edhe tek si kujt i është adresuar kjo. Folësit dinamik e dinë këtë edhe e shfrytëzojnë fuqinë e imagjinatës së vet gjatë përgatitjes, vetë paraqitjes dhe analizës së mëvonshme.

Imagjinata dhe përfytyrimi para paraqitjes ndikojnë në aftësinë e improvizimit, memories, të folurit e trupit, ekspresivitetin e zërit si dhe në aftësinë e interpretimit dhe zgjedhjes së materialit.

### **DËGJIMI AKTIV**

Në komunikimin me gojë përgjegjësia e dëgjuesit është e njëjtë sie dhe përgjegjësia e folësit. Folësi mund të jetë argëtues, i mprehtë, i mençur, spirituoz, por nëse nuk ka kush ta dëgjojë atë parashtrim, kjo vetëm është lojë jo complete. Që komunikimi të jetë i suksesshëm të paktën nevojiten dy lojtar.

Si mund ta tërhiqni publikun që të dëgjojë më mirë? Kurrqysh. Publiku edhe ashtu më shumë dëgjon se sa që shkruan, lexon apo flet dhe, nëse i thoni që ta drejtojnë vëmendjen, ndoshta do të shkyçen tërësisht. Publiku duhet të dëgjojë aktivisht, e jo më mirë, të angazhohet në procesin e dëgjimit. Tri metoda të dëgjimit aktiv- shfrytëzimi i të folurit të trupit, përfytyrimi dhe shkathtësia e ekzaminimit - do të krijojnë dëgjues më të suksesshëm.

Folësit kanë përgjegjësi ta verifikojnë a mund ti dëgjojë secili, a janë ulur të gjithë komod, a mund të realizojnë kontakt me sy, të përgatisin diç që ia vlen të dëgjohet dhe ti përmbahen kohës që e kanë në dispozicion.

## **MBAJTJA MEND**

Mbajtja mend është akt i brendshëm ku shfrytëzohen aktivisht të gjitha shqisat dhe çdo aspekt i qenies. Mbajtja mend dallon nga të mësuarit përmendsh. Gjithmonë mund të dallojnë parashtruesit të cilët fjalimin e vet e kanë mësuar përmendsh. Ata nuk përqendrohen në krijimin e kontaktit me dëgjuesit ose në theksimin e fjalëve të caktuara, veç në deklamimin e fjalëve dhe të tekstit. Ata janë të preokupuar me fjalë dhe atë jo me fjalët e veta natyrore që i shfrytëzojnë në komunikimin e përditshëm afarist, por me fjalë të sajura të cilat e përjashtojnë thelbin e asaj që dëshirojnë ta thonë.

Paraqitja publike është vendi i fundit ku parashtruesi duhet të heq dorë nga mënyra natyrore e parashtrimit ose ta zëvendësojë me ndonjë mënyrë tjetër.

Shtatë mënyra për ta mbajtur mend tekstin:

### **1. Leximi zëshëm**

Zgjidhni tekstin e fjalim që ju pëlqen. Lexoni fjalimin zëshëm. Mund ti lexoni në vetvetes, të dashurit të shtëpisë ose mikut. Krijoni imazhin e të folurit në imagjinatë. Pasi që tekstin e keni lexuar pesë herë, përpuni që vetvetes t'ia rrëfeni zëshëm rrëfimin duke mos shikuar në tekst. Nëse diçka nuk ju kujtohet, verifikoni atë pjesë të fjalimit, pastaj tekstin lënë dhe vazhdoni të flisni. Tash lexoni tekstin edhe pesë herë zëshëm dhe me ekspresivitet. Mos harroni ta shfrytëzoni imazhin dhe imagjinatën. Tash do të duhej të jeni në gjendje t'ia rrëfeni vetvetes tekstin e fjalimit e që me atë rast të mos shikoni në tekst.

### **2. Vizatimi**

Mendoni për fjalim in tuaj si për stripin. Si do ta vizatonit personazhin kryesor? Si do ta vizatoni ambientin? Vizatoni tekstin tuaj të fjalimit në dhjetë deri dyzetë figura të vogla, por pa re të vogla për fjalim. Gjithsesi verifikoni nëse stripi juaj ka fillim, mes dhe fund. Ngjyrosni vizatimet. Tregoni mikut stripin dhe rrëfejani tregimin duke shfrytëzuar strupin si ilustrim.

### **3. Dëgjimi**

Lexoni fjalimin tuaj sa më me ekspresivitet dhe incizoni në kasetë. Dëgjojeni katër herë. Përfytyroni fjalimin në imagjinatën tuaj.

Kur ta dëgjoni për herë të pestë, rrëfeni tekstin e fjalimit krahas me incizimin. Tash shkyçni magnetofonin dhe vetvetes foli zëshëm fjalimin.

### **4. Këndimi**

Këndojeni fjalimin tuaj si këngën e muzikës së njohur. Këndojeni me zë të ulët disa herë derisa nuk e përvetësoni tërësisht.

### **5. Improvizimi**

Lozni fjalimin tuaj sikur të ishte fjala mbi pjesën teatrale. Orvatuni të lozni personazhe të ndryshëm me zëra karakteristik dhe mënyrën e të ecurit. Pastaj orvatuni ta rrëfeni fjalimin sikur të jeni ju narator, duke futur personazhe të ndryshme siç zhvillohej fjalimi.

### **6. Krijimi i hartës**

Punoni hartën e fjalimit (ose formularin e ngjarjeve) dhe rrëfejani vetvetes ose mikut fjalimin duke shfrytëzuar hartën si ciceron tuajin.

### **7. Rrjedha e ngjarjeve**

Reduktoni fjalimin në gjashtëmbëdhjetë fjali kyçe. Pastaj ato gjashtëmbëdhjetë fjali reduktoni në tetë. Tetë fjalitë vini në kartelet indeksose, secilën veç e veç. Përzieni, pastaj radhisni nga fillimi deri në fund, e pastaj orvatuni vini në renditje anasjelltas. Përzieni hartat dhe shihni sa shpejtë mund ti rendisni. Tash përpuni që vetvetes t'ia rrëfeni zëshëm atë version të përmbledhur. Pastaj hartoni një version të gjatë.

## VENDOSJA E RAPORTEVE ME PUBLIKUN

Folësi i suksesshëm dëshiron të realizojë kontakt me publikun. Por, si vendoset ajo lidhje? Elementet kryesore për vendosjen dhe ruajtjen e raporteve me publikun; Kontakti me sy-kontakti direkt me sy jo vetëm që zhvillon besimin midis folësit dhe dëgjuesit, veç folësit i jep edhe fuqi mbi ata që e dëgjojnë, nxit respektim, bënë të duket i përmbajtur, kërkon nga dëgjuesit ti kushtojnë vëmendje folësit para se të është folur ndonjë fjalë.

Të kaluarit me shikim- Kur folësi me lehtësi realizon kontaktin me sy me publikun, duhet ta shikojë me sy gjithë publikun, të ndalët në personat e caktuar, që me ta të realizoj kontakt me sy dhe pastaj të vazhdojë me shikimin.

Njëra nga sfidat më të mëdha në paraqitjen publike është të jesh në gjendje që njëkohësisht të bësh më shumë gjëra: ta kontrollosh nervozizmin, ta mbash mend çka duhet thënë dhe ta mbash vëmendjen e publikut.

### Gjuha e trupit

Trupi dërgon mesazhe për të mirë dhe për të keq pa ndonjë fjalë të folur. Folësi duhet t'ia dërgojë mesazhin pozitiv publikut të vet ku paraqitet publikisht. Publiku duhet ta vërej si të aftë, të përmbajtur dhe nën kontroll, kurse folësi duhet të ketë për qëllim ta mbaj vëmendjen e publikut të vet. Folësi duhet të dijë se fjalët mund ta magjepsin publikun, por çelësi për mbajtjen e vëmendjes është gjuha e trupit.

Falë **qëndrimit, gjestikulimit dhe mimikës së fytyrës**, folësi mund ta fus një fuqi dhe pasion të jashtëzakonshëm në paraqitjen e vet publike.

Nga tri teknika të të folurit të trupit më i rëndësishëm është **qëndrimi**. Me qëndrimin e vet folësi i dërgon vibracione pozitive a negative publikut. Ato vibracione menjëherë ndikojnë në atë si e pranon publiku folësin dhe si reagon ndaj tij.

Teknika tjetër e rëndësishme është **mimika e fytyrës**. Kur rëndësia e fjalëve pasqyrohet në fytyrë, ato fjalë ndikojnë bindshëm.

Më në fund, fjalët e folësit i fuqizon gjestikulimi i zakonshëm por kuptimor.

### Mundësitë e zërit

Ekzistojnë katër teknika themelore vokale: fuqia (zëshëm dhe i qetë), lartësia (lartë dhe thellë), tempi (shpejtë dhe ngadalë) dhe përdorimi i heshtjes. Këto katër teknika mund të kombinohen ashtu që të fitohet një numër i madh i efekteve të cilët veprojnë në mënyra të ndryshme në publikun. Shkathtësia qëndron në faktin që të shfrytëzohet e drejta e kombinimit në kohë të duhur që të arrihet efekti që e dëshiron folësi. Nëse folësi donë të krijojë tendosje dhe pritje, atëherë zëri i thellë dhe i fuqishëm me të cilin flasim ngadalë edhe e ndërtojmë pritjen që sjellë rezultatin e parë.

Nga katër teknika të shprehjes vokale fuqia është më e rëndësishme. Më keq për folësin është që publiku të mos e dëgjojë. Prandaj është e domosdoshme që zëri të jetë mjaftë i fuqishëm, por jo tepër i fortë, që folësin ta dëgjojë publiku.

### Të ruhet të përmbajturit

Përmbajtja – ndërlikimi, qetësia, rehatia- është përshtypje që donë ta lë secili që flet në opinion. Folësi në vetvete mund të jetë i frikësuar, i pasigurt, i tmerruar, i brengosur, i emocionuar, i magjepsuar apo edhe bile të vuaj, por publikut duhet ti duket i përmbajtur.

Folësi e ushqen publikun me energjinë e vet, e ngre atë, e bartë dhe e hipnotizon. Por energjia e cila nuk është nën kontroll mund të shndërrohet në dy armiqtë të hatashëm për atë që flet në opinion- në lëvizje nervoze dhe tremë.



Tri taktika për ruajtjen e të përmbajturit:

1. Të kuptohet trupi vetanak dhe të njihet si ndikon me nervozizëm në sjellje, secili i ka pikat e veta të dobëta me të cilat duhet t'ia dalë në krye.

2. Ushtrimi dot ë ndërtojë vetëbesim i cili çon në sukses. Ushtrimi kap simulimin, pushtimin e vëmendjes së publikut, shfrytëzimin e fjalive të para interesante, përfundimin e fjalimit me gjest të fuqishëm. Krejt kjo është pjesë e përgatitjes për paraqitje të mirë.

3. Në fund, folësi duhet të angazhohet aktivisht në ushtrimet e relaksimit, që të zhvillohet vetëdija mbi rrethinën e vet dhe të fitojë kontrollin mbi trupin dhe mendjen e vet.

Parashtrimi nuk fillon kur folësi nis të flas apo kur qëndron përpara publikut. Ai fillon para se e paralajmërojnë paraqitjen e tij. Ai duhet të jetë i lirë edhe para se të ngrihet, ashtu që me ecjen e vet të tregojë vetëbesim dhe përbëshmëri. Qëndrimi i mirë fizik- koka drejtë, shpatullat e qitura mbrapa, shikimi para vetes dhe lëvizjet e lira të duarve- flet mjaftë mbi raportin e folësit ndaj asaj që do ta thotë.

Folësi e krijon atmosferën dhe atë e bën me qëndrimin ndaj asaj që e ekspozon. Prandaj, folësi duhet të vendos çka është qëndrimi tij ose cili është raporti i tij ndaj materialit, e pastaj të krijojë atmosferën me të cilën edhe do ti jap mbështetje atij qëndrimi duke shfrytëzuar tonin përkatës.

### **Kritika**


Ekziston dallimi i qartë midis kriticizmit dhe kritikës. Kritik është ai që gjykon.

Kriticizmi gjithmonë është negativ.

Kritika definohehet si proces, si analizë e kujdeshme e prodhimit artistik.

Kjo është akt i cili mbështetet në dijeni dhe përvojë. Analiza duhet të jetë rezultat i syrit të arsimuar.

Shtojca 12. Tabela e dinamikës kohore



**Botues**

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës e Republikës së Serbisë

**Për botuesin**

Dr Zharko Obradović, ministër

**Titulli i botimit**

Edukata qytetare për klasën e pestë të shkollës fillore

Doracak për mësimdhënës

**Doracakun e kanë përgatitur**

Mirjana Trkulja

Smiljana Grujić

Natasha Gjurić

**Recenzent**

Eleonora Vlahović

**Përktheu në gjuhën shqipe**

Fahri Musliu

**Lektura e doracakut në shqip**

Alma Lama

**Kopertinat dhe thyerja**

Ivan Valenčak

Malisha Vučković

ISBN978-86-7408-048-1